



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 08/241  
Datë: 27.12.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4, dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 dhjetor 2024, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Strategjia për Menaxhimin e Integruar të Mbeturisë në Republikën e Kosovës 2024-2035 dhe Plan i Veprimit 2024-2026.
2. Obligohet Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit, nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

# Strategjia (2024-2035) për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave në Kosovë dhe Plan i Veprimit (2024-2026)



Dhjetor 2024

## Tabela e Përmbajtjes

|                                                                                                                                                            |           |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|
| <b>TABELA E PËRMBAJTJES</b>                                                                                                                                | <b>2</b>  |
| <b>AKRONIMET</b>                                                                                                                                           | <b>4</b>  |
| <b>PËRKUFIZIMET</b>                                                                                                                                        | <b>5</b>  |
| <b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b>                                                                                                                              | <b>7</b>  |
| <b>1 HYRJE</b>                                                                                                                                             | <b>11</b> |
| <b>2 METODOLOGJIA</b>                                                                                                                                      | <b>12</b> |
| <b>3 HISTORIKU</b>                                                                                                                                         | <b>14</b> |
| 3.1 GJENERIMI I MBETURINAVE                                                                                                                                | 14        |
| 3.2 GJENDJA EKZISTUESE                                                                                                                                     | 16        |
| 3.2.1 MBETURINAT E NGURTA KOMUNALE                                                                                                                         | 16        |
| 3.2.2 MBETURINAT E NDËRTIMIT DHE RRËNIMIT                                                                                                                  | 18        |
| 3.2.3 MBETURINAT BUJQËSORE DHE TË KAFSHËVE                                                                                                                 | 20        |
| 3.2.4 AUTOMJETET                                                                                                                                           | 20        |
| 3.2.5 GOMAT                                                                                                                                                | 21        |
| 3.2.6 PAJISJET ELEKTRIKE DHE ELEKTRONIKE                                                                                                                   | 21        |
| 3.2.7 VAJRAT                                                                                                                                               | 22        |
| 3.2.8 BATERITË                                                                                                                                             | 22        |
| 3.2.9 LLUMI                                                                                                                                                | 23        |
| 3.2.10 MBETURINAT INDUSTRIALE DHE MINERARE                                                                                                                 | 24        |
| 3.2.11 MBETURINAT E RREZIKSHME                                                                                                                             | 24        |
| 3.2.12 MBETURINAT MEDICINALE                                                                                                                               | 25        |
| 3.2.13 FRAKSIONET E TJERA TË MBETURINAVE                                                                                                                   | 25        |
| 3.3 ANALIZA                                                                                                                                                | 27        |
| 3.1 PËRMBLEDHJE                                                                                                                                            | 29        |
| <b>4 OBJEKTIVAT</b>                                                                                                                                        | <b>31</b> |
| 4.1 VIZIONI                                                                                                                                                | 31        |
| 4.2 OBJEKTIVAT STRATEGJIKË DHE SPECIFIKE                                                                                                                   | 31        |
| 4.3 CAQET PËR GRUMBULLIM TË NDARË, PËRGATITJE PËR RIPËRDORIM, RICIKLIM DHE PËRPUNIM                                                                        | 34        |
| 4.3.1 PËRGATITJA PËR CAQET E RIPËRDORIMIT DHE RICIKLIMIT PËR MBETURINAT KOMUNALE                                                                           | 35        |
| 4.3.2 PËRGATITJA PËR CAQET E RICIKLIMIT PËR MBETURINAT E NDËRTIMIT DHE RRËNIMIT                                                                            | 35        |
| 4.3.3 CAQET PËR FRAKSIONET SPECIFIKE TË MBETURINAVE                                                                                                        | 35        |
| 4.4 OBJEKTIVI STRATEGJIK 1: INICIIMI I SHËRBIMEVE DHE INFRASTRUKTURËS PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETURINAVE                                            | 36        |
| 4.4.1 ZGJERIMI I SHËRBIMEVE TË GRUMBULLIMIT TË MBETURINAVE KOMUNALE                                                                                        | 37        |
| 4.4.2 SISTEMI I OBJEKTEVE PËR PËRPUNIMIN DHE DEONIMIN E MBETURINAVE PËR MBETURINAT KOMUNALE                                                                | 38        |
| 4.4.3 MENAXHIMI I PËRMIRËSUAR I MBETURINAVE INDUSTRIALE, MBETURINAVE TË RREZIKSHME, MBETURINAVE<br>NGA N&RR DHE FRAKSIONEVE TJERA SPECIFIKE TË MBETURINAVE | 39        |

|              |                                                                             |           |
|--------------|-----------------------------------------------------------------------------|-----------|
| <b>4.5</b>   | <b>OBJEKTIVI STRATEGJIK 2: KUSHTET KORNIZË</b>                              | <b>45</b> |
| <b>4.5.1</b> | <b>KORNIZA RREGULLATORE</b>                                                 | <b>45</b> |
| <b>4.5.2</b> | <b>ORGANIZIMI DHE KAPACITETET INSTITUCIONALE</b>                            | <b>46</b> |
| <b>4.5.3</b> | <b>BASHKËPUNIMI NDËR-KOMUNAL</b>                                            | <b>47</b> |
| <b>4.6</b>   | <b>OBJEKTIVI STRATEGJIK 3: IMPLEMENTIMI, ZBATIMI I LIGJIT DHE FINANCIMI</b> | <b>48</b> |
| <b>4.6.1</b> | <b>LEJET, ZBATIMI DHE RAPORTIMI</b>                                         | <b>48</b> |
| <b>4.6.2</b> | <b>MEKANIZMAT E MBULIMIT TË KOSTOS</b>                                      | <b>49</b> |
| <b>4.6.3</b> | <b>ANGAZHIMI I SEKTORIT PRIVAT</b>                                          | <b>49</b> |
| <b>4.7</b>   | <b>OBJEKTIVI STRATEGJIK 4: EKONOMIA QARKORE</b>                             | <b>50</b> |
| <b>4.7.1</b> | <b>PARANDALIMI I MBETURINAVE</b>                                            | <b>51</b> |
| <b>4.7.2</b> | <b>RRITJA E NORMAVE TË RIPËRDORIMIT, RICIKLIMIT DHE PËRPUNIMIT</b>          | <b>52</b> |
| <b>4.7.3</b> | <b>VETËDIJESIMI DHE EDUKIMI</b>                                             | <b>55</b> |
| <b>4.7.4</b> | <b>PROMOVIMI I INOVACIONIT DHE KËRKIMIT</b>                                 | <b>56</b> |
| <b>5</b>     | <b><u>ZBATIMI, MONITORIMI DHE RAPORTIMI</u></b>                             | <b>58</b> |
| <b>5.1</b>   | <b>PARIMET</b>                                                              | <b>58</b> |
| <b>5.2</b>   | <b>ZBATIMI, MONITORIMI DHE RAPORTIMI</b>                                    | <b>59</b> |
| <b>6</b>     | <b><u>NDIKIMI BUXHETOR</u></b>                                              | <b>64</b> |
| <b>7</b>     | <b><u>PLANI I VEPRIMIT</u></b>                                              | <b>65</b> |

## Akronimet

|        |                                                                   |
|--------|-------------------------------------------------------------------|
| NPK    | Nënproduktet e Kafshëve                                           |
| UA     | Udhëzimi Administrativ                                            |
| AKK    | Asociacioni i Komunave të Kosovës                                 |
| QN     | Qendër e Ndarjes (qendër e lënies për riciklim)                   |
| MNRr   | Mbeturinat e Ndërtimit dhe Rrënit                                 |
| DMM    | Departamenti i Mbrojtjes së Mjedisit                              |
| SIM    | Sistemi Informativ Mjedisor                                       |
| AV     | Automjetet e Vjetruara                                            |
| PZP    | Përgjegjësia e Zgjeruar e Prodhuesit                              |
| BE     | Bashkimi Evropian                                                 |
| EWC    | Klasifikimi Evropian i Mbeturinave                                |
| BERZH  | Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim                        |
| EWL    | Lista Evropiane e Mbeturinave                                     |
| GHG    | Gazra Serrë                                                       |
| GIZ    | Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit           |
| MM     | Mbeturinat Medicinale                                             |
| MRr    | Mbeturinat e Rrezikshme                                           |
| IMMRr  | Inventari i Materialeve të Mbeturinave të Rrezikshme              |
| MIMO   | Menaxhimi i Integruar i Mbeturinave Organike                      |
| SRJ    | Spektori i Riciklimit Joformal                                    |
| MIMN   | Menaxhimi i Integruar i Mbeturinave të Ngurta                     |
| SMIM   | Strategjia e Menaxhimit të Integruar të Mbeturinave               |
| JICA   | Agjencia Japoneze e Bashkëpunimit Ndërkombëtar                    |
| ASK    | Agjencia e Statistikave të Kosovës                                |
| KEK    | Korporata Energjetike e Kosovës                                   |
| AMMK   | Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës                      |
| AUVK   | Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë e Kosovës                    |
| SMIMK  | Strategjia për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave në Kosovë    |
| KMDK   | Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë                      |
| LM     | Ligji nr. 04/L-060 për Mbeturina                                  |
| MIE    | Ministria e Integrimeve Evropiane                                 |
| MMPHI  | Ministria e Mjedisit, Planifikimi Hapësinor dhe Infrastrukturës   |
| MZHE   | Ministria e Zhvillimit Ekonomik                                   |
| MF     | Ministria e Financave                                             |
| MSh    | Ministria e Shëndetësisë                                          |
| MAPL   | Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal                      |
| MASHTI | Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit       |
| MNK    | Mbeturinat e Ngurta Komunale                                      |
| KASH   | Korniza Afatmesme e Shpenzimeve                                   |
| O&M    | Operimi dhe Mirëmbajtja                                           |
| SHSP   | Shëndeti dhe Siguria në Punë                                      |
| ZKM    | Zyra e Kryeministrit                                              |
| ZPS    | Zyra e Planifikimit Strategjik                                    |
| PAMKos | Shoqata për Mjedis më të Pastër të Kosovës                        |
| KRM    | Kompania Rajonale e Mbeturinave                                   |
| SDG    | Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm                            |
| SIDA   | Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA) |
| LVPP   | Lista e Vetme e Projekteve Prioritare                             |
| UNDP   | Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim                      |
| USAID  | Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar        |
| WABI   | Indikatorët e Standardit 'Wasteaware' për MIMN-në                 |

|      |                                                   |
|------|---------------------------------------------------|
| MMB  | Menaxhimi i Mbeturinave dhe Burimeve              |
| WBIF | Korniza e Investimeve për Ballkanit Perëndimor    |
| MPEE | Mbeturinat nga Pajisjet Elektrike dhe Elektronike |
| PMM  | Plani për Menaxhimin e Mbeturinave                |

## Përkufizimet

|                                                      |                                                                                                                                                                                                                                                                             |
|------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Plani i Veprimit</b>                              | Një dokument tek i cili arrihet përmes një procesi strategjik dhe taktik të vendimmarrjes, i cili i obligon autoritetet kompetente dhe/ose akterët e tjerë që të zbatojnë masa të caktuara të nevojshme për arritjen e një qëllimi të përcaktuar.                           |
| <b>Mbeturinat Biologjike</b>                         | Mbeturinat e biodegradueshme të kopshteve dhe parqeve, mbeturinat e ushqimit dhe të kuzhinës nga amvisëritë, restorantet, furnizuesit e ushqimit dhe bizneset e shitjes me pakicë dhe mbeturinat e ngjashme nga impiantet e përpunimit të ushqimit.                         |
| <b>Mbeturinat e Ndërtimit dhe Rrënimit</b>           | Mbeturinat e gjeneruara nga ndërtimi ose rrënimi i ndërtesave dhe infrastrukturës tjetër, në të cilat zakonisht hyjnë dheu, betoni, tullat, qelqi, druri, pllakat izoluese, asbesti, metalet dhe plastika.                                                                  |
| <b>Asgjësimi</b>                                     | Çdo operacion që nuk është përpunim, edhe kur ky operacion si pasojë dytësore ka përpunimin e substancave apo energjisë.                                                                                                                                                    |
| <b>Përgjegjësia e Zgjeruar e Prodhuesit</b>          | Prodhuesit e produkteve, produktet e të cilëve më pas bëhen mbeturina, marrin përgjegjësi për të caktuar masa për grumbullimin dhe menaxhimin (përfshirë ripërdorimin, riciklimin dhe përpunimin) e mbeturinave të gjeneruara nga produktet e tyre në fazën pas konsumimit. |
| <b>Mbeturinat Elektronike</b>                        | Pajisjet e vjetra, të skaduar ose të hedhura që përdorin energji elektrike (të njohura edhe si mbeturina e pajisjeve elektrike dhe elektronike, MPEE)                                                                                                                       |
| <b>Mbeturinat e Gjelbra</b>                          | Mbeturinat që përbëhen nga gjethet, bari i prerë, ashklat, degët dhe format e tjera të mbeturinave organike të prodhuara nga hapësirat e gjelbërta ose kopshtet, të ndara nga mbeturinat e tjera të ngurta.                                                                 |
| <b>Menaxhimi i Integruar i Mbeturinave të Ngurta</b> | Përdorimi i koordinuar i një varg metodash dhe zgjidhjesh për menaxhimin e mbeturinave, secila nga të cilat e ka një rol funksional në një sistem të përgjithshëm të menaxhimit të mbeturinave të ngurta dhe që kombinohen së bashku si një tërësi krejtësisht koherente.   |
| <b>Deponia</b>                                       | Vende ku mbeturinat izoloohen nga mjedisi përreth dhe degradimi i tyre menaxhohet në kuadër të një procesi të kontrolluar fizik, biologjik dhe kimik derisa të bëhen të sigurta.                                                                                            |
| <b>Mbeturinat e Ngurta Komunale</b>                  | Mbeturinat e prodhuara nga amvisëritë ose bizneset të një natyre të ngjashme me mbeturinat e amvisërisë.                                                                                                                                                                    |
| <b>Parimi “ndotësi paguan”</b>                       | Zbatimi i tarifave dhe instrumenteve ekonomike për të siguruar që shpenzimet e menaxhimit të mbeturinave të mbarten nga prodhuesi i mbeturinave ose nga mbajtësit/transportuesit e mbeturinave në emër të tyre.                                                             |
| <b>Përgatitja për ripërdorim</b>                     | Operacionet e kontrollimit, pastrimit ose riparimit e përpunimit, me anë të të cilave përgatiten produktet ose përbërësit e produkteve që janë bërë mbeturina në mënyrë që të mund të ripërdoren pa ndonjë përpunim tjetër paraprak.                                        |
| <b>Parandalimi</b>                                   | Masat që merren para se një substancë, material apo produkt të jetë bërë mbeturinë dhe që e zvogëlojnë sasinë e mbeturinave dhe ndikimet negative të mbeturinave të prodhuara në mjedis dhe në shëndetin e njeriut, ose përmbajtjen e substancave të                        |

|                                             |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
|---------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|                                             | dëmshme në materiale dhe produkte.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |
| <b>Riciklimi</b>                            | Çdo veprim i përpunimit me të cilin materialet e mbeturinave ripërpunohen në produkte, materiale ose substanca qoftë për qëllimin origjinal, qoftë për qëllime të tjera. Ai përfshin ripërpunimin e materialit organik, por nuk përfshin përpunimin për energji dhe ripërpunimin në materiale që do të përdoren si lëndë djegëse ose për operacione të rimbushjes. |
| <b>Ripërdorimi</b>                          | Çdo veprim me të cilin produktet apo komponentët që nuk janë mbeturina përdoren përsëri për të njëjtin qëllim për të cilin janë konceptuar.                                                                                                                                                                                                                        |
| <b>Standard</b>                             | Një masë e pranuar e krahasimit të vlerës sasiore ose cilësore; një kriter me të cilin zbatohet dhe/krahasohet performanca e sistemeve të MMN-së.                                                                                                                                                                                                                  |
| <b>Stacioni i transferimit</b>              | Një objekt apo vend përpunimi për deponimin e përkohshëm të mbeturinave ku automjetet për grumbullimin e mbeturinave komunale i deponojnë mbeturinat e tyre për t'i ngarkuar në automjete më të mëdha dhe për transportim të mëtejshëm deri në pikën përfundimtare për riciklim, trajtim ose deponim.                                                              |
| <b>Trajtimi</b>                             | Trajtimi<br>Një metodë, teknikë apo proces që:<br>a) E ndryshon karakterin fizik, biologjik apo kimik apo përbërjen e një mbeturine<br>b) E heq, ndan, përqendron apo përpunon një përbërës të rrezikshëm të mbeturinave<br>c) E shkatërron apo e redukton toksicitetin e një mbeturine                                                                            |
| <b>Mbeturinë</b>                            | Çdo substancë, pavarësisht se a ka potencial për t'u reduktuar, ripërdorur, ricikluar ose përpunuar; që është tepërisht ndaj nevojave të pronarit/prodhuesit dhe që hidhet.                                                                                                                                                                                        |
| <b>Menaxhimi i Mbeturinave dhe Burimeve</b> | Menaxhimi i materialeve, të krijuara si mbeturina, në një mënyrë në të cilën ripërdorimi, riciklimi dhe përpunimi janë maksimale si pjesë integrale e një tranzicioni të drejtë dhe financiarisht të qëndrueshëm drejt ekonomisë qarkore.                                                                                                                          |

## Përmbledhje ekzekutive

Ligji për Mbeturinat i transponon rregullat evropiane për menaxhimin e mbeturinave dhe e siguron një kornizë gjithëpërfshirëse për zhvillimin e sektorit të menaxhimit të mbeturinave. Ligji i jep përkufizimet, parimet, fushëveprimin, kornizën e planifikimit strategjik, përgjegjësitë e akterëve të ndryshëm dhe kërkesat për secilën fazë në zinxhirin e menaxhimit të mbeturinave për llojet e ndryshme të mbeturinave. Ligji e udhëzon përgatitjen e kësaj Strategjie për Menaxhimin e Mbeturinave. Strategjia e re, e cila ndryshon objektivat dhe përfshin një analizë të opsioneve përkatëse, u rishikua duke ndryshuar strategjinë ekzistuese që ishte miratuar në vitin 2021.

Përmes zbatimit të masave që parashikohen në këtë strategji do të trajtohen obligimet e Kosovës që burojnë nga Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit (MSA-ja) dhe të përafrojë politikat sektoriale në fushën e menaxhimit të mbeturinave me ato të Bashkimit Evropian (BE), duke e përshpejtuar kështu procesin e integritetit evropian.

Përveç kësaj, Agjenda e Reformave Evropiane (ARE-ja) është hartuar për t'i maksimizuar dobitë ekonomike dhe politike të MSA-së. Shtylla II - Aftësia konkurruese dhe investimet – e thekson përmirësimin e mëtejshëm të politikave dhe zbatimin e tyre në fushën e mjedisit, duke u përqendruar veçanërisht në menaxhimin e mbeturinave, parimin “ndotësi paguan” dhe përgjegjësinë mjedisore.

Kjo strategji e paraqet qasjen e qeverisë ndaj Menaxhimit të Integruar të Mbeturinave të Ngurta (MIMN-së) në Kosovë. Ajo paraqet hapin e ardhshëm drejt realizimit të këtyre prioritetëve strategjike kombëtare. Strategjia i përcakton objektivat strategjike, objektivat specifike, dhe indikatorët për sektorin e menaxhimit dhe riciklimit të mbeturinave. Strategjia mbulon një periudhë 12 vjeçare nga viti 2024 deri në vitin 2035 dhe e përfshin një Plan të Veprimit trevjeçar nga viti 2024 deri në vitin 2026.

Vizioni i kësaj strategjie është:

Të mbrohet shëndeti publik dhe të zvogëlohet ndikimi i mbeturinave në mjedis, duke nxitur njëkohësisht mundësitë për biznes dhe punësim dhe tranzicion drejt një ekonomie qarkore të harmonizuar me normat dhe standardet evropiane.

Strategjia synon t'i trajtojë të metat dhe kufizimet aktuale në sektorin e menaxhimit të mbeturinave, duke i përcaktuar dhe realizuar katër objektivat strategjike në vijim. Duke arritur këto objektiva strategjike, Kosova do të përshpejtojë rrugëtimin e saj drejt zhvillimit të potencialeve ekonomike dhe ngritjes së standardeve të jetesës.

Objektivat strategjike dhe specifike për këtë Strategji të Menaxhimit të Integruar të Mbeturinave janë përcaktuar përmes një analize të problemeve dhe shkaqeve të tyre.

**Objektivi strategjik 1: Iniciimi i shërbimeve dhe infrastrukturës për menaxhimin e integruar të mbeturinave.** Ky objektivi strategjik do të realizohet me ndihmën e tri objektivave specifike në vijim:

- **Objektivi specifik 1.1:** Ofrimi i shërbimeve të përshtatshme dhe të qëndrueshme të grumbullimit të mbeturinave të ngurta komunale për të gjithë gjeneruesit e mbeturinave.
- **Objektivi specifik 1.2:** Zhvillimi i sistemeve dhe impianteve të integruara, për përpunimin dhe depozimin e mbeturinave komunale.

- **Objektivi specifik 1.3:** Zhvillimi i shërbimeve dhe infrastrukturës së përshtatshme për mbeturinat nga aktivitetet industriale, mbeturinat e ndërtimit dhe rrënimit (MNRr), mbeturinat e rrezikshme dhe fraksionet e tjera specifike të mbeturinave

Shërbimet e menaxhimit të Mbeturinave të Ngurta Komunale (MNK) fillojnë me grumbullimin ose grumbullimin e ndarë të mbeturinave nga familjet, bizneset dhe institucionet. Mbulimi me shërbime të grumbullimit të mbeturinave është rritur ndjeshëm gjatë viteve të fundit, por shërbimet ende nuk ofrohen në të gjithë vendin. Kjo strategji inkurajon dhe nxit komunat që t'i vazhdojnë përpjekjet e tyre për t'i ofruar shërbime të menaxhimit të mbeturinave tërë popullatës, qoftë drejtpërsëdrejti, nëpërmjet Kompanive Rajonale të Mbeturinave (KRM) apo nëpërmjet sektorit privat.

Zhvillimi i sistemeve për grumbullim të ndarë të mbeturinave për fraksione të ndryshme, është nevojshëm për arritjen e objektivave për ripërdorim, riciklim dhe devijimin e mbetjeve nga deponitë. Zhvillimi i grumbullimit të ndarë dhe klasifikimit të mbeturinave për mallrat e mbeturinave të riciklueshme si letra dhe kartoni, plastika, qelqi dhe metalet do të financohet nëpërmjet skemave të reja të përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit (PZP) për mbeturinat e paketimit dhe fraksionet tjera të veçanta të mbeturinave.

Komunat do të jenë gjithashtu përgjegjëse për ta mbështetur kompostimin në shtëpi në zonat me shtëpi familjare dhe aty ku është e nevojshme për organizimin e grumbullimit të veçantë dhe kompostimit të mbeturinave të gjelbra të krijuara në territoret e tyre. Në planin afatgjatë, grumbullimi i ndarë i mbeturinave ushqimore do të krijohet të paktën në zonat urbane së bashku me objektet e përshtatshme të përpunimit në nivel rajonal.

Deponimi i mbeturinave në deponi do të mbetet opsioni kryesor i deponimit gjatë viteve të para të zbatimit të strategjisë. Të gjitha deponitë rajonale duhet t'i përmbushin standardet teknike të fundit deri në vitin 2027 dhe të garantojnë që mbeturinat hidhen pa shkaktuar rrezik për mjedisin dhe shëndetin e njerëzve. Në planin afatgjatë, reduktimi i mëtejshëm i deponimit të mbeturinave komunale do të arrihet përmes krijimit të objekteve rajonale të Trajtimit Mekanik-Biologjik (TMB).

Për Karburantin që Rrjedh nga Mbeturat (KRrM) e prodhuara nga këto objekte do të nevojitet ngritja e një Impianti të Centralizuar të Përpunimit të Mbeturinave për Energji (WtE) ose të përpunohet si lëndë djegëse alternative në industrinë e çimentos.

Industria do të jetë përgjegjëse për të garantuar ruajtjen, përpunimin dhe deponimin e sigurt të mbeturinave industriale të krijuara nga ndërmarrjet, për të përmirësuar efikasitetin e burimeve dhe për ta arritur përmbushjen e kërkesave ligjore.

Infrastruktura për deponimin e mbeturinave të rrezikshme duhet të krijohet sipas Udhërrëfyesit për Krijimin e Sistemit të Menaxhimit të Mbeturinave të Rrezikshme në Kosovë. Pas kësaj duhet të realizohet analiza e fizibilitetit teknik dhe qëndrueshmërisë financiare për ndërtimin e impianteve për trajtimin, ripërtëritjen dhe deponimin e mbeturinave të rrezikshme. Ndërkohë, zgjidhjet për eksportin e mbeturinave të rrezikshme duhet të identifikohen në bazë të marrëveshjeve dypalëshe dhe në përputhje me dispozitat e Konventës së Bazelit. Infrastruktura e përshtatshme do të nevojitet gjithashtu për fraksione tjera të veçanta të mbeturinave, si mbeturinat e ndërtimit dhe rrënimit, mbeturinat e kujdesit shëndetësor dhe llumrat nga impiantet për trajtimin e ujërave të zeza.

**Objektivi strategjik 2: Përmirësimi i kornizës rregullatore, planifikuese dhe institucionale për menaxhimin e mbeturinave dhe burimeve.** Ky objektivi strategjik do të realizohet me ndihmën e tri objektivave specifike në vijim:

- **Objektivi specifik 2.1:** Miratimi i kornizës ligjore të përditësuar dhe krijimi i mekanizmave të implementimit dhe forcimit të ligjit.
- **Objektivi specifik 2.2:** Alokimi i burimeve adekuate njerëzore dhe teknike për institucionet kompetente dhe fuqizimi i vazhdueshëm i kapaciteteve të tyre.
- **Objektivi specifik 2.3:** Krijimi i një kornize të planifikimit ndër-komunal dhe procedurave të qarta për të nxitur bashkëpunimin ndër-komunal.

Kosova po punon për ta harmonizuar legjislacionin e saj me normat e BE-së, duke kërkuar përshtatje të shpejta për ta mbajtur ritmin me peizazhin legjislativ në zhvillim të BE-së. Koncepti dokumenti i sektorit përshkruan se si të përditësohet korniza rregullatore e sektorit të menaxhimit të mbeturinave dhe të modernizohen mekanizmat e tij të zbatimit, duke siguruar hapa të mundshëm drejt përputhshmërisë së plotë duke marrë parasysh burimet dhe kapacitetet institucionale në dispozicion.

Për të kaluar drejt një ekonomie qarkore për menaxhimin e mbeturinave dhe burimeve, është jetike të përcaktohen qartë rolet brenda institucioneve zbatuese të Strategjisë për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave në Kosovë (SMIMK). Sigurimi që organizatat e përfshira kanë burimet dhe kompetencat e nevojshme, përfshirë forcimin e bashkëpunimit ndër-komunal dhe rritjen e kontrolleve rregullatore, është thelbësore për zbatimin efektiv të strategjisë dhe zhvillimin e sektorit.

Komunat e Kosovës, pasi kanë rritur me sukses shkallët e grumbullimit të mbeturinave përmes bashkëpunimit të vazhdueshëm, tani janë duke hyrë në fazën tjetër të zhvillimit, drejt shërbimeve të menaxhimit të integruar të mbeturinave. Kjo duke u bazuar në bashkëpunim ndër-komunal dhe shërbime të centralizuara të deponimit, për të siguruar fizibilitet ekonomik dhe shfrytëzim efikas të fazave të ardhshme të sektorit të Menaxhimit të Mbeturinave dhe Burimeve (MMB).

**Objekti strategjik 3: Përmirësimi i kapaciteteve implementuese, ligjzbatuese dhe financuese në sektorin e menaxhimit të mbeturinave.** Ky objektiv strategjik do të realizohet me ndihmën e tri objektivave specifike në vijim:

- **Objekti specifik 3.1:** Krijimi i sistemeve gjithëpërfshirëse dhe funksionale të lejeve, raportimit dhe zbatimit të ligjit.
- **Objekti specifik 3.2:** Promovimi i mekanizmave për mbulimin e plotë të kostos dhe rritja e investimeve në sektor.
- **Objekti specifik 3.3:** Krijimi i kushteve për ta tërhequr përfshirjen e sektorit privat në investimet në infrastrukturë dhe ofrimin e shërbimeve.

Sistemi i lejeve mjedisore është vendosur për një rishikim gjithëpërfshirës për të përfshirë të gjithë akterët e sektorit të mbeturinave, duke mbështetur përfshirjen e sektorit privat në menaxhimin e mbeturinave dhe burimeve. Krahës kësaj, sistemi informativ për menaxhimin e mbeturinave në kuadër të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit në Kosovë (AMMK) do të zgjerohet për ta përmirësuar cilësinë e të dhënave. Masat e zbatimit të ligjit do të rriten, duke theksuar rëndësinë e nxitjes së praktikave të përgjegjshme dhe sigurimin e pajtueshmërisë më të rreptë me rregulloret mjedisore, me komunat që luajnë një rol kyç në ekzekutimin efektiv.

SMIMK nënvijëzon një qasje të gjithanshme të financimit, duke integruar mekanizma të ndryshëm financimi dhe instrumente ekonomike për ta lehtësuar barrën e komunave, duke kaluar në faza në mbulimin gjithëpërfshirës të kostos, duke siguruar financim të qëndrueshëm të sektorit të MMB në Kosovë. SMIMK ofron mundësi të konsiderueshme për angazhimin e sektorit privat, duke kërkuar heqjen e barrierave dhe ofrimin e stimuljeve për ta shfrytëzuar potencialin e tij, veçanërisht duke pasur parasysh kërkesat e mëdha për investime që financat publike nuk mund t'i përmbushin vetëm.

**Objekti strategjik 4: Iniciimi i tranzicionit të Kosovës drejt ekonomisë qarkore duke maksimizuar shfrytëzimin e burimeve/materialeve nga sektori i mbeturinave.** Ky objektiv strategjik do të realizohet me ndihmën e tri objektivave specifike në vijim:

- **Objekti specifik 4.1:** Mbështetja për parandalimin e mbeturinave dhe përmirësimin e efikasitetit të burimeve.

- **Objektivi specifik 4.2** Rritja e grumbullimit të ndarë, ripërdorimit dhe riciklimit sipas treguesve të performancës, instrumenteve ekonomike dhe skemave të përgjegjësisë së zgjeruar së prodhuesit.
- **Objektivi specifik 4.3:** Ngritja e vetëdijesimit për rëndësinë dhe dobitë e menaxhimit dhe riciklimit të duhur të mbeturinave dhe stimulimi i ndryshimit të sjelljes.
- **Objektivi specifik 4.4:** Rritja e përfshirjes së akterëve ekonomikë dhe institucioneve arsimore dhe kërkimore në përhapjen dhe zbatimin e praktikave dhe inovacioneve qarkore

BE-ja ka vendosur një politikë ambicioze për të ecur në drejtim të ekonomisë qarkore. Modelet evropiane të prodhimit dhe konsumit do të ndryshojnë ndjeshëm në dekadat e ardhshme dhe Kosova do të përshtatet dhe do t'i përgjigjet kësaj sfide.

Nga pikëpamja ekonomike, përfitimet nga tranzicioni në ekonominë qarkore janë të shumta – rritja e efikasitetit të burimeve, ulja e kostove materiale, stimulimi i inovacionit, shkëputja e rritjes ekonomike nga konsumi i burimeve, zhvillimi i tregut të punës, reduktimi i mbeturinave dhe kostove për deponimin e tyre.

Me kalimin e kohës, shërbimet e menaxhimit të mbeturinave do të bëhen më komplekse, me krijimin gradual të sistemeve të grumbullimit me kontejnerë të shumëfishtë dhe me një komunitet, biznese dhe institucione nga të cilat do të kërkohet që të bashkëveprojnë me shërbimet e menaxhimit të mbeturinave në mënyra të ndryshme. Ndryshimi kulturor i qëndrimeve dhe sjelljes është i nevojshëm për ta mbështetur këtë tranzicion.

Ripërdorimi dhe riciklimi janë prioritet i rëndësishëm strategjik, si në aspektin e zhvillimit të ekonomisë në Kosovë, ashtu edhe në aspektin kritik për arritjen e caceve të përcaktuara nga kjo strategji.

Qeveria i jep përparësi ndarjes së mbeturinave në burim dhe do të zhvillohen sisteme grumbullimi të materialeve të ndryshme të riciklueshme, me mbështetjen e instrumenteve ekonomike dhe “përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit” për mbeturinat e paketimit, bateritë dhe akumulatorët, pajisjet elektrike dhe elektronike dhe rrjedhat e tjera të veçanta të mbeturinave. Do të futet gjithashtu Sistemi i Rimbursimit të Depozitave (SRD) për ambalazhet e pijeve, i cili i lejon gjithkujt që të kthejë mbetjet në një makineri të posaçme dhe të marrë prej saj paratë e depozitara në blerje.

Mbeturinat biologjike konsiderohen gjithashtu si fraksion prioritar i mbeturinave për ta rritur riciklimin dhe në planet ndër-komunale të menaxhimit të mbeturinave do të duhet të përfshihen masa të përcaktuara për kompostimin dhe tretjen anaerobe.

Gjithashtu, për arritjen e niveleve të larta të riciklimit do të nevojitet një politikë e përcaktuar qartë e qeverisë për t'i mbështetur tregjet për lëndët e para dytësore.

Në mënyrë që çdo politikë, sistem, shërbim dhe teknologji e mbeturinave të arrijë sukses pozitiv dhe të qëndrueshëm, mbështetja proaktive e qytetarëve është thelbësore. Sjellja njerëzore gjithashtu ka ndikimin në koston e trajtimit të mbeturinave, ekzistencën e vend deponimeve të paligjshme si dhe ambicet lokale, rajonale dhe globale për ta reduktuar ndotjen plastike. Fushatat për ndryshimin e sjelljes janë mjet thelbësor për të ofruar jo vetëm informacion, por motivim të krijuar për ta frymëzuar përfshirjen gjatë zbatimit të sistemeve të reja të menaxhimit të mbeturinave nëpër komunitete.

Zhvillimi i inovacioneve, dhe në veçanti i eko-inovacioneve, është një pjesë themelore e konceptit të tranzicionit drejt një ekonomie qarkore. Eko-inovacionet janë teknologji, procese, produkte ose shërbime të reja që kontribuojnë në mbrojtjen e mjedisit ose përdorimin më efikas të burimeve. Për t'i riorganizuar modelet e prodhimit dhe konsumit dhe për t'i transformuar mbeturinat në burime, ne kemi nevojë për teknologji, procese, shërbime dhe modele të reja biznesi që do të paracaktjnë të ardhmen e ekonomisë dhe shoqërisë sonë.

Kjo strategji do të nxisë përmirësime të mëdha në sektorin e menaxhimit dhe riciklimit të mbeturinave. Për këtë qëllim është hartuar një Plan i Veprimit që e mbulon periudhën 2024-2026 dhe që përmban dispozita për dokumentet e planifikimit strategjik në nivel qendror.

# 1 Hyrje

Mbeturinat janë nënprodukt nga jeta e jonë e përditshme personale dhe profesionale, që krijohen nga shtëpitë tona, bizneset, industria, vendet e ndërtimit, spitalet, etj. Gjërat që i hedhim duhet të ruhen, mbledhen, transportohen, përpunohen, riciklohen, trajtohen dhe deponohen në mënyrë të sigurt.

Është bërë përparim i mirë në përmirësimin e mbulimit me shërbime dhe cilësisë së shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave. Nga një bazë prej rreth 57% të mbulimit me shërbime të grumbullimit të mbeturinave në vitin 2015, shërbimet e grumbullimit të mbeturinave janë shtrirë në 90,5% të popullsisë në vitin 2021<sup>1</sup>, dhe kjo përqindje vazhdon të rritet. Kjo do të thotë se jemi në rrugën e duhur drejt ofrimit të shërbimeve gjithëpërfshirëse të grumbullimit të mbeturinave për tërë popullatën dhe mund të synojmë në nivelin e ardhshëm të ambicieve për të zhvilluar sisteme për menaxhimin e integruar të mbeturinave. Përderisa pjesa e parë e zinxhirit të shërbimit të menaxhimit të mbeturinave – grumbullimi i mbeturinave - është e dukshme për syrin e publikut, MIMN mbështetet në trajtimin dhe përpunimin kompleks të materialeve pas grumbullimit që zakonisht nuk kuptohen apo çmohen mirë. Me zhvillimin e ekonomisë rritet edhe shumëllojshmëria e produkteve që vendosen në treg. Ato bëhen gjithashtu më komplekse, duke e bërë ripërdorimin ose riciklimin e tyre më të komplikuar, nëse është e mundur.

Ofrimi i shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave të ngurta komunale është përgjegjësi primare dhe funksioni themelor i komunave. Komunitetet dhe kompanitë e tyre rajonale të mbeturinave (KRM-të) janë ofrues të shërbimeve të vijës së parë të frontit në këtë drejtim. Publiku ka dhe do të vazhdojë të ketë rol në financimin e sistemeve të menaxhimit të mbeturinave dhe ata që gjenerojnë mbeturina duhet t'i kontribuojnë mbulimit të këtyre shpenzimeve. Menaxhimi i integruar i mbeturinave të ngurta kërkon gjithashtu që komunitetet t'i bashkojnë forcat dhe ta trajtojnë ripërtëritjen, trajtimin dhe deponimin e mbeturinave në mënyrë të koordinuar.

Reformimi i sektorit të menaxhimit të mbeturinave ka marrë vëmendje më të madhe gjatë viteve të fundit. Menaxhimi i qëndrueshëm i mbeturinave është përfshirë si kapitull në Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit, duke u përqendruar në nevojën për të investuar në infrastrukturën e menaxhimit, për t'i konsoliduar kompanitë publike, për t'i kontraktuar operatorët ekonomikë, për ta ngritur vetëdijësimin dhe për ta stimuluar riciklimin.<sup>2</sup>

Marrëveshja e Stabilizimit Asocimit (MSA), e cila hyri në fuqi më 1 prill 2016, e obligoi Kosovën (neni 115 i Ligjit për Mjedisin) që t'i përmbushë obligimet lidhur me ndalimin e degradimit të mëtejshëm të mjedisit dhe fillimin e përmirësimit të kushteve mjedisore. Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të mbeturinave në Kosovë është paraparë në programin kryesor për zbatimin e kësaj marrëveshjeje, Programin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së (PKZMSA), gjegjësisht në treguesin (pika 3.27) "Përmirësimi i politikave për menaxhimin e mbeturinave dhe ekonomisë qarkore"<sup>3</sup>.

---

<sup>1</sup> AMMK, Raporti i Menaxhimit të Mbeturinave Komunale në Kosovë, shih në: [Raporti i mbeturinave komunale për vitin 2021\\_shq\(2\).pdf \(ammk-rks.net\)](#), fq. 13

<sup>2</sup> Qeveria e Kosovës, SKZH 2030, shih në: [Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2030 \(rks-gov.net\)](#)

<sup>3</sup> Qeveria e Kosovës, PKZMSA 2022-2026, shih në: [41310-UpdEn.PDF \(rks-gov.net\)](#), fq. 286

Përmes zbatimit të masave që parashikohen në këtë strategji do të trajtohen obligimet e Kosovës që burojnë nga Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit (MSA-ja) dhe të përaftojë politikat sektoriale në fushën e menaxhimit të mbeturinave të përafërta me ato të BE-së, duke e përshpejtuar kështu procesin e integritetit evropian. SMIMK miraton objektiva që e sjellin Kosovën në përputhje me rregulloret e BE-së. Ajo i referohet Agjendës së Gjellbër të BE-së për Ballkanin Perëndimor, e cila thekson rëndësinë e parandalimit të mbeturinave, përafrimit e caqeve, përmirësimit të strategjive të menaxhimit të mbeturinave dhe forcimit të ripërtëritjes së materialeve nga fraksionet e mbeturinave. SMIMK adopton tranzicionin në një ekonomi qarkore në sektorin e menaxhimit të mbeturinave në përputhje me Udhërrëfyesin e Ekonomisë Qarkore të Kosovës (2023).

Ligji për Mbeturina<sup>4</sup> i transpozon rregullat evropiane për menaxhimin e mbeturinave dhe e siguron një kornizë gjithëpërfshirëse për zhvillimin e sektorit të menaxhimit të mbeturinave. Ai i jep përkufizimet, parimet, fushëveprimin, kornizën e planifikimit strategjik, përgjegjësitë e akterëve të ndryshëm dhe kërkesat për secilën fazë në zinxhirin e menaxhimit të mbeturinave për llojet e ndryshme të mbeturinave.

Kjo strategji e paraqet qasjen e qeverisë ndaj menaxhimit të integruar të mbeturinave të ngurta në Kosovë. Ajo paraqet hapin e ardhshëm drejt realizimit të këtyre prioritetëve strategjike kombëtare. Strategjia i përcakton objektivat strategjike, objektivat specifike, caqet dhe indikatorët për sektorin e menaxhimit dhe riciklimit të mbeturinave. Strategjia mbulon një periudhë 12 vjeçare nga viti 2024 deri në vitin 2035 dhe e përfshin një Plan të Veprimit trevjeçar nga viti 2024 deri në vitin 2026. Rishikimi i vitit 2023 i SMIMK përfshin caqe detyruese në përputhje me rregulloret e BE-së dhe përshkruan një qasje strategjike për t'i përmbushur këto synime deri në vitin 2045, duke u shtrirë përtej afatit kohor aktual të strategjisë. Ky mendim i fokusuar në të ardhmen është thelbësor për ta udhëhequr përparimin e sektorit dhe për t'i informuar vendimet për nevojat e ardhshme. Rishikimi gjithashtu përditëson analizën e të dhënave me të dhënat më të fundit dhe thekson bashkëpunimin ndër-komunal si thelbësor për planifikimin e menaxhimit të integruar të mbeturinave.

## 2 Metodologjia

Strategjia e Menaxhimit të Integruar të Mbeturinave në Kosovë 2021-2035 është përgatitur nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) në bashkëpunim me ministrinë, autoritetet kompetente dhe akterët tjerë si në vijim:

- Zyra e Kryeministrit
- Ministria e Zhvillimit Ekonomik
- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
- Ministria e Shëndetësisë
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
- Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
- Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
- Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë e Kosovës
- Kompania për Menaxhimin e Deponive të Kosovës
- Instituti i Kosovës për Administratë Publike
- Oda Ekonomike e Kosovës

---

<sup>4</sup> Ligji nr. 04/L-060, shih në: [LIGJI NR. 04/L-060 PËR MBETURINA - SHTOJCA \(rks-gov.net\)](#) dhe [LIGJI NR. 08/L-071 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR.04/L-060 PËR MBETURINA \(rks-gov.net\)](#)

Sipas Ligjit për Mbeturina, SMIMK i mbulon fraksionet e mbeturinave në vijim: mbeturinat komunale, mbeturinat e ndërtimit dhe rrënit, mbeturinat e kafshëve, mbeturinat e kujdesit shëndetësor, mbeturinat industriale, mbeturinat e rrezikshme dhe ato të kujdesit shëndetësor, dhe llojet e fraksionet e tjera specifike të mbeturinave, siç janë paketimi, tekstili, automjetet, gomat, pajisjet elektrike dhe elektronike, vajrat, bateritë dhe llumi. Mbeturinat minerare dhe bujqësore nuk mbulohen zyrtarisht brenda fushës së strategjisë, por informacioni në dispozicion është paraqitur në kapitullin 3.

Kjo strategji është përgatitur sipas kërkesave ligjore mbi procesin dhe procedurat e hartimit të dokumenteve strategjike që i përmban Udhëzimi Administrativ (UA) 07/18 për Planifikimin dhe Hartimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të Veprimit<sup>5</sup>. Struktura dhe përmbajtja e kësaj Strategjie dhe e Planit të Veprimit shoqërues u përmbahen kërkesave që janë përcaktuar në UA.

Përgatitja e strategjisë është mbikëqyrur nga një grup punues ndërmënor, i cili është kryesuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, duke përfshirë përfaqësuesit e institucioneve të renditura më lart. Asistenca teknike për përgatitjen e dokumentit strategjik dhe lehtësimi i procesit të konsultimit është siguruar nga Bashkëpunimi Gjerman për Zhvillim, që është realizuar nga Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ). E njëjta qasje është aplikuar edhe për rishikimin e SMIMK-së në vitin 2023.

Për metodologjinë e përgatitjes së kësaj strategjie janë ndjekur praktikat më të mira ndërkombëtare. Procesi ka filluar në muajin mars të vitit 2023 me një punëtor fillestare. Janë mbajtur pesë punëtori, të cilat janë përqendruar në kornizën strategjike, analizën e opsioneve si dhe diskutimin dhe finalizimin e draftit të strategjisë. Kërkesat që janë përcaktuar në Rregulloren për Standardet Minimale të Konsultimit Publik<sup>6</sup> janë respektuar.

Qëllimi kryesor i strategjisë është të projektojë tranzicionin e sektorit të menaxhimit të mbeturinave në Kosovë nga shërbimet të qëndrueshme bazike në menaxhimin e integruar të mbeturinave dhe burimeve në përputhje me kërkesat e BE-së duke u siguruar që ajo të jetë:

- Kuptimplotë në aspektin e sjelljes së një ndryshimi me ndikim.
- E zbatueshme në kontekstin e sektorit specifik në Kosovë.
- Në përputhje me standardet dhe kërkesat kombëtare dhe evropiane.

Caqet dhe indikatorët janë përcaktuar për të qenë të arritshme, në kuadër të burimeve financiare që dihet se janë në dispozicion, të plotësuar me financat që janë zotuar nga partnerët zhvillimorë ndërkombëtarë.

Për realizimin e qaveve dhe indikatorëve do të kërkohet një përpjekje e vendosur dhe e koordinuar nga qeveria, komunat dhe industria e menaxhimit dhe riciklimit të mbeturinave, e mbështetur nga programet për ngritje të kapaciteteve dhe financim për zhvillim.

---

<sup>5</sup> Udhëzimi Administrativ nr. 07/2018, shih në: [UDHËZIM ADMINISTRATIV \(QRK\) NR. 07/2018 PËR PLANIFIKIMIN DHE HARTIMIN E DOKUMENTEVE STRATEGJIKE DHE PLANEVE TË VEPRIMIT \(rks-gov.net\)](#)


<sup>6</sup> Rregullorja nr. 05/2016, shih në: [RREGULLORE \(QRK\) NR. 05/2016 PËR STANDARDET MINIMALE PËR PROCESIN E KONSULTIMIT PUBLIK \(rks-gov.net\)](#)

### 3 Historiku

#### 3.1 Gjenerimi i mbeturinave

Shumica e raporteve të të dhënave bazë përqendrohen në MNK. Të dhëna për MNK-të raportohen nga AMMK dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK). Sistemi i raportimit të të dhënave menaxhohet nga AMMK, dhe ofron një grup të plotë por jo të përsosur të të dhënave për menaxhimin e mbeturinave, gjeneruesit e mbeturinave dhe të dhëna financiare. Të dhënat e paraqitura më poshtë janë dhënë nga raporti i AMMK 2021<sup>7</sup> dhe modeli i projektimit të mbeturinave të përgatitur nga ekspertët e hartimit të këtij dokumenti. Për vitin 2021 raportohen të dhënat e mëposhtme të mbeturinave për Republikën e Kosovës:

- bazuar në projeksione vlerësohet se në Kosovë u gjeneruan përafërsisht 580,000 ton të MNK në vitin 2021.
- prej tyre menaxhohen, grumbulluar dhe deponuar 490,000 ton në 7 nga deponitë e menaxhuara në Kosovë.<sup>8</sup>
- vlerësohet se përafërsisht 230,000 ton (40% e gjithsej MNK-ve sipas anketës së përbërjes së mbeturinave të kryer nga programi MS i GIZ) janë mbeturina komunale të biodegradueshme.
- vlerësohet se përafërsisht 240,000 ton (41% e gjithsej MNK sipas anketës së përbërjes së mbeturinave) janë të riciklueshme (letër, plastikë, qelq, metal).
- Sasia e mbeturinave të ricikluara të raportuara në vitin 2021 ishte 21,307 ton/vit ose 5.4 herë më e lartë se në vitin 2020



<sup>7</sup> Të dhënat e përdorua në SMIMK janë të fundit zyrtarisht të publikuara nga AMMK

<sup>8</sup> Të dhënat nuk raportohen/disponohen për 1 prej deponive.

| Fraksioni i mbeturinave        | Urbane | Rurale |
|--------------------------------|--------|--------|
| Mbeturinat e ushqimit          | 28.0%  | 29.4%  |
| Tetrapak                       | 2.4%   | 2.5%   |
| Letër/karton                   | 13.9%  | 14.6%  |
| Plastikë                       | 18.1%  | 18.9%  |
| Tekstil                        | 4.4%   | 4.6%   |
| Pelena                         | 3.6%   | 3.8%   |
| Fraksioni i imët i mbeturinave | 6.4%   | 6.7%   |
| Mbeturinat e gjelbra           | 12.1%  | 8.0%   |
| Druri                          | 1.3%   | 1.4%   |
| Qelqi                          | 5.1%   | 5.3%   |
| Metalet                        | 1.7%   | 1.8%   |
| Mbeturinat interte             | 2.8%   | 2.9%   |
| Mbeturinat e rrezikshme        | 0.2%   | 0.2%   |
| Total                          | 100.0% | 100.0% |

Një analizë e përbërjes së mbeturinave kryer nga programi Shërbime të Qëndrueshme Komunale i GIZ ofroi vlerësimin e parë analitik në shkallë vendi të fraksioneve të mbeturinave në Kosovë. Kjo siguron informacion të rëndësishëm që mbështet projeksionin strategjik për objektet e nevojshme të grumbullimit dhe trajtimit të infrastrukturës së mbeturinave. Megjithatë, informacioni për fraksionet e veçanta/jo komunale të mbeturinave mbetet i kufizuar.

Rezultatet e raportit të ASK 2021<sup>9</sup> tregojnë se në vitin 2021 janë grumbulluar 2,214,928 ton mbeturina industriale, ose 3.6% më shumë krahasuar me vitin 2020. Sektorët e tillë si furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar dhe minierat dhe gurthyesit janë kontribuuesit kryesorë me përkatësisht 57.2% dhe 25.4%

Figura 1: Analiza e Përbërjes së Mbeturinave 2023 (GIZ)

Kombëtar të Menaxhimit të Mbeturinave të Ndërtimit dhe Rrënit (MNRr) (maj 2023) me qëllim krijimin e një kornize dhe vendosjen e primeve dhe kërkesave për menaxhimin e qëndrueshëm të MNRr-ve në nivel kombëtar. Raporti vlerëson se përafërsisht 620,000 m<sup>3</sup> MNRr gjenerohen çdo vit në Republikën e Kosovës, që parashikohet të rritet për rreth 70% në vitin 2040. Grumbullimi i MNRr-ve në përgjithësi është joformal dhe deponohen në rreth 760 deponi në të gjithë vendin, ku riciklimi në parim nuk ekziston (vetëm nisma të fragmentuara nga sektori privat). Plani vendosi një sërë objektivash dhe caqesh të parashikuara për vitin 2030 për të zbatuar menaxhimin e integruar të MNRr-ve.




Figura 2: Sektorët kryesorë të gjenerimit të mbeturinave 2021. Anketa e Institutit të Statistikave të Kosovës 2021.

Proporcionet e mbeturinave të gjeneruara nga burimet kryesore janë ilustruar në diagramin në vijim. Gjithsej sasia e mbeturinave nga të gjithë sektorët e bazuar në Institutin e Statistikave të Kosovës për vitin 2021 është rreth 2.8 milion ton, dyfishi i sasisë së anketës së Eurostat-it të vitit 2014.

Me përjashtim të mbeturinave komunale, këto janë vlerësime të përafërta që nuk burojnë nga të dhëna në sisteme të konsoliduara të mbledhjes dhe raportimit të të dhënave.

<sup>9</sup> Anketat e Mbeturinave Industriale 2021, shih në: [Template for SOK publications in Albanian \(rks-gov.net\)](https://rks-gov.net)

## 3.2 Gjendja ekzistuese

### 3.2.1 Mbeturinat e ngurta komunale

Problemet në sektorin e mbeturinave të ngurta komunale janë kuptuar gjerësisht dhe janë paraqitur në disa raporte dhe publikime gjatë viteve të fundit. Këto përfshijnë Raportin për Menaxhimin e Mbeturinave Komunale në Kosovë, Raportin për Gjendjen (2021), Raportin për Gjendjen e Mbeturinave dhe Kimikateve (2014) dhe Raportin për Hotspotet Mjedisore (2011) të publikuara nga AMMK-ja dhe raportin e mbeturinave të Rrezikshme industriale në Kosovë (2019).

Përparim i dukshëm është bërë në zgjerimin e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave, i cili raportohet të jetë rreth 90.2%<sup>10</sup>, duke shënuar një rritje prej rreth 15.8%<sup>11</sup> më shumë krahasuar me vitin 2017. Në hartën e mëposhtme është paraqitur gjendja e shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave të ngurta komunale sipas të dhënave të AMMK të vitit 2021.

Deponimi është metoda kryesore e trajtimit të MNK-ve. Në Kosovë ekzistojnë 7 deponi të menaxhuara nga dy kompanitë KMDK dhe KRM. AMMK 2021 raporton një rritje mbi 22% në gjithsej MNK gjatë periudhës 2017 - 2021<sup>12</sup>. Kosova është afër shterjes së kapacitetit të lejuar të deponive të saj. Përveç kësaj, deponitë ekzistuese nuk menaxhohen në përputhje të plotë me kërkesat e Direktivën 1999/31/EC e BE-së për Deponitë. Një gjeneratë e dytë e qendrave të menaxhimit të mbeturinave, duke përfshirë përmirësimin dhe zgjerimin e qendrave dhe shërbimeve ekzistuese është prioritet urgjent. Ky përmirësim i infrastrukturës duhet të mbështetet me vënien në zbatim të sistemeve të përmirësuara të grumbullimit të mbeturinave, duke përfshirë sisteme të grumbullimit dhe menaxhimit të ndarë për lloje të ndryshme të mbeturinave/materialeve. Në vitin 2022 AMMK me mbështetjen e GIZ ka identifikuar gjithsej 763 deponi ilegale të klasifikuara në tri kategori i) të vogla (një deri në pesë thasë mbeturinash 200l) ii) të mesme (6-20 thasë mbeturinash 200l) dhe iii) të mëdha (mbi 20 thasë 200l) bazuar në inspektimin vizual.<sup>13</sup> Aktiviteti i sektorit joformal fokusohet kryesisht në metale, plastikë, letër dhe karton, bateri dhe MPEE dhe i shet ato zakonisht për eksport. Nuk ka të dhëna për sasinë e mbeturinave të mbledhura nga sektori joformal.

---


<sup>10</sup> Raporti i Menaxhimit të Mbeturinave komunale në Kosovë, shih në: [Raporti i mbeturinave komunale për vitin 2021\\_shq\(2\).pdf \(ammk-rks.net\)](https://ammk-rks.net/Raporti_i_mbeturinave_komunale_për_vitin_2021_shq(2).pdf)

<sup>11</sup> Ibid

<sup>12</sup> Ibid

<sup>13</sup> Raporti gjatë hartimit të Strategjisë ende nuk është publikuar zyrtarisht. Të dhënat në fjalë janë mbledhur gjatë intervistave të ekspertëve me zyrtarë të AMMK-së.

## Mbulimi me shërbimin e grumbullimit të mbeturinave 2021



Burimi AMMK 2023

Figura 1: Shkalla e mbulimit me shërbimin e grumbullimit dhe transportit të MK sipas komunave, (Raporti i monitorimit të AMMK 2021)



Figura 2: Zonat e reja të mbeturinave të Kosovës (2023)

### 3.2.2 Mbeturinat e ndërtimit dhe rrënit



MMPHI-ja, me mbështetjen e BERZH-it ka zhvilluar Planin Kombëtar të Menaxhimit të Mbeturinave të Ndërtimit dhe Rrënit (Maj 2023). Sipas Planit aktualisht, përafërsisht 620,000 m<sup>3</sup> MNRR-ve (që korrespondon me 515,000 ton) gjenerohet në bazë vjetore në vend (përfshijtur dheun e gërmimit dhe punët publike si hekurudhat dhe punimet rrugore), një sasi e cila pritet të rritet ndjeshëm (~70% deri në vitin 2040) në vitet në vijim, për shkak të zgjerimit të madh të pritshëm të sektorit të ndërtimit. Përreth 60% e MNRR-ve gjenerohet në Rajonin e Prishtinës, ndërsa Rajoni i Prizrenit paraqet sasinë e dytë më të madhe të prodhuar. Në nivel komunal, afërsisht 40% e MNRR gjenerohet në Komunën

e Prishtinës, ndërsa Fushë Kosova shton 15% të MNRR-ve. Të gjitha komunat e tjera kontribuojnë me më pak se 7% në prodhimin e përgjithshëm të MNRR-ve.

Aktualisht MNRR-ja e krijuar mblidhet nga operatorë të paautorizuar (qoftë KRM-të ose operatorë privatë që punojnë për sektorin e ndërtimit) dhe hidhet ose në vendet e specifikuar nga autoritetet lokale (22 vende magazinimi të përkohshëm janë identifikuar) ose në të gjithë vendin në një në mënyrë

të pakontrolluar (përreth 760 deponi janë të shpërndara në mbarë Kosovën). Riciklimi i materialit në parim nuk ekziston (vetëm iniciativa të fragmentuara nga sektori privat). Për më tepër, ka një mungesë të plotë të të dhënave në lidhje me prodhimin, përbërjen, riciklimin dhe deponimin e MNRR-ve, ndërkohë që nuk janë dedikuar aktivitete për menaxhimin e asbestit ose materialeve të tjera të rrezikshme të përfshira në MNRR-të.

Plani cakton caqe të reja të performancës për të sjellë një reduktim të konsiderueshëm në sasinë e MNRR-ve të deponuara në deponitë në Kosovë dhe është si vijon:

- **Sistemet e integruara për menaxhimin e MNRR-ve:** Zhvillimi i sistemeve të tilla përfshin pajisjet e grumbullimit dhe infrastrukturën përkatëse, objektet e ripërtëritjes, trajtimit dhe deponimit;
- **Grumbullimi i ndarë i MNRR-ve:** Është përcaktuar miratuar caku prej jo më pak se 40% të MNRR-ve gjithsej që do të mbledhet ndaras deri në vitin 2030– Zhvillimi i një rrjeti të zonave të duhura të ruajtjes së përkohshme dhe Qendrave të Ndarjes (QN) / pikave të lëshimit;
- **Rritja e normave të ripërtëritjes:** Është përcaktuar miratuar caku prej jo më pak se 20% shkallë ripërtëritje për MNRR-të deri në vitin 2030. Shkalla i referohet përqindjes gjithsej të MNRR-së së prodhuar (ose 50% e MNRR-ve të mbledhura ndaras) dhe shkalla e ripërtëritjes përfshin aktivitetet e rimbushjes;
- **Minimizoni normat e deponimit:** Është përcaktuar miratuar caku prej jo më shumë se 75% shkallë deponimi për MNRR-të deri në vitin 2030. Shkalla i referohet përqindjes gjithsej të MNRR-ve të prodhuara;
- **Caktimi fushave të deponimit:** Theksi do t'i jepet guroreve ekzistuese në lidhje me deponimin e mbeturinave të MNRR-ve.

Në përputhje me praktikën e mira ndërkombëtare, janë paraqitur propozime specifike për të siguruar: i. grumbullimin e duhur të MNRR-ve të ndara nga prodhuesi i MNRR-ve, ii. transportin e duhur të mbeturinave, iii. Magazinimin e përkohshëm të mbeturinave në stacionet të caktuara të transferimit ose pikat e shkarkimit, e ndjekur nga iv. përpunimi i duhur i mbeturinave në produkte të riciklueshme ose të ripërdorshme që kanë vlerë tregu dhe ku prodhohen mbeturina minimale, të cilat depozitohen në deponi të caktuara, v. një sistem menaxhimi të zbatuar siç duhet që përmban sasinë dhe klasifikimin e duhur për MNRR-të në faza të ndryshme të trajtimit dhe një sistem monitorimi të zbatuar siç duhet me një proces të rregullt dokumentimi.

Sistemi i propozuar promovon sistemin rajonal (jo komunal) të menaxhimit të MNRR-ve, dhe përfshin: Zhvillimin e gjashtë sistemeve rajonale të menaxhimit të MNRR-ve (ose shtatë nëse pjesa veriore e Kosovës trajtohet ndaras nga Rajoni i Mitrovicës); Blerjen e kontejnerëve dhe kamionëve që shërbejnë për grumbullimin e ndarë të MNRR-ve; Zhvillimi i një rrjeti të QN / Pika të dorëzimit të mbetjeve për ruajtjen e përkohshme, trajtimin paraprak dhe transportimin e MNRR-ve në objektet e trajtimit; Zhvillimi i një rrjeti objektiv riciklimi me qëllim ritrajtimin e materialit të riciklueshëm dhe përgatitjen e materialit për rimbushje; Zhvillimi i një rrjeti vendesh deponimi inerte për mbeturinat e pa riciklueshme.

### 3.2.3 Mbeturinat bujqësore dhe të kafshëve



Mbeturinat bujqësore përkufizohen si mbeturina që krijohen nga përpunimi i ushqimit dhe përfshijnë përdorimin e produkteve që përdoren gjatë veprimtarisë bujqësore. Në Kosovë përfshihen edhe mbeturinat e industrisë ushqimore, në të cilat bëjnë pjesë nënproduktet e kafshëve, siç janë eshtrat e thertoreve, bagëtitë e ngordhura, plehu organik, mbeturinat nga prodhimi i bulmetit, mbeturinat nga prodhimi i alkoolit/pijeve alkoolike dhe çdo artikull ushqimor që është prishur apo e ka arritur datën e skadimit.

Vlerësohet se në Kosovë prodhohen dhe deponohen rreth 14,500 ton mbeturina të kafshëve apo mbeturina të nënprodukteve të kafshëve në vit. Shumica e tyre deponohen bashkë me mbeturinat e amvisërisë në deponi sanitare. Disa komunitete dhe disa thertore i kanë zhvilluar mjetet e veta për menaxhimin e mbeturinave të kafshëve, ndonëse procesi i kompostimit dhe menaxhimi i ujërave të të kullimit nga mbetjet dhe i ujërave të zeza është kryesisht i parregulluar.

Në Kosovë, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë është përgjegjëse për kornizën legislative për menaxhimin e mbeturinave të kafshëve, ndërsa Ligji për Mbeturina nuk është preciz në këtë drejtim. Deri më sot nuk është miratuar ndonjë ligj që do ta rregullonte këtë fraksion të mbeturinave sipas normave të BE-së.

### 3.2.4 Automjetet



Kompanitë ose individët që menaxhojnë Automjetet e Vjetruara (AV) duhet të jenë të licencuara dhe t'u përmbahen ligjeve për vendndodhjen e qendrave të çmontimit. Ata gjithashtu duhet të mbajnë shënime për atë që kanë mbledhur, çfarë lloje dhe sasish të substancave të rrezikshme janë hequr.

Megjithatë, në praktikë, nuk ka një sistem formal grumbullimi dhe sistemi i licencimit nuk funksionon mirë. Pronarët e automjeteve të vjetruara zakonisht i shesin ato në kantieret e mbeturinave të hekurit, të licencuara për këtë aktivitet, ku ose prishen për pjesët e tyre të këmbimit, zhvishen për metalin e tyre dhe/ose eksportohen në vende të tjera të rajonit.

Nuk ka të dhëna në dispozicion për numrin e AV-ve të trajtuara, ose të dhëna se çfarë proporcioni është duke u ripërdorur dhe ricikluar. Kosova aktualisht është duke punuar në miratimin e legjislacionit të ri për PZP (tetor 2023), i cili parasheh zbatimin e skemave të PZP për disa fraksione të veçanta të mbeturinave duke përfshirë AV-të. Duke marrë parasysh mungesën e të dhënave dhe një sistemi funksional, ekspertët kanë kryer dhe vlerësimin e numrit të automjeteve dhe mbeturinave të pritura të gjeneruara duke përdorur udhëzimet e BE-së dhe të dhënat statistikore të Kosovës.

Bazuar në të dhënat e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe vlerësimin e kryer nga ekspertët, numri i automjeteve në stok në vitin 2022 ishte 420,331, të cilat përbëjnë 76,298 automjete më shumë se viti 2018 (344,033). Numri i automjeteve të çregjistruara në vitin 2022 ishte 10,744, të cilat përbëjnë 53,151 më pak se viti 2018 (63,895). Në fund, numri i automjeteve të vendosura në treg për vitin 2022 ishte 33,229, që përbën 40,193 më pak se automjetet e vendosura në treg në vitin 2018 (73,422). Duke përdorur këtë formulë dhe projeksionet e bazuara në normat e rritjes së PBB-së (bazuar në të dhënat e Ministrisë së Financave), numri i automjeteve të vendosura në treg u parashikua deri në vitin 2030. Prandaj, numri i automjeteve të vendosura në treg për vitin 2030 parashikohet të jetë 220,626.

Një supozim është bërë që numri i automjeteve të çregjistruara është i barabartë me numrin e AV të gjeneruara në mënyrë që të vlerësohen sasitë e AV në vend. Për prognozën e sasive të ardhshme të AV, shkalla e motorizimit të Kosovës (numri i veturave të pasagjerëve për 1000 banorë) është krahasuar me normën mesatare të motorizimit të BE-së. Krahasimi i të dhënave zbuloi se Kosova nuk arrin shkallën mesatare të motorizimit të BE-së. Kjo sugjeron që makinat kanë më shumë gjasa të qëndrojnë në magazinë në vend që të bëhen AV derisa të arrihet një normë e ngjashme motorizimi si në BE.

Nga parashikimet për automjete të çregjistruara deri në vitin 2030 janë 74,865, ndërsa automjetet në stok pritet të arrijnë në 555,855. Ky fraksion i mbeturinave është menduar të jetë objekt i ligjit të ri të mbeturinave, hartimi i të cilit pritet të fillojë në vitin 2024.

### 3.2.5 Gomat



Personave të përfshirë në menaxhimin e gomave mbeturinë u kërkohet të jenë të licencuar dhe të mbajnë shënime të vëllimeve të trajtuara. Importuesit dhe prodhuesit duhet të mbajnë shënime për vëllimet që hyjnë në sistem. Komunitat kanë detyrimin të lejojnë qendra për shërbimin, grumbullimin dhe trajtimin e gomave në territoret e tyre të cilat duhet të operohen nga personel i licencuar.

Kosova aktualisht ka 3 kompani të licencuara për grumbullimin, rinovimin/trajtimin/riciklimin e gomave. Sipas të dhënave të ASK, për vitin 2022 janë importuar 585,703 goma për lloje të ndryshme automjesh. Megjithatë, asnjë e dhënë për sasinë e gomave të menaxhuara nuk është raportuar ende nga industria. Metodatat aktuale për vlerësimin e vëllimeve të gomave janë vetëm rudimentare me shifra me saktësi që nuk mund të mbështeten siç duhet.

Gomat mbeturina paraqesin një kërcënim të rëndësishëm mjedisor për shëndetin dhe sigurinë, veçanërisht për shkak të rrezikut nga zjarri. Sistemi i menaxhimit për gomat e vjetruara ende nuk është krijuar siç duhet dhe duhet të adresohet në mënyrë që të jetë në përputhje me kërkesat evropiane.

### 3.2.6 Pajisjet elektrike dhe elektronike



Personat e përfshirë në menaxhimin e Mbeturinave të Pajisjeve Elektrike dhe Elektronike (MPEE) duhet të licencohen. Mbajtësit e licencës janë përgjegjës për ndarjen e pajisjeve dhe duhet të mbajnë shënime në lidhje me origjinën/destinacionet/vëllimet e MPEE të trajtuara. Një Udhëzim Administrativ është në fuqi për të filluar një Skemë të Përgjegjësisë së Zgjeruar të Prodhuesit (PZP) për MPEE me objektiva për grumbullimin që do të rriten në mënyrë graduale gjatë viteve të ardhshme, me një synim për një shkallë grumbullimi prej 85% deri në vitin 2020.

Praktikat e menaxhimit të MPEE në Kosovë janë të kufizuara në llojet e MPEE me vlerë pozitive. Përpjekjet për grumbullim të ndarë përqendrohen kryesisht në kategoritë e MPEE me përmbajtje të lartë metali, si pajisjet e mëdha shtëpiake, pasi vlera e tyre mbulon kostot pasuese të trajtimit. MPEE të tjera, si tubat me rreze katodë ose televizorët me panel të sheshtë, nuk kanë interes ekonomik për shkak të vlerës së pamjaftueshme materiale, duke e bërë grumbullimin dhe deponimin e duhur të tyre financiarisht sfidues. Zbatimi i standardeve të trajtimit është i dobët, duke çuar në praktika të ndryshme midis objekteve të licencuara dhe të palicencuara. Grumbulluesit joformal të mbeturinave kontribuojnë gjithashtu në grumbullimin e MPEE që përmbajnë metal. Financimi i kufizuar nga prodhuesit ose komunitet pengon zbatimin e skemave gjithëpërfshirëse të grumbullimit, duke lënë shumë forma të MPEE të përziera në fraksionet e mbeturinave komunale ose të depozituara në shtëpi. Trajtimi i MPEE përfshin kryesisht çmontimin manual të materialeve të vlefshme, me vetëm disa

kompani që përdorin pajisje të avancuara. Aktualisht, Kosova nuk përputhet plotësisht me kërkesat teknike të Direktivës për MPEE, dhe ruajtja e mbeturinave të rrezikshme është duke vazhduar derisa Qendra Kombëtare e Trajtimit të Mbeturinave të Rrezikshme të bëhet funksionale.

Kosova aktualisht ka 5 kompani të licencuara për grumbullimin dhe përpunimin e MPEE. Aktualisht, nuk ka skema grumbullimi, qendra apo pajisje çmontimi dhe nuk ka të dhëna në dispozicion për llojet dhe sasi të MPEE. Kosova aktualisht është duke punuar në miratimin e legjislacionit të ri për PZP (tetor 2023), i cili parasheh zbatimin e skemave të PZP për disa fraksione të veçanta të mbeturinave duke përfshirë MPEE.

Sipas ASK-së, nuk u gjet asnjë informacion statistikor i besueshëm për prodhimin e Pajisjeve Elektrike dhe Elektronike (PEE) në vend, por të dhënat ekzistuese për vlerën totale të PEE të prodhuar tregojnë se pjesa e PEE e prodhuar në Kosovë në krahasim me PEE të importuar është e parëndësishme. Sasi të PEE janë vlerësuar vetëm në bazë të importit dhe eksportit të PEE. Bazuar në vlerësimin e bërë nga ekspertët, numri i PEE të hedhura në treg arrin në 39,421 pajisje të kategorive të ndryshme. Të dhënat e parashikuara tregojnë se ky numër do të arrijë në 52,555 pajisje në vitin 2030.

Bazuar në vlerësimet e kryera nga ekspertët të ndryshëm dhe vlerësimin e bërë nga ekspertët hartues të studimit për PZP, sasia e MPEE për vitin 2023 vlerësohet në rreth 15,595 ton, me një projeksion prej 17,876 ton për vitin 2030. Ky fraksion i mbeturinave është menduar të jetë objekt i ligjit të ri të mbeturinave, hartimi i të cilit pritet të fillojë në vitin 2024.

### **3.2.7 Vajrat**

Në Kosovë, mbeturinat e vajrave grumbullohen kryesisht veçmas, kryesisht për shkak të vlerës së tyre pozitive ekonomike, dhe dërgohen për përpunim. Individët, dyqanet e riparimit të automjeteve dhe gjeneratorët industrialë marrin pjesë në këtë praktikë, duke u dorëzuar kryesisht mbeturinat e vajrave kompanive të licencuara në këmbim të pagesës. Vajrat e përdorura zakonisht përpunohen në vend dhe ripërdoren si lëndë djegëse në prodhimin e asfaltit dhe çimentos, me ri-rafinimin (konvertimi në vajra bazë) që është një metodë trajtimi e përdorur më rrallë. Aktualisht, një kompani e licencuar është e angazhuar në ri-rafinimin e mbeturinave të vajrave, duke përdorur një impiant për distilimin e pjesshëm me vakum, i pasuar me trajtim me acid sulfurik dhe argjilë. Tregu i lubrifikantëve dhe vajrave industriale në Kosovë është i shtyrë nga importi, dhe të dhënat statistikore tregojnë se nuk ka prodhim vendor të vajrave lubrifikues.

Kosova aktualisht është duke punuar në miratimin e legjislacionit të ri për PZP (tetor 2023), i cili parasheh zbatimin e skemave të PZP për disa fraksione të veçanta të mbeturinave duke përfshirë mbeturinat e vajrave.

Në bazë të vlerësimit, sasia e vajrave të përdorura për motor, kuti të shpejtësive dhe për qëllime industriale për vitin 2023 arrin në 6,740,656 litra, me një projeksion për vitin 2030 me një rritje të vogël prej 7,226,895 litra. Ekspertët kanë llogaritur sasinë e mbeturinave të vajrave të grumbullueshme bazuar në përvojën e BE-së dhe praktikën më të mira në dispozicion për llogaritjen e të dhënave. Të dhënat tregojnë se sasia e mbeturinave të vajrave të grumbullueshme si pjesë e vajit lubrifikant të vendosur në treg për vitin 2023 është rreth 3,804,026 litra, me një projeksion në 4,078,431 litra për vitin 2030. Ky fraksion i mbeturinave është menduar të jetë objekt i ligjit të ri të mbeturinave, hartimi i të cilit pritet të fillojë në vitin 2024.

### **3.2.8 Bateritë**

Bateritë dhe akumulatorët janë çdo burim i energjisë elektrike i marrë nga shndërrimi i energjisë kimike në energji elektrike. Pasi kjo energji konsumohet dhe njësia nuk mund të rimbushet, bateritë bëhen mbeturina. Ligjërisht, personat e përfshirë në menaxhimin e këtyre mbeturinave duhet të jenë të licencuar dhe përgjegjës për mbajtjen e shënimeve në lidhje me llojet dhe sasi të baterive. Ligji

për Mbeturina përcakton kornizën për krijimin e një Përgjegjësie të Zgjeruar të Prodhuesit (PZP); ku importuesve, distributorëve, shitësve me pakicë dhe komunave u kërkohet të krijojnë skema grumbullimi të ndarë/kthimi, megjithatë, kërkesa nuk është kthyer ende në praktikë.

Mbeturinat e baterive me përmbajtje të lartë të plumbit grumbullohen veçmas në Kosovë për shkak të vlerës së tyre ekonomike, duke mundësuar mbulimin e kostove të grumbullimit, para-përpunimit dhe transportit. Megjithatë, për llojet e tjera të baterive, të hyrat nga riciklimi shpesh nuk mjaftojnë për t'i mbuluar shpenzimet. Operatorët e licencuar në Kosovë kryesisht mbledhin bateritë e acidit të plumbit, të marra kryesisht nga dyqanet e riparimit të automjeteve ku ndërrohen bateritë e vjetra dhe u shiten operatorëve të menaxhimit të mbeturinave. Ndryshe nga bateritë me acid plumbi, llojet e tjera të baterive, të cilave u mungojnë sistemet e dedikuara të grumbullimit, përfundojnë në fraksione të përziera mbeturinash komunale ose të mëdha ose ruhen në shtëpi dhe biznese për periudha të gjata.

Aktualisht, nuk ekziston një sistem i grumbullimit të ndarë për bateritë e lëvizshme, që kërkon përfshirjen e shitësve me pakicë dhe krijimin e skemave të dedikuara grumbullimi. Në Kosovë nuk ka ndërmarrje që merren me riciklimin e acidit të plumbit apo të baterive të tjera, bateritë dërgohen për riciklim të tëra (pa zbrazur acidin e baterisë) me destinim primar eksportues në vendet fqinje. Kosova aktualisht është duke punuar në miratimin e legjislacionit të ri për PZP (tetor 2023), i cili parasheh zbatimin e skemave të PZP për disa fraksione të veçanta të mbeturinave duke përfshirë bateritë. Bazuar në vlerësimin dhe korrelacionin me veturat e nxjerra në treg, numri i baterive në Kosovë në tri lloje të kategorive, konkretisht bateri portative, bateri automobilistike dhe industriale, arrin në 1662,7 ton për vitin 2023 me një projeksion prej 1782,7 ton në vitin 2030. Ky fraksion i mbeturinave është menduar të jetë objekt i ligjit të ri të mbeturinave, hartimi i të cilit pritët të fillojë në vitin 2024.

### 3.2.9 Llumi



Llumi është nënprodukt i trajtimit të ujit me origjinë urbane dhe shtëpiake (ujërat e zeza), balta nga gropat septike dhe lënda e ngurtë nga Impiantet e Trajtimit të Ujërave të Zeza (ITUZ). Ligji për Mbeturina i përcakton kërkesat për menaxhimin dhe përdorimin e këtyre mbeturinave, duke detajuar pragjet specifike për përdorimin e tyre në bujqësi. MMPHI dhe Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) janë përgjegjëse për menaxhimin e këtyre mbeturinave.

Aktualisht nuk ka të dhëna për trajtimin e llumit, dhe sipas një raporti të ASK-së për Statistikat e Ujërave të Kosovës për vitin 2015 nuk ka trajtim të ujërave të zeza, ku ujërat e zeza derdhen direkt në lumenj. Në Llaushë të Skenderajt ekziston një impiant trajtimi, ky impiant u shërben rreth 10,000 banorëve.

Pas funksionalizimit të ITUZ do të ketë nevojë për menaxhim të nënproduktit të llumit. Sasitë dhe natyra e llumit të krijuar do të varen nga burimet e ujërave të zeza dhe nga teknologjia specifike e ITUZ e përdorur. Në tërë Evropën, llumi i trajtuar i ujërave të zeza mund të përdoret përsëri në tokë si përmirësues i tokës, por vetëm aty ku ka kornizë të mirë të menaxhimit dhe kornizë rregullative.

### 3.2.10 Mbeturinat industriale dhe minerare



Pas vitit 1999, shumë objekte industriale kanë dalë nga funksioni. Këto objekte, posa janë braktisur, kanë lënë pas teknologji dhe ndërtesa të vjetra, dyqane që kanë mbetur të pamenaxhuara, mbeturina të parregulluara dhe deponi të ndotura rëndë me kimikate dhe metale të rënda, që tani përbëjnë rrezik permanent për shëndetin publik. Shumë pak nga këto objekte kanë pronarë të rinj, ndërsa në ato që kanë është bërë vetëm një rehabilitim i pjesshëm.

Sasi të mëdha të kimikateve dhe mbetjet industriale dhe të minierave me përmbajtje të lartë të metaleve të rënda janë trashëguar nga industria kosovare e kohës socialiste (e para luftës) dhe nuk janë trajtuar asnjëherë. Për shkak të teknologjive të vjetra të përpunimit, të cilat nuk kanë mundur përdorimin e mjaftueshëm të lëndëve të para, ka sasi të konsiderueshme të mbetjeve minerare në deponi dhe afër tyre, të cilat shkaktojnë rreziqe të mëdha për mjedisin. Për më tepër, deponitë industriale, për aktivitete të ndryshme minerare, metalurgjike dhe kimike, paraqesin sfida të mëdha. Pikat e nxehta të mjedisit që janë shënuar me sinjal të kuq sa i përket rrezikut të tyre ndaj shëndetit të njeriut, florës dhe faunës janë:

- Kompleksi industrial i Trepçës në komunën e Mitrovicës: 60 milionë ton mbeturina të rrezikshme minerare që përmbajnë sasi të konsiderueshme të metaleve të rënda.
- Korporata Energjetike e Kosovës (KEK-u) në komunën e Obiliqit: Hiri i deponuar dhe liqenet e ujërave të zeza që rrjedhin nga prodhimi i energjisë i bazuar në linjit kontaminojnë vazhdimisht tokën si dhe ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore.
- Kompleksi industrial i Ferronikelit në Glogovc: Mbeturinat e minierave të kontaminuara me metale të rënda që rrezikojnë burimet e ujit.

Deponitë e tjera të egra, kimikatet e mbetura nga fabrikat në të kaluarën, janë ripaketuar dhe ruhen përkohësisht në pika të caktuara në Kosovë, të cilat paraqesin rrezik të përhershëm për mjedisin.

### 3.2.11 Mbeturinat e rrezikshme

Inventari i Materialeve të Mbeturinave të Rrezikshme (MMRr) ofron një regjistrim të mbeturinave të rrezikshme për Kosovën. Ky regjistër azhurnohet rregullisht në fund të çdo viti dhe është baza më gjithëpërfshirëse e të dhënave për prodhimin dhe deponimin e Mbeturinave të Rrezikshme (MRr) në dispozicion.

MRr-të gjenerohen nga burime të shumta duke përfshirë minierat, industrinë, kantieret ndërtimore, mjekësore/veterinare dhe ndërtimin, ndër të tjera. Një studim i Bankës Botërore në vitin 2015 ka identifikuar industrinë që shkaktojnë ndotje dhe pikat e nxehta që gjenerojnë MRr në Kosovë, dhe paraqet pasqyrën më të plotë të hartës së pikave të nxehta në vend.

Aktualisht komponentët e MRr brenda mbeturinave të ngurta komunale nuk janë të ndara. Është vlerësuar se 0.4% deri në 1.2% e mbeturinave komunale është MRr. Me kalimin e kohës, natyra e MRr të gjeneruara nga ekonomitë familjare po ndryshon. Pritet që përqindja e MPEE të rritet gradualisht, ndërsa fraksionet e tjera të mundshme të MRr (si bojërat me bazë tretës) do të ulen në mënyrë të qëndrueshme.

Mbeturinat e rrezikshme në Kosovë menaxhohen në mënyrë jo të duhur, zakonisht ruhen dhe depozitohen në objekte të papërshtatshme dhe të shkatërruara keq, duke mos respektuar paketimin, etiketimin dhe ruajtjen e sigurt të tyre. Me mbështetjen e programit IPA III (2021-2027) të BE-së, është

planifikuar të përgatitet një plan për ndërtimin e një qendre për deponimin e përkohshëm të mbeturinave të rrezikshme.

### 3.2.12 Mbeturinat medicinale



Plani Strategjik për Menaxhimin e Mbeturinave Medicinale (PSMMM) 2023-2030, hartimi i të cilit është mbështetur nga Qeveria Gjermane në vitin 2022, synon të zhvillojë një Plan Kombëtar për menaxhimin e mbeturinave medicinale në përputhje me SMIMK. Strategjia ofron bazën e parë dhe më të plotë të gjenerimit dhe trajtimit të mbeturinave shëndetësore në Kosovë.

Ekzistojnë 9 objekte të licencuara dhe funksionale për trajtimin e mbeturinave, nga të cilat 6 autoklava publike dhe 3 inceneratorë privatë. Bazuar në të dhënat e mbledhura nga të gjitha objektet, në vitin 2021 janë krijuar 1,102,887 kg mbetura infektive, me vetëm 815,334 kg të trajtuara në mënyrë të sigurt. Rreth 74% e totalit të mbeturinave medicinale të gjeneruara janë trajtuar në objekte të licencuara, duke ngritur shqetësime për 26% të mbetur, me gjasë që të përfundojë në deponitë e mbeturinave komunale.

Të dhënat e gjenerimit të mbeturinave të tjera të rrezikshme, si mbeturinat kimike dhe mbeturinat radioaktive të krijuara në objektet shëndetësore, nuk janë në dispozicion dhe nuk mund të mblidhen. Ekziston një sasi mbeturinash e trashëguar nga e kaluara, e cila aktualisht ruhet dhe duhet të trajtohet në mënyrë të sigurt. Bazuar në vlerësimin e hartuesve të PSMMM, vlerësohet se rreth 1,870 m<sup>3</sup> mbetura farmaceutike ruhen aktualisht për trajtim të mëvonshëm.

Strategjia është e përshtatur në tri objektiva kryesore strategjike, përkatësisht: 1. Standardizimi i procedurave për menaxhimin e mbeturinave brenda sektorit të kujdesit shëndetësor; 2. Zhvillimi i shërbimeve të qëndrueshme dhe infrastrukturës së sigurt për menaxhimin e mbeturinave në sektorin e shëndetësisë; 3. Forcimi i kapaciteteve brenda sektorit të menaxhimit të mbeturinave medicinale (MMM). Strategjia ka vendosur objektiva specifike për avancimin e menaxhimit të mbeturinave të kujdesit shëndetësor deri në vitin 2030, shoqëruar me një buxhet total të vlerësuar prej 3.6 milion euro.

Trajtimi aktual i mbeturinave medicinale paraqet një sfidë të madhe dhe një kërcënim për mjedisin në Kosovë. Kjo është për shkak të disa faktorëve të ndërlidhur, duke përfshirë: dështimin për të përgatitur ose për t'iu përmbytur Planeve të Menaxhimit të Mbeturinave (PMM) brenda Objekteve të Kujdesit Shëndetësor (OKSh); mungesën e stafit të caktuar dhe të kualifikuar përgjegjës për menaxhimin e mbeturinave medicinale; dështimin në grumbullimin dhe raportimin sistematik të të dhënave përkatëse tek institucionet përgjegjëse, gjë që pengon vendimmarrjen e shëndoshë. Më e rëndësishmja, aktualisht një pjesë e konsiderueshme e mbeturinave infektive dhe të mprehta largohen nga sistemet e grumbullimit të ndarë dhe hyjnë në fraksionet e mbeturinave komunale - gjë që paraqet shqetësime serioze shëndetësore dhe mjedisore.

### 3.2.13 Fraksionet e tjera të mbeturinave

Kategoritë e mbeturinave të papërmendura përfshijnë një sërë artikujsh, si bojëra, detergjente, pesticide, plastikë, qelq, letër dhe karton, tekstile dhe kimikate.

Mbeturinat e qelqit shpesh i referohen çdo produkti qelqi që i ka shërbyer qëllimit të tyre original dhe duhet të deponohet në mënyrë të sigurt. Mbeturinat e qelqit mund të gjenerohen si nga burime

rezidenciale ashtu edhe nga ato tregtare, duke përfshirë ekonomitë familjare, industrinë, restorantet dhe bizneset. Ekzistojnë lloje të ndryshme mbeturinash qelqi, si shishe, kontejnerë ushqimesh dhe kavanoza, krahas qelqit që përdoret për ruajtjen e parfumeve.

Në Kosovë, riciklimi i qelqit nuk është i organizuar siç duhet. Nuk ka asnjë qendër grumbullimi dhe riciklimi të mbeturinave. Sipas të dhënave të fundit, është vetëm një kompani private që riciklon mbeturinat e qelqit. Për shkak të mungesës së infrastrukturës, pjesa më e madhe e mbeturinave të qelqit konsiderohen dhe kategorizohen si mbeturina komunale dhe dërgohen në deponi. Nuk ka të dhëna të sakta lidhur me sasinë e mbeturinave të qelqit që riciklohen në baza vjetore në Kosovë.

Mbeturinat plastike përfshijnë materialet plastike të hedhura me origjinë si nga proceset industriale ashtu edhe nga përdorimi i konsumatorëve. Kjo kategori përfshin një gamë të gjerë artikujsh plastike si ambalazhe, kontejnerë, produkte për një përdorim dhe materiale sintetike. Këta artikuj kanë arritur në fund të jetëgjatësisë së tyre të dobishme dhe më pas janë hedhur poshtë.

Në Kosovë ka mungesë të të dhënave në lidhje me sasinë e mbeturinave plastike që i nënshtrohen riciklimit. ASK raporton se në vitin 2022<sup>14</sup> janë ricikluar me sukses gjithsej 8519 ton mbeturina plastike. Veçanërisht, sektori joformal luan një rol kryesor në grumbullimin dhe riciklimin e plastikës, duke zbutur kështu vëllimin e mbeturinave të drejtuara në deponi.

Gjatë viteve të fundit, është vërejtur një prezencë në rritje e kompanive të specializuara në riciklimin e plastikës. Aktualisht në Kosovë funksionojnë rreth 20 kompani të licencuara nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. Këto kompani janë të angazhuara në grumbullimin dhe përpunimin e materialeve plastike. Një listë gjithëpërfshirëse e këtyre kompanive është në dispozicion në faqen e internetit të MMPHI, e ofruar ekskluzivisht në gjuhën shqipe.

Mbeturinat organike u përkasin materialeve të bio-degradueshme që vijnë nga organizmat e gjallë ose proceset organike. Këto materiale mbeturinash përbëhen nga komponime organike me bazë karboni, ose të qenësishme për qeniet e gjalla ose të krijuara prej tyre. Varietetet që përfshihen në kuadrin e mbeturinave organike përfshijnë:

- Mbeturinat ushqimore
- Mbeturinat e kopshtit
- Mbeturinat bujqësore

Përkundër këtyre kategorive, praktika e kompostimit të mbeturinave nuk ka fituar ende vëmendje në Kosovë. Përpjekjet fillestare në nivel komunal janë ndërmarrë në Komunën e Prishtinës. Në mars të vitit 2023 ka filluar funksionalizimi i Qendrës së Kompostimit nën menaxhimin e Ndërmarrjes Publike "Hortikultura". Megjithatë, nuk ka në dispozicion të dhëna konkrete për vëllimin e mbeturinave që janë kompostuar me sukses në këtë qendër.

Duke pasur parasysh që një mekanizëm gjithëpërfshirës i ndarjes së mbeturinave nuk është ende plotësisht funksional në Kosovë, informacioni në lidhje me grumbullimin dhe riciklimin e këtyre kategorive specifike të mbeturinave është i pakët. Megjithëse riciklimi i këtyre formave të mbeturinave ka ndikime të mundshme pozitive, një vlerësim gjithëpërfshirës i rezultateve kërkon analiza të zellshme dhe studime të plota.

Mbeturinat e letrës dhe kartonit i referohen materialeve të hedhura të bëra kryesisht nga letra dhe kartoni, të cilat zakonisht përdoren për paketim, printim dhe qëllime të tjera të ndryshme.

Duke pasur parasysh se nuk ka kontejnerë të veçantë për këtë lloj mbeturinash, ato zakonisht grumbullohen me mbeturina të tjera komunale dhe dërgohen në deponi.

---

<sup>14</sup> Anketa e mbeturinave të trajtuara (2022), shih në: [Mbeturinat e trajtuara sipas llojit sipas Viti, Mbeturinat dhe Variabla. SiteTitle \(rks-gov.net\)](#)

Nga viti 2010 deri në vitin 2019, rreth 10 kompani për menaxhimin e letrës dhe kartonit janë licencuar nga MMPHI. Sipas të dhënave më të fundit të siguruara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, sasia e letrës dhe kartonit të ricikluar për vitin 2022 ishte 10,839 ton.<sup>15</sup> Një pjesë e madhe mbledhet edhe nga sektorët joformalë dhe dërgohet në qendrat e riciklimit. Materiali dorëzohet në qendrat në të cilat dërguesi kompensohet me një shumë simbolike parash (rreth 0.05 €/kg).

Mbeturinave të tekstilit i referohen materialeve dhe produkteve të bëra nga pëlhura dhe tekstile që janë hedhur poshtë dhe nuk janë më të dëshirueshme ose të përdorura, të tilla si veshje, aksesore, liri dhe objekte të tjera me bazë tekstili.

Kosovës i mungojnë objektet dhe sistemet e nevojshme për riciklim efektiv të tekstilit. Në nivel lokal, një projekt i financuar nga BE i quajtur "SEREC" është duke u zhvilluar në mënyrë aktive që nga viti 2021. Ky projekt synon të adresojë sfidën, duke nxitur një ekonomi qarkore dhe duke lehtësuar zhvillimin e ndërmarrjeve sociale përmes riciklimit dhe ripërdorimit të mbeturinave të tekstilit. Ky fraksion i mbeturinave buron nga pikat e caktuara grumbulluese të vendosura në kuadër të Komunës së Pejës.

### 3.3 Analiza

Situata bazë në sektorin e mbeturinave të ngurta komunale është analizuar duke përdorur indikatorët e standardit 'Wasteaware' (WABI) për MIMN. Rezultatet e vlerësimit janë futur në strategji me të dhënat e performancës për vitin 2018. Përditësimi aktual ofron performancën bazuar në të dhënat e AMMK-së për vitin 2021. Grafikët e mëposhtëm ofrojnë një krahasim vizual të performancës rreth 3 komponentëve fizikë dhe 3 faktorëve qeverisës të listuar më poshtë.



WABI janë bërë një standard ndërkombëtar për vlerësimin e performancës së shërbimit bazuar në tregues. Treguesit ndihmojnë në identifikimin e prioriteteve dhe matjen e ndryshimit në MIMN. WABI po përdoren gjithnjë e më shumë si mjet matës për menaxhimin e mbeturinave dhe performancën e sektorit të riciklimit.

Indikatorët e vlerësimit të cilësisë së performancës


| I LARTË   | MESATAR/ I LARTË | MESATAR  | I ULËT/MESATAR | I ULËT  |
|-----------|------------------|----------|----------------|---------|
| 81 - 100% | 61 - 80%         | 41 - 60% | 21 - 40%       | 0 - 20% |

|                       |    |                                                           | Indikatori standard                                                         | 2018 | 2021 |
|-----------------------|----|-----------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------|------|------|
| Komponentët fizikë    | 1  | Shëndeti publik – grumbullimi i mbeturinave               | Mbulimi me shërbimin e grumbullimit të mbeturinave                          | 71   | 90   |
|                       | 1C |                                                           | Cilësia e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave                          | 74.3 | 75   |
|                       | 2  | Kontrolli mjedisor – përpunimi dhe deponimi i mbeturinave | Përpunimi dhe deponimi i kontrolluar                                        | 63   | 84   |
|                       | 2E |                                                           | Shkalla e mbrojtjes së mjedisit në objektet e përpunimit dhe deponimit      | 66   | 46   |
|                       | 3  | Menaxhimi i burimeve – Redukto, Ripërdor, Riciklo         | Përqindja e riciklimit                                                      | 3.3  | 4    |
|                       | 3R |                                                           | Cilësia e 3 R-ve - Redukto, Ripërdor, Riciklo                               | 21   | 21   |
| Faktorët e qeverisjes | 4U | Gjithëpërfshirje                                          | Gjithëpërfshirja e përdoruesve                                              | 50   | 54   |
|                       | 4P |                                                           | Gjithëpërfshirja e ofruesit                                                 | 50   | 60   |
|                       | 5F | Qëndrueshmëria financiare                                 | Qëndrueshmëria financiare                                                   | 71   | 67   |
|                       | 6N | Institucione të shëndosha, politika proaktive             | Përshtatshmëria e kornizës kombëtare të menaxhimit të mbeturinave të ngurta | 58   | 75   |
|                       | 6L |                                                           | Koherencë institucionale lokale                                             | 54   | 71   |

<sup>15</sup> Anketa e mbeturinave të trajtuara (2022), shih në: [Mbeturinave të trajtuara sipas llojit sipas Viti, Mbeturinave dhe Variabla. SiteTitle \(rks-gov.net\)](#)



Performanca e vitit **2018**



Performanca e vitit **2021**

Vlerësimi tregon përmirësime në performancë nga viti 2018, veçanërisht në mbulimin e grumbullimit të mbeturinave me 19% dhe aspekte të qeverisjes si legjislacioni dhe institucionet. Megjithatë, niveli i ndarjes së mbeturinave në burim dhe i riciklimit mbetet shumë i ulët. Profilizimi i sektorit të mbeturinave të ngurta komunale në Kosovë duke përdorur WABI identifikon prioritetet e mëposhtme.

1. Përmirësimet duhet të fokusohen në qeverisjen si dhe në aspektet teknike.
2. Shërbimet e grumbullimit janë përmirësuar ndjeshëm, prandaj fokusi mund të zhvendoset në detyra më komplekse, të tilla si ndarja në burim
3. Ekziston potenciali për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të trajtimit dhe deponimit të mbeturinave.
4. Vetëm një pjesë shumë e vogël e mbeturinave riciklohet dhe përpunohet.
5. Duhet bërë më shumë punë për t'i përfshirë përdoruesit dhe ofruesit e shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave në sistem.
6. Qëndrueshmëria financiare është brenda kufijve, por ende e jo e plotë/pasiguruar.
7. Ekzistojnë politikat dhe institucionet, por kapacitetet duhet të forcohen.

Në përgjithësi mungojnë të dhëna për fraksionet e tjera të mbeturinave dhe për këtë arsye një pasqyrë e plotë e gjendjes aktuale është e paqartë për momentin.

### 3.1 Përmbledhje

Tabela më poshtë liston disa nga çështjet më kritike që përballen në sektorin e menaxhimit dhe riciklimit të mbeturinave dhe reagimin strategjik që duhet marrë parasysh.

| Aspekti                              | Çështja kritike                                                                                                                                     | Reagimi strategjik                                                                                                                                                            |
|--------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Shërbimet dhe infrastruktura         | Shërbimet e grumbullimit të mbeturinave të ngurta komunale janë përmirësuar, por ende nuk janë shtrirë në të gjithë popullsinë                      | Të vendoset mbulimi 100% me shërbim si objektiv dhe të mbështetet me mbulim të shtuar të mbledhjes së tarifave, financimit të dedikuar dhe stimujve                           |
|                                      | Deponitë rajonale që nuk mbulojnë kostot e funksionimit dhe mirëmbajtjes dhe nuk përmbushin standardet mjedisore.                                   | Të bëhet planifikim në nivel rajonal dhe të investohet në impiante të përbashkëta, të përmirësohen mekanizmat e pagesave për shërbimet rajonale të deponive                   |
|                                      | Limitim i ndjeshëm i kapacitetit të deponive                                                                                                        | Të zhvillohet rrjeti i stacioneve të transferit, trajtimit dhe deponimit të mbeturinave                                                                                       |
|                                      | Mungesa e objekteve/impianteve për mbeturinat e ndërtimit dhe rrënim                                                                                | Të instalohen objekte të menaxhimit të MNRr bazuar në planin kombëtar të miratuar                                                                                             |
|                                      | Rreziqet e ndotjes së mjedisit, shëndetit dhe sigurisë nga mbeturinat e kafshëve dhe mbeturinat e kujdesit shëndetësor që hyjnë në fraksionin e MNK | Të fuqizohen sistemet e menaxhimit për mbeturinat e tjera                                                                                                                     |
| Kushtet kornizë të sektorit          | Korniza ligjore gjithëpërfshirëse, por jo e harmonizuar me menaxhimin e integruar të mbeturinave dhe standardet e BE-së                             | Të përditësohet dhe rregullohet korniza ligjore                                                                                                                               |
|                                      | Organizatat nuk kanë kapacitete të mjaftueshme institucionale dhe individuale për ta nxitur zhvillimin e sektorit                                   | Të alokohen burime adekuatë dhe të fuqizohen kapacitetet                                                                                                                      |
|                                      | Ekonomitë e shkallës ndërmjet komunave ende të pa eksploruara dhe zbatuara                                                                          | Të bëhet planifikimi në nivel rajonal dhe të nxitet bashkëpunimi ndërkomunal                                                                                                  |
|                                      | Rolet dhe përgjegjësitë ekzistuese institucionale pengojnë progresin në këtë sektor                                                                 | Të analizohet, konceptohet dhe reformohet korniza ekzistuese institucionale për të mundësuar efikasitet dhe për të mundësuar transformimin e sektorit drejt ekonomisë qarkore |
| Implementimi, zbatimi dhe financimi  | Mekanizmat e lejeve, raportimit dhe zbatimit janë joefektive për ta mbështetur zhvillimin e sektorit                                                | Të rishikohen dhe fuqizohen mekanizmat e lejeve, raportimit dhe zbatimit                                                                                                      |
|                                      | Financimi i investimeve dhe operacioneve nuk është i mjaftueshëm                                                                                    | Të rriten mekanizmat e mbulimit të kostos dhe investimit                                                                                                                      |
|                                      | Mungesa e angazhimit të sektorit privat                                                                                                             | Të promovohen dhe nxiten rolet e akterëve të sektorit privat në zhvillimin e sektorit                                                                                         |
| Reduktimi, ripërdorimi dhe riciklimi | Ndërgjegjësimi i ulët i publikut për mundësitë dhe avantazhet e Ekonomisë Qarkore (EQ)                                                              | Të popullarizohen konceptet e EQ përmes ndërgjegjësitimit, edukimit dhe hulumtimit publik.                                                                                    |
|                                      | Përmbushja e treguesve evropiane të ekonomisë qarkore duket perspektivë e largët.                                                                   | Të nisë procesi i stimulimit të të menduarit për "ekonominë qarkore", duke përfshirë parandalimin e                                                                           |

|  |                                                                                                        |                                                                                                                                                                                             |
|--|--------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|  |                                                                                                        | mbeturinave, ripërdorimin dhe riciklimin.                                                                                                                                                   |
|  | Implementim i kufizuar i detyrimit të PZP nga biznesi në lidhje me fraksionet e veçanta të mbeturinave | Të miratohet një ligj i ri në përputhje me acquis të BE-së për PZP dhe të zbatohen dispozitat e tij në periudhën afatmesme                                                                  |
|  | Infrastruktura aktuale nuk mbështet ndarjen në burim                                                   | Të bëhet planifikimi, të bëhen investime dhe funksionalizimi i objekteve lokale dhe rajonale të ndarjes dhe trajtimit të mbeturinave për të mundësuar ndarjen dhe riciklimin e mbeturinave. |
|  |                                                                                                        |                                                                                                                                                                                             |

## 4 Objektivat

### 4.1 Vizioni


Vizioni i kësaj Strategjie është:

*Të mbrohet shëndeti publik dhe të zvogëlohet ndikimi i mbeturinave në mjedis, duke nxitur njëkohësisht mundësitë për biznes dhe punësim dhe tranzicion drejt një ekonomie qarkore të harmonizuar me normat dhe standardet evropiane.*

Strategjia synon t'i adresojë mangësitë dhe kufizimet aktuale në sektorin e menaxhimit të mbeturinave duke vendosur dhe përmbushur katër objektivat strategjike të mëposhtëm. Përmbushja e këtyre objektivave strategjike do të luajë një rol në shtyrjen e Kosovës përpara drejt potencialeve ekonomike evropiane dhe standardeve të jetesës.

### 4.2 Objektivat strategjike dhe specifike

Objektivat strategjike dhe specifike për këtë Strategji të Menaxhimit të Integruar të Mbeturinave janë përcaktuar nëpërmjet një analize të problemeve dhe shkaqeve të tyre, siç janë përshkruar në kapitullin 3. Ato janë të strukturuar në katër dimensione strategjike. Përmirësimi i kushteve kornizë dhe forcimi i kapaciteteve të implementimit si dhe financimi dhe zbatimi i ligjit mbështet zhvillimin e qëndrueshëm të shërbimeve dhe infrastrukturës së integruar të menaxhimit të mbeturinave. Ato të kombinuara formojnë bazën për një tranzicion gradual por të qëndrueshëm drejt ekonomisë qarkore në sektorin e MMB.



| Problemet dhe shkaktarët e tyre                                                                                                                            |   | Objektivat strategjike dhe specifike                                                                                                                                                                                                                   |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>PROBLEMI:</b> Mbeturinat nuk menaxhohen për shkak të mangësive në shërbim dhe mangësive në infrastrukturë.                                              | → | <b>Objektivi strategjik:</b> Iniciimi i shërbimeve dhe infrastrukturës për menaxhimin e integruar të mbeturinave.                                                                                                                                      |
| <b>SHKAKU:</b> Mungesa e mbulimit me shërbim dhe efikasiteti i ulët i shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave.                                           | → | <b>Objektivi specifik:</b> Ofrimi i shërbimeve të përshtatshme dhe të qëndrueshme të grumbullimit të mbeturinave të ngurta komunale për të gjithë gjeneruesit e mbeturinave.                                                                           |
| <b>SHKAKU:</b> Rrjeti i papërshtatshëm i objekteve për menaxhimin e mbeturinave për trajtimin dhe deponimin e mbeturinave komunale.                        | → | <b>Objektivi specifik:</b> Zhvillimi i sistemeve dhe impianteve të integruara, për përpunimin dhe deponimin e mbeturinave komunale.                                                                                                                    |
| <b>SHKAKU:</b> Fraksionet e tjera të mbeturinave hyjnë në fraksionin e mbeturinave komunale duke i ngarkuar barrë shtesë komunave ose nuk menaxhohen fare. | → | <b>Objektivi specifik:</b> Zhvillimi i shërbimeve dhe infrastrukturës së përshtatshme për mbeturinat nga aktivitetet industriale, mbeturinat e ndërtimit dhe rrënimit (MNRr), mbeturinat e rrezikshme dhe fraksionet e tjera specifike të mbeturinave. |

| Problemet dhe shkaktarët e tyre                                                                                                                                                            |   | Objektivat strategjike dhe specifike                                                                                                                         |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>PROBLEMI:</b> Korniza rregullatore, struktura organizative dhe kapacitetet institucionale nuk mbështesin zhvillimin e nevojshëm të sektorit                                             | → | <b>Objektivi strategjik:</b> Përmirësimi i kornizës rregullatore, planifikuese dhe institucionale për menaxhimin e mbeturinave dhe burimeve.                 |
| <b>SHKAKU:</b> Korniza ligjore nuk mbulon të gjitha aspektet e një sistemi modern për menaxhimin e integruar të mbeturinave                                                                | → | <b>Objektivi specifik:</b> Miratimi i kornizës ligjore të përditësuar dhe krijimi i mekanizmave të implementimit dhe forcimit të ligjit.                     |
| <b>SHKAKU:</b> Kapacitetet institucionale në nivel kombëtar dhe lokal dhe profesionistët e aftë që punojnë në sektorin e menaxhimit dhe riciklimit të mbeturinave nuk janë të mjaftueshme. | → | <b>Objektivi specifik:</b> Alokimi i burimeve adekuate njerëzore dhe teknike për institucionet kompetente dhe fuqizimi i vazhdueshëm i kapaciteteve të tyre. |
| <b>SHKAKU:</b> Mungesa e mekanizmave për promovimin e bashkëpunimit ndërmjet komunave për të eksploruar efektet e ekonomisë së shkallës                                                    | → | <b>Objektivi specifik:</b> Krijimi i një kornize të planifikimit ndër-komunal dhe procedurave të qarta për të nxitur bashkëpunimin ndër-komunal.             |

| Problemet dhe shkaktarët e tyre                                                                                                     |   | Objektivat strategjike dhe specifike                                                                                                                  |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>PROBLEMI:</b> Zhvillimi i sektorit pengohet nga kapaciteti i dobët zbatimit të ligjit dhe zbatues dhe financimi i pamjaftueshëm. | → | <b>Objektivi strategjik:</b> Përmirësimi i kapaciteteve implementuese, ligjzbatuese dhe financuese në sektorin e menaxhimit të mbeturinave.           |
| <b>SHKAKU:</b> Mekanizmat e lejeve, raportimit dhe zbatimit të ligjit nuk ofrojnë zbatim efikas të ndonjë sistemi të përmirësuar    | → | <b>Objektivi specifik:</b> Krijimi i sistemeve gjithëpërfshirëse dhe funksionale të lejeve, raportimit dhe zbatimit të ligjit.                        |
| <b>SHKAKU:</b> Mekanizmat aktualë të financimit nuk mbulojnë plotësisht nevojat për investime dhe operacionale.                     | → | <b>Objektivi specifik:</b> Promovimi i mekanizmave për mbulimin e plotë të kostos dhe rritja e investimeve në sektor.                                 |
| <b>SHKAKU:</b> Sektori privat nuk është mjaftueshëm i angazhuar në shërbimet e lidhura me mbeturinat dhe riciklimin.                | → | <b>Objektivi specifik:</b> Krijimi i kushteve për ta tërhequr përfshirjen e sektorit privat në investimet në infrastrukturë dhe ofrimin e shërbimeve. |

| Problemet dhe shkaktarët e tyre                                                                                                                                        |   | Objektivat strategjike dhe specifike                                                                                                                                                          |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>PROBLEMI:</b> Si ekonomi në zhvillim, Kosova nuk mund ta përballojë humbjen e burimeve përmes praktikave lineare të menaxhimit të mbeturinave                       | → | <b>Objektivi strategjik:</b> Iniciimi i tranzicionit të Kosovës drejt ekonomisë qarkore duke maksimizuar shfrytëzimin e burimeve/materialeve nga sektori i mbeturinave                        |
| <b>SHKAKU:</b> Sektori nuk e konsideron ende parandalimin dhe efikasitetin e burimeve/materialeve.                                                                     | → | <b>Objektivi specifik:</b> Mbështetja për parandalimin e mbeturinave dhe përmirësimin e efikasitetit të burimeve.                                                                             |
| <b>SHKAKU:</b> Sektori i menaxhimit të mbeturinave nuk ofron asnjë stimul apo detyrim për t'i rritur normat e përpunimit të materialeve.                               | → | <b>Objektivi specifik:</b> Rritja e grumbullimit të ndarë, ripërdorimit dhe riciklimit nga caqet e performancës, instrumentet ekonomike dhe skemat e përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit. |
| <b>SHKAKU:</b> Prodhuesit e mbeturinave nuk janë mjaftueshëm të angazhuar në reduktimin e sasive të mbeturinave, ndarjen e mbeturinave dhe parandalimin e mbeturinave. | → | <b>Objektivi specifik:</b> Ngritja e vetëdijesimit për rëndësinë dhe dobitë e menaxhimit dhe riciklimit të duhur të mbeturinave dhe stimulimi i ndryshimit të sjelljes.                       |
| <b>SHKAKU:</b> Njohuri dhe aktivitete të kufizuara për të mbështetur modelet rrethore nga të gjithë akterët.                                                           | → | <b>Objektivi specifik:</b> Rritja e përfshirjes së akterëve ekonomikë dhe institucioneve arsimore dhe kërkimore në përhapjen dhe                                                              |

|  |  |                                                 |
|--|--|-------------------------------------------------|
|  |  | zbatimin e praktikave dhe inovacioneve qarkore. |
|--|--|-------------------------------------------------|

Objektivat strategjike dhe specifike i shtohen një agjende reforme gjithëpërfshirëse dhe të arritshme për sektorin e mbeturinave. Në përgjithësi, ato ofrojnë një përgjigje kuptimplote, të zbatueshme dhe të pajtueshme për adresimin e problemeve aktuale në sektorin e mbeturinave.

|                                                                                                                                                                                       |                                                                                                                                                                                                                                                |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Shërbimet dhe infrastruktura</b><br><br>Shërbimet e grumbullimit të mbeturinave<br><br>Objektet për menaxhimin e integruar të mbeturinave<br><br>Fraksionet e tjera të mbeturinave | <b>Kushtet kornizë</b><br><br>Korniza ligjore<br><br>Organizimi dhe kapacitetet institucionale<br><br>Bashkëpunimi ndërkomunal                                                                                                                 |
| <b>Implementimi, zbatim i ligjit dhe financimi</b><br><br>Lejet, zbatim i ligjit dhe raportimi<br><br>Mekanizmat e mbulimit të kostos<br><br>Angazhimi i sektorit privat              | <b>Ekonomia qarkore</b><br><br>Parandalimi i mbeturinave dhe efikasiteti i përdorimit të burimeve/materialeve<br><br>Rritja e normave të përpunimit të materialeve<br><br>Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut<br><br>Promovimi i inovacionit |

#### 4.3 Caqet për grumbullim të ndarë, përgatitje për ripërdorim, riciklim dhe përpunim

Kosova ka si objektiv afatgjatë harmonizimin e legjislacionit të saj kombëtar dhe përmbushjen e kërkesave të Acquis të BE-së në sektorin e menaxhimit të mbeturinave. Për ta mbështetur zbatimin e hierarkisë së mbeturinave dhe reduktimin e dërgimit të mbeturinave në deponi, do të hartohet dhe miratohet legjislacioni i ri që përcakton objektivat sasiore për përgatitjen për ripërdorim, riciklim dhe përpunim të mbeturinave komunale, mbeturinave të ndërtimit dhe rrënimit dhe fraksioneve të veçanta të mbeturinave.

Në strategji gjithashtu njihet se për arritjen e niveleve të larta të riciklimit dhe përpunimit nevojiten ndryshime thelbësore në mënyrën se si organizohen shërbimet e menaxhimit të mbeturinave, rritje e ndërgjegjësimit dhe pjesëmarrjes së publikut në skemat e reja të grumbullimit të ndarë të mbeturinave dhe marrëveshje të reja financiare dhe instrumente ekonomike për t'i përballuar shpenzimet shtesë në zbatim. Do të jetë një proces i gjatë dhe i vazhdueshëm që do të zgjasë përtej periudhës së zbatimit të strategjisë aktuale dhe do të sigurojë vizionin për zhvillimin e ardhshëm të sektorit.

Caqet sasiore janë përcaktuar më poshtë - koha e të cilave reflekton, për aq sa është e mundur, parimet udhëzuese të strategjisë, objektivat strategjike dhe kufizimet.

#### 4.3.1 Përgatitja për caqet e ripërdorimit dhe riciklimit për mbeturinat komunale

Caqet për përgatitjen për ripërdorimin dhe riciklimin e mbeturinave komunale dhe për devijimin e mbeturinave komunale të përcaktuara për deponim sipas peshës së mbeturinave të krijuara janë përcaktuar për 2030, 2035 dhe 2045. Për arritjen e këtyre caqeve duhet të përcaktohen gjithashtu objektiva për banorët që kanë nevojë për shërbime të grumbullimit të ndarë të mbeturinave.

| Caku                                                                  | Deri në vitin 2030 | Deri në vitin 2035 | Deri në vitin 2045 |
|-----------------------------------------------------------------------|--------------------|--------------------|--------------------|
| Mbeturinat komunale të përgatitura për ripërdorim dhe riciklim        | 20%                | 50%                | 80%                |
| Deponimi i mbeturinave komunale                                       |                    | < 30 %             | < 10 %             |
| Popullsia pajiset me shërbime të grumbullimit të ndarë të mbeturinave | 80%                | 90%                | 100%               |

#### 4.3.2 Përgatitja për caqet e riciklimit për mbeturinat e ndërtimit dhe rrënimin

Përgatitja për ripërdorim, riciklim, dhe përpunim të mbeturinave jo të rrezikshme të ndërtimit dhe rrënimin, përfshirë punët e rimbushjes për të zëvendësuar materiale të tjera, do të rritet sipas peshës si më poshtë:

| Caku                                                                          | Deri në vitin 2030 | Deri në vitin 2035 |
|-------------------------------------------------------------------------------|--------------------|--------------------|
| Ripërdorimi dhe riciklimi i MNRr                                              | 40%                | 50%                |
| Përdorimi, riciklimi dhe metoda të tjera të përpunimit të materialeve të MNRr | 60%                | 70%                |

#### 4.3.3 Caqet për fraksionet specifike të mbeturinave

Përgatitja për ripërdorim, riciklim dhe përpunim të mbeturinave të paketimit duhet t'i arrijë caqet e mëposhtëm, të formuluar në lidhje me të gjitha ambalazhet e vendosura në treg në Kosovë dhe për materialet specifike të paketimit:

| Lloji i mbeturinave të paketimit                               | Deri në vitin 2028 | Deri në vitin 2030 | Deri në vitin 2035 |
|----------------------------------------------------------------|--------------------|--------------------|--------------------|
| Përpunimi i të gjitha mbeturinave të paketimit                 | 45%                | 60%                | 70%                |
| Riciklimi i të gjitha mbeturinave të paketimit, duke përfshirë | 40%                | 55%                | 65%                |
| plastikë                                                       | 22.5%              | 30%                | 50%                |
| letër dhe karton                                               | 60%                | 70%                | 75%                |
| qelq                                                           | 30%                | 50%                | 70%                |
| metalet me ngjyra                                              | 30%                | 50%                | 70%                |

|        |     |     |     |
|--------|-----|-----|-----|
| alumin | 30% | 40% | 50% |
| dru    | 10% | 15% | 25% |

Do të përcaktohen caqe shtesë për grumbullimin e ndarë, përgatitjen për ripërdorimin dhe riciklimin e MPEE, baterive dhe akumulatorëve, gomave të përdorura, mbeturinave të vajrave, automjeteve të vjetruara dhe tekstilit.

#### 4.4 Objektivi Strategjik 1: Inicimi i shërbimeve dhe infrastrukturës për menaxhimin e integruar të mbeturinave

##### Objektivi strategjik 1

###### Inicimi i shërbimeve dhe infrastrukturës për menaxhimin e integruar të mbeturinave

- Nevojiten investime publike të vazhdueshme në shërbime dhe infrastrukturë për t'i menaxhuar mbeturinat komunale dhe disa mbeturina të tjera. Me kalimin e kohës, duhet të bëhen investime nga të ardhurat e mbledhura për shërbimet e menaxhimit të mbeturinave, mirëpo në këtë fazë të ardhurat janë të pamjaftueshme për t'i mbuluar nevojat dhe ekziston një boshllëk i qartë financiar. Si rezultat, menaxhimi i mbeturinave në Kosovë mbështetet në mënyrë të konsiderueshme nga mbështetjen përmes granteve dhe kredive koncesionare nga partnerët ndërkombëtarë për zhvillim, për ta plotësuar financimin në dispozicion.
- Shërbimet e menaxhimit të mbeturinave fillojnë me grumbullimin/grumbullimin e ndarë të materialeve nga ekonomitë familjare, bizneset dhe institucionet. Për të kryer këto detyra nevojiten automjete dhe pajisje, dhe këto asete duhet të mirëmbahen dhe zëvendësohen me kalimin e kohës. Burimi kryesor i financimit për blerjen/zëvendësimin e automjeteve dhe pajisjeve duhet të jenë tarifat e mbeturinave, mirëpo, në një periudhë afatshkurtër parashikohet një mbështetje e financimit me grante.
- Për arritjen e përgatitjes për caqet e ripërdorimit, riciklimit dhe devijimit nga deponitë për mbeturinat komunale duhet të ngritjen sisteme të grumbullimit të ndarë të mbeturinave për fraksione të ndryshme të mbeturinave komunale. Zhvillimi i grumbullimit të ndarë dhe klasifikimit të mbeturinave për mallrat mbeturinë të riciklueshme, si letra dhe kartoni, plastika, qelqi dhe metalet do të financohet nëpërmjet skemave të reja të përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit për mbeturinat e paketimit dhe fraksionet tjera të veçanta të mbeturinave.
- Komunat do të jenë gjithashtu përgjegjëse për ta mbështetur kompostimin në shtëpi në zonat me shtëpi familjare dhe aty ku është e nevojshme për organizimin e grumbullimit të ndarë dhe kompostimit të mbeturinave të gjelbra të krijuara në territoret e tyre. Në planin afatgjatë, grumbullimi i ndarë i mbeturinave ushqimore do të krijohet të paktën në zonat urbane së bashku me objektet e përshtatshme të përpunimit në nivel rajonal.
- Deponimi i mbeturinave në deponi do të mbetet opsioni kryesor gjatë viteve të para të zbatimit të strategjisë. Të gjitha deponitë rajonale duhet t'i përmbushin standardet teknike të fundit deri në vitin 2027 dhe të garantojnë që mbeturinat të hidhen pa shkaktuar rrezik për mjedisin dhe shëndetin e njerëzve. Në planin afatgjatë, reduktimi i mëtejshëm i deponimit të mbeturinave komunale do të arrihet përmes krijimit të objekteve rajonale të Trajtimit Mekanik-Biologjik (TMB). Për Karburantin që Rrjedh nga Mbeturinat (KRrM) e prodhuara nga këto objekte do të nevojitet ngritja e një Impianti të Centralizuar të Përpunimit të Mbeturinave për Energji (WtE) ose të përpunohen si lëndë djegëse alternative në industrinë e çimentos.
- Pritet që investimet e granteve të rrjedhin natyrshëm drejt atyre objekteve dhe shërbimeve publike që funksionojnë në baza rajonale/ndër-komunale, pasi këto do të japin ndikimin dhe qëndrueshmërinë më të madhe.

- Industria do të jetë përgjegjëse për të garantuar ruajtjen, përpunimin dhe deponimin e sigurt të mbeturinave industriale të krijuara nga ndërmarrjet, për të përmirësuar efikasitetin e burimeve dhe për ta arritur përmbushjen e kërkesave ligjore.
- Infrastruktura për deponimin e mbeturinave të rrezikshme duhet të krijohet sipas *Udhërrëfyesit për Krijimin e Sistemit të Menaxhimit të Mbeturinave të Rrezikshme në Kosovë*. Pas kësaj duhet të realizohet analiza e fizibilitetit teknik dhe qëndrueshmërisë financiare për ndërtimin e instalimeve për trajtimin, përpunimin dhe deponimin e mbeturinave të rrezikshme. Ndërkohë, zgjidhjet për eksportin e mbeturinave të rrezikshme duhet të identifikohen në bazë të marrëveshjeve dypalëshe dhe në përputhje me dispozitat e Konventës së Bazelit.
- Infrastruktura e përshtatshme do të nevojitet gjithashtu për fraksione tjera të veçanta të mbeturinave, si mbeturinat e ndërtimit dhe rrënimin, mbeturinat e kujdesit shëndetësor dhe llumrat nga impiantet për trajtimin e ujërave të zeza. Infrastruktura e financuar nga publiku duhet të mobilizohet për ta mbështetur ndërtimin e infrastrukturës së tillë në mënyrë që këto fraksione të mbeturinave të mund të menaxhohen veçmas nga MNK, dhe në mënyrë që të përmirësohet performanca e menaxhimit të sistemit të MNK.

| Treguesit e Ndikimit                                                                                                             | Viti Bazë                                                              | Objektivi i ndërmjetëm | Objektivi përfundimtar |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------|------------------------|------------------------|
| <b>Përqindja totale e mbeturinave të gjeneruara të kontrolluara nëpërmjet sistemit të integruar të menaxhimit të mbeturinave</b> | Sistemi i integruar për menaxhim të mbeturinave nuk ekziston 0% (2024) | 30% (2028)             | 50% (2035)             |

#### 4.4.1 Zgjerimi i shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave komunale

##### Objektivi specifik 1.1

Ofrimi i shërbimeve të përshtatshme dhe të qëndrueshme të grumbullimit të mbeturinave të ngurta komunale për të gjithë gjeneruesit e mbeturinave.

- Grumbullimi i mbeturinave është një shërbim publik thelbësor, i nevojshëm për kushte të shëndetshme jetese të popullsisë dhe për ta mbrojtur cilësinë e mjedisit. Komunitat janë ligjërisht përgjegjëse për të siguruar ofrimin e shërbimeve të rregullta dhe të besueshme të grumbullimit të mbeturinave dhe duhet të sigurojnë performancën efikase dhe të qëndrueshme të këtyre shërbimeve.
- Gjatë viteve të fundit, Kosova tashmë ka shënuar rritje të konsiderueshme të mbulimit të popullsisë me shërbime të organizuara të grumbullimit të mbeturinave komunale që së fundi tejkalon 90% të të gjithë banorëve në vend.
- Komunitat mund të ofrojnë shërbime për grumbullimin e mbeturinave ose drejtpërdrejt vetë, ose përmes Kompanive Rajonale të Mbeturinave (KRM) ose përmes sektorit privat. Është detyrë e komunitet të vendosin për aranzhimin për operimin e shërbimeve, dhe të sigurojnë efikasitetin dhe qëndrueshmërinë e përgjithshme të shërbimit. Performanca e menaxhimit duhet të përmirësohet ndjeshëm ashtu që qëllimet e kësaj strategjie të realizohen.
- Ofrimi i shërbimeve ndërlikohet nga disa faktorë, duke përfshirë vështirësitë në mbledhjen e tarifave nga gjeneruesit e mbeturinave, vjetërsimi i automjeteve dhe pajisjeve, kostot e larta të mirëmbajtjes, nivelet relativisht të ulëta të ndërgjegjësimit të publikut, dhe kontaminimi i fraksionit të mbeturinave komunale me mbeturina nga ndërtimi dhe rrënimi, mbeturina të kafshëve dhe mbeturina të kujdesit shëndetësor. Zgjidhja e këtyre vështirësive kërkon një qeverisje të mirë. Komunitat duhet ta përmirësojnë performancën e tyre në mbledhjen e tarifave,

menaxhimin e ofrimit të shërbimeve, zëvendësimin e aseteve, ndërgjegjësimin e publikut dhe shmangien dhe pastrimin e mbeturinave të hedhura ilegalisht.

- Planet e reja ndër-komunale të menaxhimit të mbeturinave do të ofrojnë plan të qartë për zgjerimin e shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave komunale dhe modalitetet e zbatimit.
- Kontratat e Shërbimit Publik (KShP) do të futen për të rregulluar marrëdhëniet dhe standardet e shërbimeve ndërmjet komunave dhe KRM-së apo ofruesve të tjerë të shërbimeve.
- Në planin afatgjatë, për ta mbështetur parandalimin e mbeturinave dhe për të ofruar stimuj për ndarjen në burim, shërbimet komunale të grumbullimit të mbeturinave do të zhvendosen gradualisht nga vendet e kontejnerëve publikë në kazanë individuale që do t'i jepen çdo familjeje dhe do të mundësojë që tarifat e përdoruesit të përcaktohen sipas vëllimit ose peshës së mbeturinave të hedhura.

| Indikatori i rezultatit                                                                                                       | Viti Bazë    | Objektivi i ndërmjetëm | Objektivi përfundimtar |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------|------------------------|------------------------|
| Përqindja e popullsisë së përgjithshme me qasje në shërbime adekuate dhe të rregullta të grumbullimit të mbeturinave komunale | 90.2% (2021) | 98.5% (2028)           | 99% (2030)             |

#### 4.4.2 Sistemi i objekteve për përpunimin dhe deponimin e mbeturinave për mbeturinat komunale

##### Objektivi specifik 1.2

Zhvillimi i sistemeve dhe impianteve të integruara, për përpunimin dhe deponimin e mbeturinave komunale.

Kosova ka arritur një pikë ku kapaciteti i disponueshëm i deponive është në mungesë kritike. Duhet të merren masa urgjente për të zhvilluar një rrjet të integruar dhe adekuat të instalimeve për përpunimin dhe deponimin e mbeturinave komunale. Një rrjet i tillë garanton që mbeturinat të deponohen pa shkaktuar rrezik për mjedisin dhe shëndetin e njeriut dhe mbështetë rritjen e përgatitjes për ripërdorim, riciklim, përpunimin dhe devijimin e mbeturinave nga deponimi, në përputhje me caqet e vendosur. Në planin afat shkurtër, nevojitet gjithashtu përmirësimi dhe zgjerimi i deponive ekzistuese.

Gjatë përgatitjes së kësaj strategjie janë vlerësuar një sërë konfigurimesh të ndryshme të infrastrukturës së MNK-së në lidhje me fizibilitetin teknik dhe qëndrueshmërinë e tyre ekonomike. Analiza konfirmon qasjen rajonale të marrë në strategjinë e mëparshme për zhvillimin e Zonave rajonale për Menaxhimin e Mbeturinave (ZMM), secila prej tyre e shërbyer nga objektet e centralizuara të përpunimit dhe deponimit. Strategjia parasheh vazhdimin e zhvillimit të pesë Zonave për Menaxhimin e Mbeturinave (ZMM).

Në planin afatshkurtër, fokusi do të jetë në zhvillimin e skemave të grumbullimit të ndarë të mbeturinave për mbeturinat e riciklueshme që do të mbështeten përmes kërkesave të reja të përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit për paketimin e mbeturinave. Komunat do të duhet të organizojnë kompostimin e mbeturinave të gjelbra dhe mbeturinave të tjera të përshtatshme biologjike dhe të krijojnë objekte kompostimi të paktën për mbeturinat e grumbulluara nga zonat e gjelbra publike. Programet shtëpiake të kompostimit do të duhet të zbatohen në zonat rurale. Në nivel rajonal, lokacionet e deponive që u shërbejnë komunave në secilën ZMM do të përmirësohen në përputhje me standardet e fundit teknike. Paralelisht me këtë proces do të nisin edhe studimet e

fizibilitetit për ndërtimin e impianteve të TMB në secilën ZMM që pritet të bëhet funksionale në periudhën 2030 – 2032. Riciklimi i mëtejshëm do të arrihet përmes fillimit të zbatimit të grumbullimit të ndarë të mbeturinave ushqimore në zonat urbane dhe ndërtimit të impianteve të specializuara për tretje anaerobe.

Ngritja e objekteve të TMB-së do të rezultojë në prodhimin e sasive të konsiderueshme të Karburantit që Derivon nga Mbeturinat (KDM) dhe për përdorimin e tij nevojitet ndërtimi i impiantit të centralizuar nga mbeturinat-në-energji (MnE) ose bashkëpunimi i mundshëm me industrinë e çimentos.

Vendimi përfundimtar për llojin, vendndodhjen dhe kapacitetin e objekteve të trajtimit, ripërtëritjes dhe deponimit që do të krijohen do të merret me hartimin dhe miratimin e planeve ndër-komunale të menaxhimit të mbeturinave për çdo ZMM.

| Indikatori i rezultatit                                                                                                                                                                                                                        | Viti Bazë                                                                                                                         | Objektivi i ndërmjetëm | Objektivi përfundimtar |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------|------------------------|
| <b>Përqindja e totalit të mbeturinave të ngurta komunale të gjeneruara që menaxhohen në objekte të kontrolluara (përfshirë deponitë sanitare, dhe/ose impiantet për trajtim termik/biologjik dhe të përpunimit/riciklimit të materialeve).</b> | 90.2% (2021)<br>Deponi sanitare<br>0% (2021)<br>impiante për trajtim termik/biologjik dhe të përpunimit/riciklimit të materialeve | 75% (2028)             | 100% (2035)            |

#### 4.4.3 Menaxhimi i përmirësuar i mbeturinave industriale, mbeturinave të rrezikshme, mbeturinave nga N&Rr dhe fraksioneve tjera specifike të mbeturinave

##### Objektivi specifik 1.3

Zhvillimi i shërbimeve dhe infrastrukturës së përshtatshme për mbeturinat nga aktivitetet industriale, mbeturinat N&Rr (ndërtimit dhe rrënimit), mbeturinat e rrezikshme dhe fraksionet e tjera specifike të mbeturinave

Kjo strategji përfshin zhvillimin e shërbimeve dhe infrastrukturës për mbeturinat e tjera (jokomunale). Tashmë janë zhvilluar impiante për menaxhimin e ndarë të mbeturinave për mbeturinat e ndërtimit dhe rrënimit, mbeturinat e kujdesit shëndetësor dhe është përgatitur udhërrëfyesi për menaxhimin e mbeturinave të rrezikshme.

##### Mbeturinat nga ndërtimi dhe rrënimi

Mbeturinat nga Ndërtimi dhe Rrënimi (MNRr) të hedhura në mënyrë arbitrare nga rinovimet e ndërtesave dhe pronave mund të katalizojnë shpejt formimin e deponive lokale. Këto ndotin peizazhin, tërheqin mbeturina të tjera për t'u hedhur sipër tyre dhe përfundimisht bëhen baza për mbarështimin e dëmtuesve.

Një rrjet i integruar i objekteve të trajtimit dhe riciklimit do të ndërtohet në përputhje me dispozitat e planit të menaxhimit të MNRr të zhvilluar së fundmi dhe do të konfirmohet më tej në planet ndër-komunale të menaxhimit të mbeturinave. Praktikë e përmirësuar për rrënimin selektiv të ndërtesave, ndarja në burim të kantieret e ndërtimit dhe kontrolli i përmirësuar do të mbështesin gjithashtu arritjen e objektivave të riciklimit për MNRr.

Komunat janë përgjegjëse për organizimin dhe financimin e menaxhimit të MNRr në territoret e tyre, dhe mund t'ia delegojë operimin e këtyre objekteve KRMM-ve ose sektorit privat.

Për të qenë funksionale dhe të qëndrueshme, objektet e reja të menaxhimit të MNRR do të kenë nevojë për një rrjedhë të qëndrueshme të të ardhurave. Komunitatet do t'i përcaktojnë aranzhimet e tyre, me mundësi të përfshirjes së detyrimit të përdorimit të objekteve të menaxhimit të MNRR në procedurat e lejimit për projektet e ndërtimit dhe rrënit, duke specifikuar kërkesat për planet e menaxhimit të mbeturinave nga MNRR që do të dorëzohen si pjesë e dokumentacionit të projektimit për kategori ose madhësi të caktuara të projektit, dhe gjithashtu përdorimi i mundshëm i pagesave të obligacioneve ose garancive të detyrueshme financiare.

MMPHI do t'i shqyrtojë mundësitë për krijimin e kushteve të favorshme kornizë për përfshirjen e sektorit privat në përpunimin dhe riciklimin e MNRR qoftë nëpërmjet rregullores ose nëpërmjet kodeve të industrisë së ndërtimit. Gjithashtu do të shqyrtohen barrierat për përdorimin e materialeve të përpunuara dhe tejkalimin përmes një kombinimi të kërimit dhe zhvillimit, dhe klauzolat e mundshme ku kërkohet përmbajtje e detyrueshme e riciklueshme për materialet e ndërtimit të përdorura në projektet e infrastrukturës publike.

Do të jetë qenësor ndërtimi i komunikimit dhe ndërveprimit ndërmjet komunave, industrisë së ndërtimit dhe publikut. Menaxhimi i duhur i MNRR është i rëndësishëm për reputacionin dhe qëndrueshmërinë afatgjatë të industrisë së ndërtimit, dhe për këtë arsye pritet që industria të angazhohet me komunitet për të gjetur një zgjidhje të realizueshme në nivel lokal.

| Indikatori i rezultatit                                                                                                                | Viti Bazë | Objektivi i ndërmjetëm | Objektivi përfundimtar                                                      |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|------------------------|-----------------------------------------------------------------------------|
| Një rrjet i integruar i objekteve për trajtim dhe riciklim të MNRR, ndërtuar në përputhje me dispozitat e planit për menaxhimin e MNRR | 0 (2023)  | n/a                    | 5 objekte për trajtim dhe riciklim të MNRR-ve (1 objekt për një ZMM) (2035) |

#### Mbeturinat industriale

- Disa industri, si minierat, energjia dhe metalurgjia, gjenerojnë një sasi të konsiderueshme mbeturinash;
- Mungesa e aftësisë teknike për përpunimin ose deponimin e disa kategorive të mbeturinave çon në lirim dhe deponimin e pakontrolluar të llojeve të mbeturinave potencialisht të dëmshme;

Investimet e përgjithshme në lidhje me menaxhimin e mbeturinave janë shumë të kufizuara. Niveli aktual i shpenzimeve për menaxhimin e mbeturinave në të gjitha nivelet është i pamjaftueshëm dhe nuk garanton mbrojtjen e mjedisit dhe të shëndetit të njerëzve në tërësi. Zbatimi i hierarkisë së mbeturinave, duke inkurajuar parandalimin, ripërdorimin dhe riciklimin, nuk është arritur në praktikë për shkak të kushteve aktuale ekonomike dhe nivelit të vetëdijesimit për mjedisin. Kjo ka rezultuar në mungesën e riciklimit dhe përpunimit së lëndëve të para dytësore potencialisht të vlefshme dhe në përdorimin joefikas të lëndëve të para parësore.

Ndërmarrjet do të inkurajohen të marrin masa për ta përmirësuar efikasitetin e burimeve dhe për ta minimizuar gjenerimin e mbeturinave industriale nëpërmjet optimizimit të procesit.

Kjo mund të arrihet përmes prezantimit të proceseve dhe teknologjive të reja më të pastra dhe masave për reduktim në burim bazuar në praktikën e mira të mirëmbajtjes së mjedisit të brendshme, përmirësimin e inxhinierisë dhe mirëmbajtjes, ndryshimet teknologjike dhe ndryshimet në materialet dhe produktet hyrëse.

Gjeneruesve të mëdhenj të mbeturinave industriale do t'u kërkohet që të fillojnë zbatimin e auditimeve për minimizimin e mbeturinave, zbatimin e sistemeve të menaxhimit mjedisor (EMAS, ISO14001) dhe zhvillimin e impianteve për menaxhimin e mbeturinave të ndërmarrjeve formale.

Të gjithë operatorët e instalimeve të përpunimit ose deponimit të mbeturinave industriale do të jenë të detyruar të përgatisin plane për përputhshmërinë dhe të aplikojnë për autorizimet ose lejet përkatëse. Procedurat e VNM-së dhe të lejeve do të përdoren për ta arritur përbushjen e kërkesave të fundit ligjore dhe standardeve teknike dhe do të fokusohen në zbatimin e teknikave më të mira në dispozicion, siç përcaktohen në dokumentet BREF të BE-së për sektorët përkatës industrialë.

Shkëmbimi i mbeturinave brenda industrisë dhe simbioza industriale do të inkurajohen gjithashtu nëpërmjet zhvillimit të zonave industriale, platformave të shkëmbimit të të dhënave dhe projekteve pilot/demonstruese.

Do të ofrohet motivimi i duhur për riciklim/ripërdorim nëpërmjet zhvillimit të një infrastrukture për menaxhimin e mbeturinave industriale duke rezultuar në kosto më të larta për trajtimin dhe deponimin, dhe futjen e deponimit të mbeturinave me kosto të plotë.

Një parakusht për vlerësimin e rrezikut dhe rehabilitimin e operacioneve për mbeturinat industriale historike është të kuptojmë se ku janë këto vende, madhësia e tyre dhe natyra e mbeturinave të deponuara. Prandaj, do të kryhet një inventar i plotë për të adresuar vendndodhjen, llojin dhe natyrën e vendeve historike të deponimit industrial.

Qasja strategjike për prioritizimin e masave korigjuese do të jetë vlerësimi sasior i rrezikut. Qeveria e pranon se nuk është as e realizueshme dhe as realiste të mendohet për një pastrim të plotë të mbeturinave industriale të Kosovës për shkak të pengesave teknike si dhe kostove potencialisht të mëdha. Prandaj do të zbatohet një qasje sistematike e cila do të përfshijë: i) Identifikimi i Opsioneve të realizueshme të rehabilitimit; ii) Vlerësimi i detajuar i opsioneve (d.m.th. për të vendosur se cila nga opsionet e mundshme të rehabilitimit është më e përshtatshme); dhe iii) Strategjia e rehabilitimit

| Indikatori i rezultatit                                                                                       | Viti Bazë | Objektivi i ndërmjetëm                                                                 | Objektivi përfundimtar                                                                                                       |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|----------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Impiantet për përpunimin dhe deponimin e mbeturinave industriale funksionojnë sipas kërkesave të lejes</b> | n/a       | Inventari i vendeve të mbyllura për deponimin e mbeturinave industriale i kryer (2026) | Të gjithë gjeneruesit e mëdhenj të mbeturinave industriale kanë leje për operim, dhe operojnë sipas kërkesave të tyre (2028) |

#### Mbeturinat e rrezikshme

Është e njohur nevoja për ta përmirësuar praktikën e menaxhimit të mbeturinave të rrezikshme, veçanërisht masat për të shmangur dhe minimizuar gjenerimin e mbeturinave dhe nevoja për mjedise të përshtatshme për trajtimin dhe deponimin e mbeturinave.

Sigurimi i përshtatshmërisë së objekteve të nevojshme për ruajtjen, trajtimin dhe deponimin e mbeturinave të rrezikshme paraqet një sfidë të konsiderueshme. Përcaktimi i një ekuilibri optimal midis vetëmjaftueshmërisë së brendshme në përpunim dhe deponimin e MRr dhe eksporteve për përpunim në vende të tjera është një faktor kyç në përcaktimin e kërkesave për kapacitet kombëtar.

Eliminimi dhe minimizimi i mbeturinave do të jenë qasjet e preferuara për menaxhimin e mbeturinave të rrezikshme. Trajtimi dhe deponimi do të merren parasysh vetëm pasi të jenë shqyrtuar të gjitha opsionet e tjera. Zgjedhja do të varet përfundimisht nga lloji dhe sasia e mbeturinave të krijuara, madhësia e ndërmarrjes dhe kapaciteti i saj teknik dhe financiar.

Zbatimi i një politike dhe kornize ligjore të qartë për menaxhimin e mbeturinave të rrezikshme dhe kërkesa për përmbushjen e standardeve strikte mjedisore nga objektet që trajtojnë dhe deponojnë mbeturinat e rrezikshme. Kërkohej gjithashtu përcaktimi i qartë i përgjegjësisë statutores të institucioneve të përfshira në planifikimin, lejet, inspektimin, kontrollin dhe monitorimin e magazinimit, grumbullimit, trajtimit dhe deponimit të mbeturinave të rrezikshme.

Ndryshimi i sjelljes së organizatave që gjenerojnë dhe menaxhojnë mbeturina të rrezikshme është me rëndësi parësore në procesin e planifikimit dhe zbatimit të infrastrukturës së re të trajtimit dhe deponimit.

Masat e mëposhtme për menaxhimin e përmirësuar të mbeturinave të rrezikshme janë paraparë në përputhje me *Udhëzuesin e zhvilluar për Krijimin e Sistemit të Menaxhimit të Mbeturinave të Rrezikshme në Kosovë*:

- Nevojitet një inventar sistematik dhe koherent i mbeturinave të rrezikshme për të krijuar një pamje të saktë të fraksioneve të mbeturinave të rrezikshme në vend dhe për planifikimin e detajuar të sektorit;
- Kërkimi i përgjegjësisë nga gjeneruesit e mbeturinave të rrezikshme për të gjithë ciklin e menaxhimit të mbeturinave të rrezikshme deri në pikën e deponimit ose përpunimit përfundimtar të tyre;
- Krijimi i kapacitetit kombëtar për deponimin e mbeturinave të rrezikshme inorganike dhe organike, si tretës, acide, baza, mbeturina vajore dhe emulsione;
- Përcaktimi i një ekuilibri optimal midis vetëmjaftueshmërisë së brendshme në përpunimin dhe deponimin e mbeturinave të rrezikshme dhe eksportet e mbeturinave të rrezikshme në vende të tjera;
- Fillimi i zbatimit të kërkesave ekuivalente me Direktivën e BE-së për emetimet industriale;
- Zbatimi i skemave të grumbullimit të MRrSh në ekonomi familjare. Fillimi i zbatimit të një rrjeti gjithëpërfshirës të objekteve të qasshme lokale të dorëzimit të mbeturinave bëhet për të siguruar që gjeneruesit e vegjël të mbeturinave të rrezikshme të mbulohen me sistem efektiv të grumbullimit të mbeturinave; dhe
- Synimi i sektorëve specifikë tregtarë për një vëmendje të ngjashme prioritare, me fokus të veçantë në ato aktivitete që gjenerojnë sasi relativisht të mëdha mbeturinash të rrezikshme të pakontrolluara, p.sh. garazhet, ordinancat dentare dhe fermat.
- Sigurimi që leja operative për një objekt të përcaktojë periudhën maksimale gjatë së cilës mbeturinat e rrezikshme mund të mbahen në magazinim të përkohshëm. Periudha të tilla nuk duhet të zgjasin më shumë se një vit para operacioneve të deponimit të mbeturinave dhe tri vite përpara ripërtëritjes së mbeturinave;
- Prezantimi i detyrimit ligjor për gjeneruesit ose mbajtësit e mbeturinave të rrezikshme për të siguruar që përgjegjësia për menaxhimin e atyre mbeturinave t'i caktohet një personi të kualifikuar, teknikisht kompetent dhe përgjegjës;
- Sigurimi që të gjitha vendet e deponimit të mbeturinave të rrezikshme të inspektohen rregullisht;
- Të obligojë operatorin/pronarin e çdo deponie apo objekti për trajtim të përgatisë dhe të dorëzojë për miratim një program përputhshmërie për vazhdimin e operimit të deponisë;
- Sigurimi që operatori i objektit t'i mbulojë kostot e pajtueshmërisë;
- Fuqizimi i autoriteteve kombëtare për të vendosur periudha më të shkurtra mbylljeje për objektet që paraqesin rrezik për mjedisin ose shëndetin e njeriut;
- Mandatimi i operatorëve të objekteve të mbeturinave të rrezikshme që të bëjnë parashikime financiare formale për mbylljen përfundimtare dhe kostot e kujdesit pasues të vendit të tyre.

- Krijimi i infrastrukturës së duhur të grumbullimit të ndarë, riciklimit dhe përpunimit për fraksione të veçanta të mbeturinave të rrezikshme të mbuluara nga kërkesat për përgjegjësi të zgjeruar të prodhuesit, si bateritë dhe akumulatorët, kategoritë e caktuara të MPEE, mbeturinat e vajrave, etj.
- Ofrimi i mundësive dhe krijimi i procedurave për eksportin e mbeturinave të rrezikshme në bazë të marrëveshjeve dypalëshe me vendet fqinje dhe në përputhje me dispozitat e Konventës së Bazelit.

| Indikatori i rezultatit                                                                      | Viti Bazë                                                                                                                                                                   | Objektivi i ndërmjetëm                                                    | Objektivi përfundimtar                                                                                        |
|----------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Sistemet dhe infrastruktura për menaxhimin e mbeturinave të rrezikshme janë vendosur.</b> | Mbeturinat e rrezikshme të depozituara në territorin e ndërmarrjeve dhe pa infrastrukturë të përshtatshme për ruajtje, përpunim dhe deponim në nivel të përgjithshëm (2021) | Mundësia për eksportimin e mbeturinave të rrezikshme është krijuar (2026) | Grumbullimi i ndarë i mbeturinave të rrezikshme shtëpiake është vendosur në vendbanimet e mëdha urbane (2030) |

#### Mbeturinat Medicinale

Trajtimi aktual i Mbeturinave Medicinale (MM) paraqet një sfidë të madhe dhe një kërcënim mjedisor për Kosovën me vetëm 74% të totalit të MM të gjeneruara në vitin 2021 të trajtuara në mënyrë të sigurt në instalimet e licencuara. Kjo është për shkak të mungesës dhe respektimit të planeve të menaxhimit të mbeturinave në objektet e kujdesit shëndetësor.

Plani Strategjik për Menaxhimin e Mbeturinave Medicinale (PSMMM) në Kosovë përcakton objektivat e mëposhtme:

- Standardizimi i procedurave për menaxhimin e mbeturinave brenda objekteve të kujdesit shëndetësor
- Zhvillimi i shërbimeve të qëndrueshme dhe infrastrukturës së sigurt për menaxhimin e mbeturinave në sektorin e shëndetësisë
- Forcimi i kapaciteteve brenda sektorit të MMKSH, përmes burimeve të mjaftueshme njerëzore, ngritjes së kapaciteteve profesionale dhe përmirësimit të kontrollit dhe zbatimit

Aktivitetet kryesore përfshijnë:

- Përmirësimi i bashkëpunimit ndërsektorial përmes krijimit të Njesisë së Koordinimit të MKSh
- Hartimi dhe zbatimi i planeve gjithëpërfshirëse të menaxhimit të MKSh në nivel spitalor
- Zhvillimi i paketës së Procedurave Standarde të Operimit për trajtimin e MKSh
- Krijimi i një Komiteti funksional për Parandalimin e Infeksioneve (KPI)
- OKSh të mëdha duhet ta emërojnë një anëtar të lartë të stafit si Menaxher të Mbeturinave
- Blerja e një pajisjeje të standardizuar të mbeturinave dhe Pajisjeve Personale Mbrojtëse (PPM) bazuar në vlerësimin e nevojave
- Përfshirja e menaxhimit të mbeturinave kimike në sistemin MMKSH të sektorit shëndetësor
- Krijimi i një sistemi standard grumbullimi dhe trajtimi/deponimi për mbeturinat farmaceutike
- Zëvendësimi i autoklavave të vjetruara me të reja
- Përmirësimi dhe rehabilitimi i infrastrukturës ekzistuese të objekteve të trajtimit në Spitalet Rajonale (SR)

- Përgatitja e materialit trajnues dhe lansimi i trajnimit kombëtar mbi MMKSh për trajnerët (TiT) nga niveli terciar dhe i mesëm publik
- Institucionalizimi i MM duke përfshirë çështjet e MM në kurrikulën e shkollave mjekësore dhe universiteteve si dhe vendosjen e një sistemi certifikimi për menaxherët e mbeturinave në spitale
- Sigurimi i burimeve njerëzore të zgjeruara për të rritur numrin e inspektorëve për të promovuar përputhshmëri më të madhe

| Indikatori i rezultatit                                                      | Viti Bazë | Objektivi i ndërmjetëm | Objektivi përfundimtar                     |
|------------------------------------------------------------------------------|-----------|------------------------|--------------------------------------------|
| <b>Përqindja e MM të trajtuara sipas standardeve të përcaktuara në PSMMM</b> | 0% (2021) | n/a                    | PSMMM e aprovuar dhe duke u zbatuar (2026) |

#### Llumi nga impiantet për trajtimin e ujërave të zeza

Zhvillimi i Impianteve Komunale për Trajtimin e Ujërave të Zeza (IKTUZ) në Kosovë do të çojë në rritje të konsiderueshme të sasive të krijuara të llumit të ujërave të zeza. Për të garantuar menaxhimin e llumit pa shkaktuar rreziqe për mjedisin dhe shëndetin e njerëzve, IKTUZ duhet të pajiset me pajisje dhe objekte të përshtatshme për trajtimin e llumit dhe duhet të vendosen kërkesat e duhura për përdorim të sigurt të llumit në bujqësi. Strategjia parasheh masat e mëposhtme:

- Ndalimi i përdorimit të llumit të patrajtuar në tokën bujqësore, përveç rastit kur ai injektohet ose inkorporohet në tokë;
- Sigurimi i mbrojtjes nga rreziqet e mundshme shëndetësore nga patogjenët e mbetur, llumi nuk duhet të aplikohet në tokën në të cilën po rriten kulturat e frutave dhe perimeve, ose më pak se dhjetë muaj para korrjes së frutave dhe perimeve;
- Llumi duhet të përdoret në mënyrë të tillë që të merren parasysh kërkesat e bimëve për lëndë ushqyese dhe që cilësia e tokës dhe e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore të mos dëmtohet; dhe
- Duhet të parashtrihen kërkesat për mbajtjen e shënimeve të detajuara të sasive të llumit të prodhuar, sasive të përdorura në bujqësi, përbërjes dhe vetive të llumit, llojit të trajtimit dhe vendeve ku përdoret llumi;
- Do të vendosen kërkesat ligjore për kompostimin e prodhuar nga llumi i ujërave të zeza;
- Projektet e investimeve për rindërtimin e IKTUZ ekzistues dhe ndërtimin e IKTUZ-ve të reja do të përfshijnë gjithashtu pajisje dhe infrastrukturë për trajtimin e llumit në vend.

| Indikatori i rezultatit                                                          | Viti Bazë                                           | Objektivi i ndërmjetëm                                                                                                                                | Objektivi përfundimtar                                                                                               |
|----------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Llumi nga IKTUZ deponohet dhe përpunohet në përputhje me kërkesat ligjore</b> | 0 0 IKTUZ funksionale për trajtimin e llumit (2021) | Kërkesat për përdorimin e llumit nga IKTUZ në bujqësi dhe për kompostin e prodhuar nga llumi nga IKTUZ të përcaktuara në legjislacionin vendor (2026) | Të gjitha IKTUZ me kapacitet mbi 50,000 banorë ekuivalent janë të pajisura me impiante për trajtimin e llumit (2035) |

## 4.5 Objektivi strategjik 2: Kushtet kornizë

### Objektivi strategjik 2

#### Përmirësimi i kornizës rregullatore, planifikuese dhe institucionale për menaxhimin e mbeturinave dhe burimeve

Zhvillimi i sistemeve të menaxhimit të integruar të mbeturinave kërkon një kornizë të fuqishme, moderne dhe funksionale, të rregulloreve, institucioneve dhe procedurave të planifikimit. Objektivat dhe caqet e kësaj strategjie mund të arrihen vetëm kur:

- Korniza ligjore është në përputhje me praktikën e BE-së dhe ofron një strukturë dhe rregullore mbështetëse dhe të zbatueshme për sektorin e MMB-së,
- Procedurat e planifikimit janë konsistente ndërmjet niveleve të ndryshme të angazhimit dhe mbështesin bashkëpunimin e komunave për të arritur një nivel më të lartë të integritetit të shërbimeve dhe ekonomi më të mirë të shkallës për përpunimin, trajtimin dhe deponimin e mbeturinave,
- Institucionet dhe organizatat e tyre janë të afta të planifikojnë, zbatojnë dhe monitorojnë zhvillimin e sektorit.

| Indikatori i rezultatit                                                                                           | Viti Bazë                               | Objektivi i ndërmjetëm | Objektivi përfundimtar |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------|------------------------|------------------------|
| Niveli i përputhshmërisë së kornizave rregullatore, planifikuese dhe institucionale me kapacitetet e planifikuara | Kapacitetet janë duke u definuar (2021) | 80% (2026)             | 100% (2030)            |

### 4.5.1 Korniza rregullatore

#### Objektivi specifik 2.1

##### Miratimi i kornizës ligjore të përditësuar dhe krijimi i mekanizmave të implementimit dhe zbatimit të ligjit

Si pjesë e procesit të anëtarësimit në BE, Kosova synon ta harmonizojë legjislacionin e saj me normat dhe rregulloret e BE-së. Zhvillimet dinamike dhe synimet ambicioze në legjislacionin e BE-së kërkojnë përgjigje të shpejta dhe kuptimin e avancimeve të ardhshme për ta vendosur Kosovën në trajektoren e duhur dhe të arritshme drejt përputhshmërisë së plotë. Analiza e sektorit<sup>16</sup> përshkruan në detaje statusin e legjislacionit dhe hapat e nevojshëm për miratimin e një kornize rregullatore të përditësuar për sektorin e menaxhimit të mbeturinave. Fokusi më i fortë i është kushtuar krijimit të kushteve për modernizimin dhe përmirësimin e mekanizmave të implementimit dhe të zbatimit të ligjit. Zhvillimi është duke u udhëhequr duke i pasur në mendje vendosjen e hapave të arsyeshëm dhe të zbatueshëm drejt përputhshmërisë së plotë me burimet/financat në dispozicion. Zhvillimi i kornizës rregullatore ndërlihet fuqishëm me institucionet dhe organizatat, kapacitetet dhe ndërveprimet e tyre.

<sup>16</sup> Koncepti Dokumenti për sektorin e Menaxhimit të Mbeturinave është duke u zhvilluar gjatë kohës së hartimit të Strategjisë

| Indikatori i rezultatit                                                                             | Viti Bazë                              | Objektivi i ndërmjetëm | Objektivi përfundimtar |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------|------------------------|------------------------|
| Shkalla e miratimit të ndryshimeve rregullatore/ligjore bazuar në analizën e sektorit <sup>17</sup> | Koncept Dokumenti është duke u hartuar | 40% (2026)             | 100% (2030)            |

## 4.5.2 Organizimi dhe kapacitetet institucionale

### Objektivi specifik 2.2

Alokimi i burimeve adekuate njerëzore dhe teknike për institucionet kompetente dhe fuqizimi i vazhdueshëm i kapaciteteve të tyre

Për shumë vite, Kosova ka përfituar në mënyrë të konsiderueshme nga mbështetja e ofruar nga partnerët ndërkombëtarë për zhvillim, duke ngritur kapacitetet e sektorit të menaxhimit të mbeturinave. Mbështetja gjithëpërfshirëse ka përfshirë përgatitjen e kornizës ligjore dhe rregullatore, investimet në infrastrukturë dhe pajisje, përgatitjen e planeve dhe projekteve, të dhënat dhe proceset e menaxhimit, krijimin dhe trajnimin e operatorëve, dhe mbështetjen për rritjen e ndërgjegjësimit dhe niveleve të pjesëmarrjes së komunitetit.

Lëvizja e zhvillimit të sektorit drejt një administrimi të mbeturinave dhe burimeve të modernizuara, të orientuara nga ekonomia qarkore kërkon një përcaktim të qartë të roleve dhe përgjegjësive të institucioneve të përfshira në zbatimin dhe monitorimin e SKMIM. Një pasqyrë përmbledhëse e strukturës institucionale dhe roleve dhe përgjegjësive të organizatave të përfshira siç është shtjelluar në analizën e sektorit.

Fokusi do t'i kushtohet garantimit që organizatat e ngarkuara me zbatimin e strategjisë do të pajisen me burimet e nevojshme njerëzore dhe teknike. Kjo do të arrihet në përputhje me kërkesat e identifikuara në analizën e sektorit dhe vlerësimet tjera relevante.

Do të zhvillohen kompetenca për ta forcuar bashkëpunimin ndërkomunal. MMPHI dhe AMMK gjithashtu marrin mbështetje të mëtejshme për t'i konsoliduar kushtet kornizë të sektorit, me fokus në përmirësimin e rregullimit dhe kontrollit të mbeturinave komunale dhe mbeturinave tjera prioritare. Sektori i MMB do të zhvillojë dhe zbatojë një program gjithëpërfshirës të zhvillimit të kapaciteteve duke përfshirë të gjitha aspektet teknike, menaxheriale dhe rregullatore të zhvillimit të sektorit, duke marrë parasysh kapacitetet sektoriale, organizative dhe individuale.

Fushat ku do të vendoset mbështetja për zhvillimin e kapaciteteve përfshin, por nuk kufizohet në:

|                                                       |                                                                            |
|-------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------|
| Zbatimi i strategjisë së monitorimit                  | Zhvillimi i Standardeve dhe Udhëzimeve                                     |
| Menaxhimi i programit                                 | Përgatitja e projektit                                                     |
| Legjislacioni, rregulloret dhe aktet nënligjore       | Sistemi Informativ i Menaxhimit të Mbeturinave                             |
| Protokollet e rregullimit dhe kontrollit              | Procedurat e lejeve mjedisore përaktëse, dhënies së lejeve dhe inspektimit |
| Planifikimi i menaxhimit të integruar të mbeturinave  | Planet specifike të menaxhimit të mbeturinave                              |
| Menaxhimi i mbeturinave industriale dhe të rrezikshme | Sistemet e përgjegjësive të zgjeruar të prodhuesit                         |
| Sistemet e rimbursimit të depozitave (DRS)            | Ekonomia dhe financa                                                       |

<sup>17</sup> Ibid

|                                                |                                          |
|------------------------------------------------|------------------------------------------|
| Fizibiliteti dhe dizajni                       | Specifikimet teknike dhe prokurimi       |
| Statistikat dhe kodi i industrisë              | Hulumtimi dhe zhvillimi                  |
| Ndërgjegjësimi publik dhe ndryshimi i sjelljes | Njohja dhe integrimi i sektorit joformal |
| Parandalimi i mbeturinave                      | Ripërdorimi dhe riciklimi                |

| Indikatori i rezultatit                                                              | Viti Bazë                                                         | Objektivi i ndërmjetëm                                                                        | Objektivi përfundimtar                                                                           |
|--------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>1. Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore në sektorin e menaxhimit të mbeturinave</b> | Zhvillimi i kapaciteteve ofrohet nga partnerët zhvillimorë (2024) | n/a                                                                                           | Kapacitet njerëzore të zhvilluara në përputhje me planin për ngritje të kapaciteteve 100% (2030) |
| <b>2. Institucionet kyçe janë të përgaditura për zbatimin e kompetencave ligjore</b> | Nevojat aktuale po vlerësohen përmes analizës së sektorit (2024)  | 80% e kërkesave për personel dhe burime të institucioneve zbatuese janë në dispozicion (2026) | 100% e kërkesave për personel dhe burime të institucioneve zbatuese janë në dispozicion (2030)   |

#### 4.5.3 Bashkëpunimi ndër-komunal

##### Objektivi specifik 2.3

Krijimi i një kornize të planifikimit ndër-komunal dhe procedurave të qarta për të nxitur bashkëpunimin ndër-komunal

Komunat e motivuara, me mbështetjen e vazhdueshme të marrë, kanë nxitur ofrimin e shërbimeve bazë, veçanërisht shkalla e grumbullimit të mbeturinave në nivele më të larta se sa ishte parashikuar, duke e vendosur Kosovën si pikë referimi për rajonin dhe arritjen e mbulimit të plotë me shërbime në një të ardhme të afërt. Shërbimet e deponimit janë domosdoshmërisht të organizuara në mënyrë më qendrore, përdorimi i tyre ofron tashmë përvojat e para të bashkëpunimit ndërmjet disa komunave. Hapi i ardhshëm i parashikuar i zhvillimit drejt shërbimeve të menaxhimit të integruar të mbeturinave kërkon nivele më të larta bashkëpunimi dhe integrimi për t'u bërë i zbatueshëm dhe ekonomikisht i realizueshëm. Shërbimet e integruara, siç parashikohen në OS 1.1 dhe OS 1.2 janë të arritshme vetëm kur komunat bashkëpunojnë në përpjekjet e tyre për të përdorur në mënyrë efikase fazat e ndarjes, ripërtëritjes dhe trajtimit të sektorit të ardhshëm të MMB. Janë ndërmarrë hapat e parë për të krijuar një kornizë të planifikimit ndër-komunal duke nxjerrë udhëzime dhe duke shoqëruar procedurat e para të planifikimit ndër-komunal. Planifikimi i integruar ndër-komunal dhe bashkëpunimi ndër-komunal janë një gur themeli i zhvillimit të MMB-së në Kosovë. Komunat inkurajohen dhe do të marrin mbështetje për zhvillimin dhe zbatimin e planeve të integruara ndër-komunale të menaxhimit të mbeturinave.

| Indikatori i rezultatit                                                                                                                      | Viti Bazë                  | Objektivi i ndërmjetëm      | Objektivi përfundimtar                                                  |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------|-----------------------------|-------------------------------------------------------------------------|
| <b>Të gjitha zonat e menaxhimit të mbeturinave të Kosovës kanë të hartuara plane ndër-komunale për menaxhimin e integruar të mbeturinave</b> | 3 plane të hartuara (2024) | 3 plane të miratuara (2025) | Të gjitha zonat e menaxhimit të mbeturinave me plane të hartuara (2027) |

## 4.6 Objektivi strategjik 3: Implementimi, zbatimi i ligjit dhe financimi

### Objektivi strategjik 3

#### Përmirësimi i kapaciteteve implementuese, ekzekutuese dhe financuese në sektorin e menaxhimit të mbeturinave

Përvojat me strategjinë e parë të menaxhimit të mbeturinave tregojnë qartë se zhvillimi i sektorit të MMB-së pengohet nga kapacitetet e dobëta implementuese dhe ekzekutuese të institucioneve përgjegjëse. Financimi i pamjaftueshëm i investimeve dhe operacioneve dhe strukturat e ngurta të kostos kufizojnë rritjen e qëndrueshme të shërbimeve. Implementimi i dispozitave dhe arritja e objektivave të SMIMK kërkon përmirësim të konsiderueshëm të kapaciteteve të tilla, duke siguruar që korniza e vendosur sipas objektivit strategjik 2 do të bëhet efektive. Kjo mund të jetë e qëndrueshme vetëm nëse akterët e kualifikuar dhe të certifikuar u përmbahen rregulloreve dhe kërkesave të zhvillimit të sektorit dhe nëse ekziston kontrolli i duhur. Qytetarët inkurajohen të marrin pjesë në mënyrë pozitive. Megjithatë, praktikët e paligjshme do të ndiqen penalisht dhe sanksionohen. Financimi i sektorit duhet të mbështetet nga mekanizma të qëndrueshëm të planifikimit dhe zhbllokimit për të arritur mbulimin e plotë të kostos. Akterët e sektorit privat duhet të ndërhyjnë për të marrë rolin e tyre dhe për të eksploruar mundësitë ekonomike në ndryshimin e peizazhit të menaxhimit të mbeturinave dhe burimeve në Kosovë.

| Indikatori i rezultatit                                                                                | Viti Bazë                                             | Objektivi i ndërmjetëm                                               | Objektivi përfundimtar                                               |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------|
| Niveli i arritjes së caqeve në përputhje me dokumentet e planifikimit (SMIMK dhe planet ndër-komunale) | Planet ndër-komunale duke u hartuar në linjë me SMIMK | 50% shkalla e arrijtes së caqeve me dokumentet e planifikimit (2026) | 80% shkalla e arritjes së caqeve me dokumentet e planifikimit (2035) |

### 4.6.1 Lejet, zbatimi dhe raportimi

#### Objektivi specifik 3.1

##### Krijimi i sistemeve gjithëpërfshirëse dhe funksionale të lejeve, raportimit dhe zbatimit të ligjit

Sistemi ekzistues i licencimit dhe lejeve do t'i nënshtrohet një rishikimi thelbësor, duke zgjeruar fushën e mbulimit për të përfshirë të gjithë prodhuesit dhe akterët brenda sektorit mbeturinave. Ky zgjerim do të lehtësojë qasjen pa probleme për përfshirjen e sektorit privat në operacionet e Menaxhimit të Mbeturinave dhe Burimeve (MMB). Duke u mbështetur në suksesin e sistemit informativ të menaxhimit të mbeturinave të operuar nga Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit (AMMK), qëllimi është të zgjerohet shtrirja e tij dhe të përmirësohet cilësia e të dhënave. Qëllimi është krijimi i një mekanizmi raportues dinamik, të besueshëm dhe të përditësuar që mbështet vendimmarrjen e bazuar në të dhëna brenda sektorit. Do të zbatohen standarde të rrepta të sigurisë së TI-së për të siguruar integritetin e të dhënave, mbështetur nga prezantimi i mjeteve dhe masave të përshtatshme digjitale. Përpjekjet për zbatimin e ligjit do të forcohen duke rritur kapacitetet e organeve rregullatore, duke rritur burimet në dispozicion dhe duke plotësuar këto nisma me fushata për rritjen e ndërgjegjësimit.

Në të njëjtën kohë, do të vendoset një komunikim i qartë për të përcjell se sa të rënda janë shkeljet mjedisore. Ndërsa qasja parësore është inkurajimi dhe nxitja e praktikave dhe sjelljeve të menaxhimit

të mbeturinave me përgjegjësi mjedisore, pranohet se disa individë dhe subjekte mund të zgjedhin të operojnë jashtë kërkesave ligjore. Në raste të tilla, strategjia njih nevojën për të qartësuar dhe përforcuar efektivitetin e legjislacionit dhe rregulloreve ekzistuese, duke u mbështetur nga përvojat e fituara gjatë zbatimit. Ekziston një nevojë e qartë dhe urgjente për përmirësimin e mekanizmave për zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve për menaxhimin e mbeturinave. Komunitet, duke zotëruar njohuri lokale për mjediset, bizneset dhe banorët e tyre përkatës, do të luajnë një rol vendimtar në forcimin dhe thjeshtimin e procedurave të zbatimit të ligjit. Aty ku kërkohet dhe në përputhje me legjislacionin, autoriteteve përgjegjëse do t'u jepen kompetenca të reja zbatuese, duke i fuqizuar ato për të luftuar në mënyrë efektive kundërvajtjet dhe krimet mjedisore.

| Indikatori i rezultatit                                                                                                                         | Viti Bazë                               | Objektivi i ndërmjetëm | Objektivi përfundimtar                                                                                                       |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------|------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Lejet e integruara janë të shtrira për të gjitha aktivitetet e menaxhimit të mbeturinave, operatorët dhe impiantet/ objektet e trajtimit</b> | Mbulim i pjesshëm me leje të integruara | n/a                    | Të gjithë operatorët, dhe impiantet/ objektet janë të pajisur me leje mjedisore përkatëse për menaxhim të mbeturinave (2026) |

#### 4.6.2 Mekanizmat e mbulimit të kostos

##### Objektivi specifik 3.2

Promovimi i mekanizmave për mbulimin e plotë të kostos dhe rritjen e investimeve në sektor

Prioriteti kryesor qëndron në sigurimin e financimit të qëndrueshëm për punët e menaxhimit të mbeturinave. Kjo përfshin një qasje të shumanshme, duke përfshirë eksplorimin dhe zbatimin e mekanizmave shtesë të financimit që plotësojnë qasjet e financimit të shërbimit të bazuar në tarifë. Ai gjithashtu përfshin përdorimin e instrumenteve ekonomike, të tilla si Përgjegjësia e Zgjeruar e Prodhuesit (PZP), për të inkorporuar fraksione të ndryshme mbeturinash, duke lehtësuar kështu barrën financiare dhe operacionale të komunave. Tarifat, të aplikuara si për prodhuesit ashtu edhe për operatorët e mbeturinave, do të strukturohen për t'i pasqyruar kostot aktuale të bëra, duke përdorur metodologji të përshtatshme për arritjen e përpunimit të plotë të kostos. Duke njohur peizazhin dinamik të menaxhimit të mbeturinave dhe kufizimet financiare të qytetarëve, zhvendosja drejt përpunimit gjithëpërfshirës të kostos do të jetë me faza dhe do të jetë e vëmendshme. Në të gjitha kornizat e planifikimit dhe procedurave, do të përfshihen parimet e mbulimit të kostos, duke ankoruar angazhimin për një themel financiar të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës për MMN.

| Indikatori i rezultatit                                                                       | Viti Bazë                                                | Objektivi i ndërmjetëm | Objektivi përfundimtar                                           |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------|------------------------|------------------------------------------------------------------|
| <b>Përqindja e kostove të menaxhimit të mbeturinave të mbuluara nga të ardhurat në sektor</b> | Mbulim i pjesshëm i kostove të menaxhimit të mbeturinave | n/a                    | Mbulimi i plotë i kostove, përfshirë kostot e investimeve (2035) |

#### 4.6.3 Angazhimi i sektorit privat

### Objektivi specifik 3.3

Krijimi i kushteve për ta tërhequr përfshirjen e sektorit privat në investimet në infrastrukturë dhe ofrimin e shërbimeve

Për zhvillimet e pritura në sektorin e MMB-së në Kosovë, ekziston si nevoja ashtu edhe mundësia unike që sektori privat të angazhohet. Ky sektor paraqet mundësi të shumta ekonomike, veçanërisht brenda shërbimeve më të sofistikuara dhe zinxhirëve të vlerës për materialet e përpunuara. Veçanërisht, kërkesat për investime të identifikuar në këtë sektor janë të konsiderueshme dhe nuk mund të mbështeten vetëm në burimet e sektorit publik. Për t'i shfrytëzuar me të vërtetë kapacitetet e sektorit privat, është e domosdoshme të identifikohen mundësitë brenda kornizës ekzistuese institucionale. Kjo përfshin zhdukjen e çdo pengese ekzistuese për përfshirjen e tyre, duke siguruar një mjedis të sigurt dhe të favorshëm për investimet e tyre, dhe ofrimi i stimuljeve bindës për të inkurajuar hyrjen dhe pjesëmarrjen e tyre në këtë sektor.

| Indikatori i rezultatit                                                          | Viti Bazë                                 | Objektivi i ndërmjetëm                                                  | Objektivi përfundimtar                                                  |
|----------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------|
| Rritje e investimeve të sektorit privat në menaxhimin e mbeturinave dhe burimeve | Sektori privat pa angazhim të strukturuar | 30% e infrastrukturës së nevojshme financohet nga sektori privat (2026) | 80% e infrastrukturës së nevojshme financohet nga sektori privat (2035) |

## 4.7 Objektivi strategjik 4: Ekonomia qarkore

### Objektivi strategjik 4

Inicimi i tranzicionit të Kosovës drejt ekonomisë qarkore duke maksimizuar shfrytëzimi

n e burimeve/materialeve nga sektori i mbeturinave

Me kalimin e kohës, shërbimet e menaxhimit të mbeturinave do të bëhen më komplekse, me sisteme të shumëfishta grumbullimi me kontejnerë të cilët do të integrohen haps pas hapi, gjithashtu dhe nga publiku, bizneset dhe institucionet që kërkohet të bashkëveprojnë me shërbimet e menaxhimit të mbeturinave në mënyra të ndryshme.

Nevojitet një ndryshim kulturor i qëndrimeve dhe sjelljeve për të mbështetur këtë tranzicion. Brezi i ri po sjell me vete energji dhe pritshmëri të reja. Ne duhet të përfitojmë nga kjo për të stimuluar një brez të ri qytetarësh të vetëdijshëm për burimet dhe me mendësi të parandalimit dhe ruajtjes.

Gjatë viteve të fundit janë vendosur vlerat dhe praktikatat e një ekonomie qarkore, dhe BE-ja ka vendosur një politikë të re ambicioze për të ecur në këtë drejtim si shoqëri.

Diversifikimi i sistemeve të grumbullimit, trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave sjell mundësi të reja biznesi dhe punësimi. Pasi të krijohen fraksionet e reja të lëndëve të para sekondare dhe mund të mbështeten në to, bizneset lokale mund të investojnë në industrinë e prodhimit që i përpunon këto materiale në produkte të reja. Duke u fokusuar në mbylljen e çdo qarku të materialeve një nga një, biznesi dhe industria vendase do të jenë në gjendje të përfitojnë nga një ekonomi e re qarkore, duke çuar përpara inovacionin, punësimin dhe rritjen ekonomike.

Mirëpo, koncepti i ekonomisë qarkore nuk ka të bëjë vetëm me mbeturinat; fokusi në rritje po vendoset në parandalimin e mbeturinave në radhë të parë, nëpërmjet ridizajnit të produktit dhe ndalimit të prodhimit dhe përdorimit të disa materialeve dhe produkteve. Modelet evropiane të prodhimit dhe konsumit do të ndryshojnë ndjeshëm në dekadat e ardhshme.

| Indikatori i rezultatit                                                    | Viti Bazë  | Objektivi i ndërmjetëm | Objektivi përfundimtar |
|----------------------------------------------------------------------------|------------|------------------------|------------------------|
| Përqindja e përpunimit të materialeve/mbeturinave nga llojet e mbeturinave | <5% (2021) | 20% (2028)             | 35% (2030)             |

#### 4.7.1 Parandalimi i mbeturinave

##### Objektivi specifik 4.1

Mbështetje në parandalimin e mbeturinave dhe përmirësimin e efikasitetit të burimeve

Ndërsa parandalimi i mbeturinave ka qenë gjithmonë në krye të hierarkisë së mbeturinave, vetëm në vitet e fundit vëmendja e plotë e politikëbërësve i është kushtuar kësaj teme. Me shtrëngimin e ekonomisë dhe presionin në rritje në tregjet ndërkombëtare të burimeve, efikasiteti i burimeve fiton me shpejtësi rëndësi strategjike për zhvillimin ekonomik.

Iniciativat për parandalimin e mbeturinave vijnë si përgjigje ndaj ndikimit global të problemit të ndotjes detare dhe opinionit të përhapur në publik kundër përdorimit të produkteve plastike njëpërdorimshe.

Mallrat dhe pajisjet e prodhuara apo të importuara në Kosovë kanë problem të vjetërsimit të integruar (materiale të dobëta që konsumohen shpejt). Kjo komplikohet nga niveli i ulët i ndërgjegjësimit të popullatës për zgjedhjen e produkteve për të blerë, ciklin jetësor të produkteve dhe ndikimet e mundshme negative në mjedis. Për më tepër, në sektorin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme të Kosovës, përgjithësisht nuk i kushtohet vëmendje konsumit të qëndrueshëm të burimeve dhe materialeve të konsumueshme.

Një Program Kombëtar për Parandalimin e Mbeturinave (PKPM) duhet të përgatitet siç kërkohet nga Direktiva kornizë e BE-së për mbeturinat. Objektivi i tij i përgjithshëm do të jetë që në radhë të parë të minimizojë gjenerimin e mbeturinave, dhe më pas të ruajë vlerën e produkteve, materialeve dhe burimeve në ekonomipër aq kohë sa të jetë e mundur. Për më tepër, fokusi do të jetë në dizajnimin më të mirë të produkteve dhe pajisjeve në mënyrë që të zbutet vjetërsimi i parakohshëm. Masat që do të përfshihen në programin e parandalimit të mbeturinave mund të grupohen në kategoritë e mëposhtme:

|                                                                                 |   |                                                                                                                                          |
|---------------------------------------------------------------------------------|---|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Masat që mund të ndikojnë në kushtet kornizë që lidhen me gjenerimin e mbetjeve | ✓ | planifikimi i masave, apo instrumenteve të tjera ekonomike që nxisin përdorimin efikas të burimeve                                       |
|                                                                                 | ✓ | promovimi i kërkimit dhe zhvillimit në fushën e prodhimit të produkteve dhe teknologjive më të pastra, të cilat gjenerojnë më pas mbetje |
|                                                                                 | ✓ | zhvillimi i treguesve efektivë dhe kuptimplotë të matjes së presioneve mjedisore që lidhen me gjenerimin e mbeturinave                   |
|                                                                                 | ✓ | promovimi i eko-projektimit                                                                                                              |

|                                                                                 |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |
|---------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Masat që mund të ndikojnë në fazën e projektimit dhe prodhimit dhe shpërndarjes | <ul style="list-style-type: none"> <li>✓ ofrimi i informacionit mbi teknikat e parandalimit të mbeturinave</li> <li>✓ trajnimi i autoriteteve kompetente për përfshirjen e kërkesave për parandalimin e mbeturinave në procedurat e lejeve</li> <li>✓ vlerësime ose plane për parandalimin e mbeturinave për instalime të mëdha industriale</li> <li>✓ përdorimi i fushatave vetëdijesuese ose ofrimi i mbështetjes financiare, vendimmarrëse apo të tjera për bizneset</li> <li>✓ marrëveshje vullnetare, panele me konsumatorë/prodhues ose negociata sektoriale</li> <li>✓ promovimi i sistemeve të besueshme të menaxhimit mjedisor, duke përfshirë EMAS dhe ISO 14001</li> </ul> |
| Masat që mund të ndikojnë në fazën e konsumit dhe përdorimit                    | <ul style="list-style-type: none"> <li>✓ instrumente ekonomike si stimuj për blerje që rezultojnë në emetime të ulta</li> <li>✓ fushata vetëdijesuese</li> <li>✓ promovimi i etiketave të besueshme ekologjike</li> <li>✓ marrëveshjet me industrinë ose me shitësit me pakicë për disponueshmërinë e informacionit për parandalimin e mbeturinave</li> <li>✓ prokurimi publik i gjelbër</li> <li>✓ promovimi i ripërdorimit dhe/ose riparimit</li> </ul>                                                                                                                                                                                                                             |

Derisa të hartohet një program i detajuar dhe shumësektorial për parandalimin e mbeturinave, fokusi prioritar i Qeverisë do të caktohet në masat prioritare të mëposhtme:

- Hartimi i një plani veprimi për produktet plastike njëpërdorimshe (SUP) si një përpjekje të përbashkët ndërmjet sektorit publik dhe privat.
- Parandalimi i mbeturinave ushqimore dhe në veçanti produkteve me datë të skaduar, promovimi i kompostimit në shtëpi dhe rritja e ndërgjegjësimit të publikut
- Krijimi i mekanizmave dhe stimujve për të mbështetur zhvillimin e rrjeteve të riparimit dhe ripërdorimit për produktet e hedhura dhe/ose përbërësit e tyre.

| Indikatori i rezultatit                                             | Viti Bazë                  | Objektivi i ndërmjetëm                                                                           | Objektivi përfundimtar                                                        |
|---------------------------------------------------------------------|----------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------|
| Shkalla e implementimit të programit për parandalimin e mbeturinave | Programi nuk është hartuar | Programi për parandalimin e mbeturinave (përfshirë Plastikën një-përdorimëshe) i miratuar (2028) | 50% e masave të programeve për parandalimin e mbeturinave janë zbatuar (2030) |

#### 4.7.2 Rritja e normave të ripërdorimit, riciklimit dhe përpunimit

##### Objektivi specifik 4.2

Rritja e grumbullimit të ndarë, ripërdorimit dhe riciklimit sipas treguesve e performancës, instrumentet ekonomike dhe skemat e përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit.

Ripërdorimi dhe riciklimi janë prioritet i rëndësishëm strategjik, si në aspektin e zhvillimit të ekonomisë në Kosovë, ashtu edhe në aspektin kritik për arritjen e caqeve të përcaktuara në këtë strategji. Për ta arritur këtë, kjo strategji parasheh:

- Formulimin e objektivave të qarta sa i përket fraksioneve të caktuara të mbeturinave prioritare, të tilla si mbeturinat komunale, mbeturinat e paketimit, mbeturinat e vajrave, bateritë dhe akumulatorët, MPEE dhe të tjera për të nxitur riciklimin;
- Qeveria i jep përparësi ndarjes së mbeturinave në burim, në vend të klasifikimit të mbeturinave të përziera komunale, duke marrë parasysh arritjen e një niveli të lartë riciklimi dhe shmangien e problemeve të shëndetit dhe sigurisë nga personat e punësuar për grumbullimin dhe përpunimin e mbeturinave të riciklueshme.
- Zbatimi i strategjisë do t'i rrisë edhe llojet e mbeturinave të grumbulluara për përpunim dhe riciklim. Fillimisht, grumbullimi i detyrueshëm i ndarë do të prezantohet për mallrat kryesore të mbeturinave të riciklueshme, si letra dhe kartoni, plastika, qelqi, metalet, MPEE dhe më vonë do t'i shtrijë këto kërkesa në fraksionet e tjera të mbeturinave, si tekstilet dhe mbeturinat biologjike. Do të zhvillohen sisteme grumbullimi të materialeve të ndryshme të riciklueshme dhe gradualisht do të planifikohet grumbullimi i ndarë i fraksioneve të caktuara. Riciklimi do të zbatohet nëse është teknikisht i mundur, dhe përfitimet mjedisore që duhet të arrihen lidhen me koston e riciklimit.
- Tarifat e produkteve, sistemet e depozitimit vullnetar, tarifat e menaxhimit të mbeturinave industriale dhe masa të tjera do të përdoren si mjete ekonomike për të mbështetur zbatimin e përpunimit dhe riciklimit. Vendimet për përdorimin e instrumenteve specifike do të merren pas konsultimit me sektorët relevantë të industrisë.
- Për fraksione të veçanta të mbeturinave, si mbeturinat e ambalazhit, gomat, bateritë dhe akumulatorët, MPEE, mbeturinat e vajrave, automjetet e vjetruara, do të prezantohen kërkesat e "Përgjegjësisë së Zgjeruar të Prodhuesit", ku do të angazhohen prodhuesit dhe importuesit e mallrave dhe ambalazheve parësore në organizimin dhe financimin e sistemeve të nevojshme për ripërdorimin, riciklimin dhe menaxhimin e këtyre produkteve pasi ato bëhen mbeturina. Qeveria do ta mbështesë dialogun me operatorët ekonomikë për ngritjen e sistemeve të veçanta të grumbullimit.
- Krijimi i Sistemit së Rimbursimit të Depozitave (SRD) për ambalazhet e pijeve do të futet gjithashtu paralelisht me sistemin më të gjerë të PZP për mbeturinat e paketimit.
- Do të inkurajohen gjithashtu sistemet për ripërdorimin/riciklimin e tekstileve. Preferenca është që sistemet të krijohen, operohen dhe financohen nga sektori joqeveritar. Sistemet e menaxhimit të tekstilit mund të përfshijnë 'bankat' e grumbullimit të tekstilit, dyqanet e lagjeve për shitjen dhe tregtimin e tekstileve të përdorura dhe lidhjet e mëtejshme tregtare me tregun evropian dhe ndërkombëtar. Ripërdorimi dhe riciklimi i tekstilit mund të japin një kontribut të rëndësishëm mjedisor dhe të ndihmojnë në fillimin e zhvillimit të ekonomisë qarkore lokale.
- Mbeturinat biologjike konsiderohen gjithashtu si fraksion prioritar i mbeturinave për ta rritur riciklimin. Ato gjenerohen nga burime të shumta, duke përfshirë ekonomitë familjare, tregtinë, industrinë e përpunimit të ushqimit. Siç specifikohet në objektivin specifik 1.2, gjatë periudhës fillestare të zbatimit fokusi do të jetë në kompostimin në shtëpi dhe grumbullimin e ndarë të mbeturinave të gjelbra nga zonat e gjelbra publike së bashku me mbeturinat e tregut. Në planin afatgjatë, grumbullimi i ndarë i mbeturinave duhet të shtrihet në mbeturinat biologjike dhe këto materiale do të kompostohen ose treten në objektet e Menaxhimit të Integruar të Mbeturinave Organike (MIMO). Kërkesat ligjore dhe/ose standardet kombëtare për cilësinë e kompostit do të zhvillohen jo më vonë se tre vjet pas miratimit të strategjisë.
- Duke ndjekur konceptin e hierarkisë së mbeturinave, në strategjinë e shtjelluar pranohet se opsionet e avancuara të menaxhimit të mbeturinave që devijojnë mbeturinat nga deponia mund të sjellin përfitime sociale shtesë. Strategjia do t'i marrë parasysh masat e parashikuara në planet rajonale të menaxhimit të mbeturinave në lidhje me: kompostimin në shtëpi, grumbullimin e

ndarë të mbeturinave biologjike dhe fraksioneve të tjera të mbeturinave të riciklueshme dhe trajtimin paraprak të mbeturinave komunale para deponimit në deponi.

- Instalimet për riciklim/përpunim duhet të jenë në përputhje me kërkesat e legjislacionit mjedisor që rregullon cilësinë e ajrit dhe ujit, kimikatet, sigurinë mjedisore dhe kontrollin e ndotjes industriale, etj.
- Fushatat për të rritur ndërgjegjësimin e publikut dhe konsultimet me palët e interesit do të kontribuojnë në kuptimin e mundësive të mundshme dhe përfitimeve mjedisore që dalin nga operacionet e ripërtëritjes dhe riciklimit.
- Gjatë periudhës së zbatimit të strategjisë do të prezantohet grumbullimi i ndarë i mbeturinave nga ambientet administrative, universitetet dhe shkollat. Krijimi i sistemeve të tilla të mbeturinave nga sektori tregtar, institucionet dhe zyrat do të jenë prioritet të planeve ndër-komunale për menaxhimin e mbeturinave. Skemat e monitorimit për riciklimin e këtyre mbeturinave do të bazohen në nivel të komunave, me qëllim zbatimin e detyrimeve përkatëse për raportim.

Për arritjen e niveleve të larta të riciklimit do të nevojitet gjithashtu një politikë e përcaktuar qartë e qeverisë për mbështetjen e tregjeve për lëndët e para dytësore. Rritja e kostove financiare për menaxhimin dhe deponimin e mbeturinave dhe zbatimi i tarifave për përpunimin e kostove të plota do të përfaqësojë gjithashtu një nxitje për përpunimin/riciklimin e materialeve nga mbeturinat.

Për më tepër, qeveria do të ndërmarrë veprime për të siguruar qasje të industrive në fjalë në kredi me interes të ulët për ngritjen e kapaciteteve të reja shtesë për trajtimin dhe riciklimin. Këto fonde do të fokusohen vetëm në ata sektorë ku kapaciteti ekzistues nuk është i mjaftueshëm për trajtimin e mbeturinave të grumbulluara në vend. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet riciklimit të mbeturinave të rrezikshme, mbeturinave nga ndërtimet dhe rrënimet, mbeturinave të vajrave dhe mbeturinave të biodegradueshme. Masat e marra nuk duhet të kufizojnë konkurrencën e lirë në treg për mbeturinat e riciklueshme.

#### Përgjegjësia e Zgjerrur e Prodhuesit

Qeveria e Kosovës synon të prezantojë legjislacionin për të siguruar që çdo person fizik apo juridik ("prodhuesi") i cili zhvillon, prodhon, përpunon, trajton, shet ose importon produkte të caktuara për qëllime profesionale/biznesi ngarkohet me detyrimin e "përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit". Kjo përgjegjësi mund të përfshijë pranimin e produkteve të kthyer dhe të mbeturinave që mbeten në fund të jetës së produktit, si dhe menaxhimin e mëposhtëm të mbeturinave dhe përgjegjësinë financiare për aktivitete të tilla. Grupet e mëposhtme të produkteve duhet të merren parasysh nga këndvështrimi i forcimit, ripërdorimit, parandalimit dhe riciklimit/përpunimit të mbeturinave:

- Mallrat e paketuara;
- Pajisjet elektrike dhe elektronike;
- Bateritë dhe akumulatorët;
- Makinat e vjetra;
- Vajrat motorikë; dhe
- Gomat e automobilave.

Krijimi i një skeme të përgjegjësisë së prodhuesit ka këto objektiva kryesore:

- Të ofrojë të ardhura financiare shtesë dhe stimuj për grumbullimin e ndarë, klasifikimin dhe riciklimin;
- Të shmangë ndërprerjet e përkohshme në proceset e grumbullimit në rastet e rënies së çmimeve të mbeturinave të riciklueshme;
- Të përfshijë çështjet e parandalimit, ripërdorimit dhe riciklimit të mbeturinave në dizajnin e produktit; dhe
- Të garantojë arritjen e objektivave të grumbullimit, riciklimit dhe ripërpunimit të ndarë të përcaktuar në politikën/legjislacionin kombëtar.

Përfitimet nga përfshirja e prodhuesve në aranzhimet e menaxhimit për mbeturinat (ose materialet) që rrjedhin nga produktet e konsumit është se prodhuesit janë shumë më të aftë t'i dizajnojnë sistemet logjistike për menaxhimin e këtyre materialeve pas konsumimit.

Financimi i skemave të grumbullimit të ndarë, klasifikimit dhe riciklimit të mbeturinave të riciklueshme është i lidhur drejtpërdrejt me përgjegjësitë e palëve të ndryshme të interesit të përcaktuara në legjislacionin e ardhshëm. Zgjidhjet e ndryshme teknike të miratuara për grumbullimin dhe klasifikimin e mbeturinave të ripërtërishme gjithashtu supozojnë nivele të ndryshme të ndarjes së kostove, dhe kosto dhe struktura të ndryshme financimi.

Skema të ndryshme do të zbatohen për secilën prej këtyre katër fraksioneve prioritare të produkteve/materialeve. Për MPEE dhe bateritë, sistemet duhet të projektohen, organizohen, financohen dhe operohen nga prodhuesit e sektorit privat. Industria e mallrave elektrike dhe elektronikës ka demonstruar ndërkombëtarisht proaktivitetin e tyre dhe mund të mbështetet tek investimi në sistemet e PZP.

Industria inkurajohet të dalë me propozime për mekanizmat e PZP që mbulojnë fraksionet e ndryshme të e-mbeturinave. Për paketimin do të zbatohet një sistem i PZP i tipit hibrid. Në varësi të disponueshmërisë së fondeve, një pjesë e bashkëfinancimit publik do të vihet në dispozicion për asete të tilla si kontejnerët e veçantë të grumbullimit dhe objektet e përpunimit të materialeve. Preferohet që sistemi të operohet nga një Organizatë e Licencuar e Përgjegjësisë së Prodhuesit, e krijuar nga prodhuesit, KRMM ose kontraktorët privatë të ofrojnë shërbimet të grumbullimit të ndarë dhe klasifikimit.

Për automjetet e vjetruara do të dizajnohet dhe zbatohet një sistem i administruar publikisht duke përfshirë një tarifë mjedisore që paguhet në kohën e regjistrimit të parë të automjetit në Kosovë. Kantieret e licencuara për mbeturinat e hekurit do të jenë në gjendje të kërkojnë kthimin e shpenzimeve të riciklimit/menaxhimit të automjeteve të vjetruara, me kusht që të dëshmojnë se i kanë plotësuar kërkesat rregullative dhe, në veçanti, se i kanë respektuar kontrollet mjedisore gjatë çmontimit të automjeteve dhe se i kanë realizuar caqet e ripërdorimit dhe riciklimit.

Vendimet për llojin e skemave të PZP dhe fushëveprimin e përgjegjësive do të merren në bazë të konsultimeve me industrinë përkatëse, komunat dhe palët tjera të interesit.

Do të rritet vetëdijesimi publik për të siguruar që koncepti i përgjegjësisë së prodhuesit të zbatohet me sukses në Kosovë. Publiku do të informohet për ato produkte që i nënshtrohen skemave të përgjegjësisë së prodhuesit, përfitimet nga menaxhimi i këtyre fraksioneve të mbeturinave në këtë mënyrë dhe veprimet praktike që duhet t'i ndërmarrë çdo individ në lidhje me secilën skemë.

| Indikatori i rezultatit                                                                                          | Viti Bazë                     | Objektivi i ndërmjetëm | Objektivi përfundimtar                                                                                      |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------|------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Skemat e zgjeruara të përgjegjësisë së prodhuesit zbatohen për katër lloje të fraksioneve të mbeturinave.</b> | Mekanizmat e PZP nuk zbatohen | n/a                    | 4 skema të PZP-së janë duke u zbatuar (PZP dhe SRD për ambalazhet, PZP për MPEE, bateritë dhe AV-të) (2035) |

### 4.7.3 Vetëdijesimi dhe edukimi

#### Objektivi specifik 4.3

Ngritja e vetëdijesimit për rëndësinë dhe dobritë e menaxhimit dhe riciklimit të duhur të mbeturinave dhe stimulimi i ndryshimit të sjelljes

Në mënyrë që çfarëdo politike, sistemi, shërbimi dhe teknologjie e mbeturinave të arrijë sukses pozitiv dhe të qëndrueshëm, është qenësore që të fitohet mbështetja e vullnetshme dhe proaktive e qytetarëve.

Menaxhimi i mbeturinave është një biznes njerëzor. Janë njerëzit që gjenerojnë mbeturina dhe ata mbeten ndikuesi kryesor në të gjithë zinxhirin e furnizimit të mbeturinave. As sistemet më të avancuara teknike nuk do të funksionojnë - e me gjasë edhe do të dështojnë - po që se gjërat e duhura nuk vihen në binarët e duhur në kohën e duhur. Edhe sjellja e njeriut ndikon në koston e trajtimit të mbeturinave, ekzistimin e deponive ilegale si dhe ambiciet lokale, rajonale dhe globale për ta reduktuar ndotjen plastike.

Mjetet e formësimit të qëndrimeve dhe veprimeve të njerëzve ndaj mbeturinave bien në kategorinë profesionale të 'Ndryshimit të Sjelljes'. Fushatat e ndryshimit të sjelljes janë mjet thelbësor për të ofruar jo vetëm informacione, por motivim të krijuar për të frymëzuar përfshirjen gjatë zbatimit të sistemeve të reja të menaxhimit të mbeturinave nëpër komunitete.

Veprimi i parë do të jetë komunikimi i kësaj strategjie, publikimi i objektivave dhe caqeve kryesore të strategjisë në një mënyrë që të tërheqë vëmendjen e njerëzve.

Ndryshimi i qëndrimeve, zakoneve dhe modeleve të sjelljes nuk është rregullim i njëhershëm. Ai ka nevojë për investime të qëndrueshme për shumë vite. Gjatë kësaj strategjie do të hartohen dhe lansohen fushata vetëdijesimi dhe ndryshimi i sjelljes publike. Temat kryesore për fushatat do të përfshijnë: ndalimi i hedhjes së mbeturinave, ripërdorimi, riciklimi dhe hedhja e paligjshme.

Këto fushata do të fokusohen në nxitjen e vetëdijesimit, interesit dhe ndryshimit pozitiv në sjellje për të mbështetur qëllimet e përgjithshme. Fushatat do të jenë të matshme për sa i përket ndikimit që kanë në reduktimin e plehrave, reduktimin e mbeturinave të dërguara për deponim, sasinë e riciklimit të bërë dhe zvogëlimin e numrit të vend deponimeve të paligjshme. Ky pasqyrë do të përdoret për të formësuar çdo fazë të mëpasshme.

Qëndrimet ndaj mbrojtjes së mjedisit dhe ruajtjes së resurseve fillojnë dhe formohen në klasë. Fëmijët ofrojnë shtysë dhe optimizëm për një të ardhme më të qëndrueshme mjedisore në Kosovë. Ata janë ndikues shumë efektivë në shtëpi, kështu që shprehja e interesit dhe kuptimi nga fëmijët veprojnë si avokues të fortë në ndryshimin e sjelljes së prindërve.

Të mësuarit e strukturuar do të futet në plan programin e shkollave. Përmbajtja dhe cilësia e planprogrameve që kanë të bëjnë me mjedisin në secilën fazë kryesore të arsimit do të rishikohet dhe përditësohet. Kjo do të sigurojë relevancën e temave që përshtaten me prioritetet kombëtare dhe globale.

| Indikatori i rezultatit                                                                      | Viti Bazë                                                                 | Objektivi i ndërmjetëm                     | Objektivi përfundimtar                     |
|----------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------|--------------------------------------------|
| Ndikimi i matur i fushatave për vetëdijesim vlerësohet dhe publikohet në vitet 2025 dhe 2029 | Fushata të dedikuara për menaxhimin e mbeturinave nuk janë duke u zbatuar | Ndikimet e fushatave janë publikuar (2025) | Ndikimet e fushatave janë publikuar (2030) |

#### 4.7.4 Promovimi i Inovacionit dhe kërkimit

##### Objektivi specifik 4.4

Rritja e përfshirjes së akterëve ekonomikë dhe institucioneve arsimore dhe kërkimore në përhapjen dhe zbatimin e praktikave dhe inovacioneve qarkore

Nga pikëpamja ekonomike, përfitimet nga tranzicioni në ekonomi qarkore janë të shumta – rritja e efikasitetit të burimeve, ulja e kostove materiale, stimulimi i inovacionit, shkëputja e rritjes ekonomike nga konsumi i burimeve, zhvillimi i tregut të punës, reduktimi i mbeturinave dhe kostove të tyre për deponim.

Zhvillimi i inovacioneve, dhe në veçanti i eko-inovacioneve, është një pjesë themelore e konceptit të tranzicionit drejt një ekonomie qarkore. Eko-inovacionet janë teknologji, procese, produkte ose shërbime të reja që kontribuojnë në mbrojtjen e mjedisit ose përdorimin më efikas të burimeve. Për t'i riorganizuar modelet e prodhimit dhe konsumit dhe për t'i transformuar mbeturinat në burime, ne kemi nevojë për teknologji, procese, shërbime dhe modele të reja biznesi që do të paracaktojnë të ardhmen e ekonomisë dhe shoqërisë sonë.

Pas miratimit të pakos/kuadrit të plotë së ekonomisë qarkore nga Komisioni Evropian është rritur interesimi i korporatave të mëdha për miratimin e masave të efikasitetit të burimeve, eko-inovacionit dhe strategjive dhe praktikave për modelet e biznesit qarkor. NVM-të në BE përfshijnë më shumë vështirësi në adoptimin e strategjive dhe praktikave të tilla për shkak të kapaciteteve të tyre më të kufizuara organizative, teknologjike dhe financiare dhe qasjes më të vështirë në financimin e zgjidhjeve qarkore. Biznesi kosovar po përballë me probleme të ngjashme me qasje të kufizuara në informacione rreth teknologjive të reja, zhvillimeve të produkteve dhe modeleve të biznesit.

Sigurimi i informacionit për industrinë dhe sektorin e kërkimit dhe zhvillimit në Kosovë për praktikat më të mira për përmirësimin e efikasitetit të burimeve, teknologjitë e reja të riciklimit, skemat e financimit dhe zhvillimet e tregjeve për mallrat e mbeturinave të ricikluar do të jetë me rëndësi parësore për transformimet në sektorin e menaxhimit të mbeturinave. Disponueshmëria e një burimi njerëzor me arsim të lartë është çelësi për zhvillimin e potencialit për inovacion. Për këtë qëllim, strategjia parashikon mbështetje për kërkime shkencore praktike lidhur me problemet reale të ndërmarrjeve dhe për rritjen e aftësive, kualifikimit profesional dhe edukimit në fushat e “biznesit të gjelbër”, “modeleve të reja të konsumit”, “ndërmarrjes sociale” e të tjera.

Si hap i parë, fondet për grante do të kërkohen nga partnerët ndërkombëtarë për zhvillim dhe inovacion. Këto grante për inovacion do të vihen në dispozicion në bazë të një konkurrimi për projekte që e promovojnë parandalimin, ripërdorimin dhe riciklimin e mbeturinave, me fokus të veçantë në gjetjen e alternativave ndaj produkteve plastike. Udhëzimet specifike mbi kriteret e pranueshmërisë dhe proceset e aplikimit për Grantet e Inovacionit do të varen nga dizajni i skemës dhe do të publikohen paraprakisht.

Qeveria do t'i fillojë konsultimet me përfaqësues të industrisë, universitetet dhe institucione të tjera kërkimore për krijimin e një qendre për t'i mbështetur bizneset për kalimin në ekonomi qarkore. Qëllimi i kësaj qendre do të jetë t'i ofrojë NVM-ve konsultime për çështje teknike dhe financiare për kalimin në një ekonomi qarkore. Krijimi dhe mirëmbajtja e një platforme për rezultatet e teknologjive të zbatuara për efikasitetin e burimeve, produktet mjedisore, simbiozën industriale me sigurimin e informacionit nga efekti i teknologjive tashmë të zbatuara nga prodhuesit dhe nga klientët do të lejojë aplikimin e shpejtë të përvojës së dobishme dhe zgjerimin e tregjeve dhe teknologjive dhe produkteve të reja.

| <b>Indikatori i rezultatit</b>                                                                            | <b>Viti Bazë</b>                     | <b>Objektivi i ndërmjetëm</b>                                             | <b>Objektivi përfundimtar</b>                                                   |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Zgjidhjet e zhvilluara në nivel lokal për parandalimin e mbeturinave zbatohen me mbështetjen e një</b> | Sistemi i granteve nuk është krijuar | Raundi i parë i aplikimeve për zgjidhje inovative është përfunduar (2030) | Raundi përfundimtar i aplikimeve për zgjidhje inovative është përfunduar (2035) |

## 5 Zbatimi, Monitorimi dhe Raportimi

SIMMK është fokusuar në veprime realiste dhe të zbatueshme. Ky seksion përshkruan se si do të strukturohet, drejtohet dhe realizohet zbatimi. Janë përshkruar kërkesat për raportim dhe ciklet dhe mekanizmat për monitorim. Parimet udhëzuese ndihmojnë që të ekzistojë një strategji koherente dhe koncize, duke synuar caqet dhe indikatorët e përcaktuar në kapitullin 4.

### 5.1 Parimet

Ligji për Mbeturina tashmë e përcakton një tërësi parimesh që duhet ta udhëheqin sektorin e menaxhimit të mbeturinave. Zhvillimi i qëndrueshëm i përfshin të gjitha planifikimet strategjike, ndërsa të tjerët trajtojnë aspekte më specifike të planifikimit të MMN-së.

Afërsia dhe vetëtrajtimi

Vigjilenca dhe parandalimi

Ndotësi paguan

Hierarkia e menaxhimit të mbeturinave

Përgjegjësia e prodhuesit


Siguria financiare

Qasja në informata

Mbrojtja e të drejtave në gjykatë

Përderisa legjislacioni tashmë jep udhëzime thelbësore, kjo strategji i përmbledh këto parime në gjashtë aspekte qendrore në të cilat do të përqendrohet vëmendja.

**Qeverisja e mirë:** Grumbullimi i mbeturinave është njëri nga indikatorët kryesorë të një administrate publike funksionale. Si ofruesi aktual i shërbimeve me kapacitete operative përkatëse, ashtu edhe operatorët menaxhues privatë, të dyja palët janë duke e shfaqur kapacitetin teknik, menaxhues dhe financiar të administratave komunale dhe qendrore për t'u marrë me kërkesën e përditshme për shërbime. Qeverisja e mirë nënkupton përdorimin efikas të fondeve publike për ofrimin e shërbimeve adekuate, proceset vendimmarrëse transparente dhe pjesëmarrëse, institucionet publike të përgjegjshme dhe proaktive dhe një përafrim midis qytetarëve dhe administratës që u shërben atyre.



**Standardet evropiane:** Për anëtarësimin në BE kërkohet që të zbatohen të gjitha standardet evropiane që kanë të bëjnë me menaxhimin e mbeturinave, duke përfshirë nivelet e shërbimit, standardet e deponimit, objektivat e riciklimit dhe ripërtëritjes si dhe kërkesat për monitorim dhe raportim.

**Ekonomia qarkore:** Modelet lineare të prodhimit, konsumit dhe deponimit po zhduken gradualisht përderisa ne po bëhemi më të vetëdijshëm për burimet tona të kufizuara dhe ndikimet negative të modeleve të tilla. Përderisa Kosova është ende në proces të formimit të një sistemi gjithëpërfshirës të menaxhimit të mbeturinave në vend, aspektet kryesore të konceptit të ekonomive qarkore, siç është përpunimi i burimeve, zinxhirët e vlerave të produkteve dhe qarkullimi mes tjerash, do t'i udhëheqin sistemet e vendit drejt një menaxhimi më të qëndrueshëm dhe ekonomikisht më të favorshëm dhe më modern të burimeve të saj.

**Parimi “ndotësi paguan” dhe përgjegjësia e zgjeruar e prodhuesit:** janë shtysa rregullative që çojnë kah ekonomia qarkore. Siç është përkufizuar tashmë në Ligjin për Mbeturina, parimi “ndotësi paguan” ia atribuon një përgjegjësi financiare të qartë financiare prodhuesit të mbeturinave, duke e stimuluar kështu reduktimin dhe riciklimin e tyre. Përgjegjësia e zgjeruar e prodhuesit e shtrin këtë përgjegjësi në ciklin e plotë të prodhimit, konsumit dhe deponimit, duke e nxitur kështu motivimin për të dizajnuar dhe prodhuar produkte që janë të përshtatshme për riciklim apo ripërtëritje.

**Zbatueshmëria:** Ndonëse nuk është parim strategjik në vetvete, por duke e marrë pasur parasysh përvojën me zbatimin e strategjisë së mëparshme, zbatueshmëria e kësaj strategjie do të sigurohet me vlerësime të hollësishme të shpenzimeve, me afate kohore reale dhe me një plan të veprimit gjithëpërfshirës për tri vitet e para të kësaj strategjie.

## **5.2 Zbatimi, Monitorimi dhe Raportimi**

Njëri nga parimet themelore të Strategjisë është zbatueshmëria e saj. Ajo bazohet në planin e veprimit që i është bashkangjitur këtij dokumenti dhe në të cilin përshkruhen të gjitha aktivitetet relevante për realizimin e objektivave të strategjisë, në një horizont kohor prej tri vitesh. Fushëveprimi është caktuar për t'u siguruar që fondet në dispozicion dhe alokimet financiare si dhe kapacitetet e nevojshme institucionale për zbatimin e strategjisë janë rritur dhe përputhen me kërkesat për zbatim. Zbatimi i strategjisë është duke u përshkallëzuar në disa nivele të përgjegjësisë dhe duke e mbuluar tërë vendin. Prandaj, monitorimi adekuat i progresit dhe drejtimi i vazhdueshëm është po aq i rëndësishëm dhe sfidues.

Meqë shumë veprime po zbatohen në nivel lokal me shumëllojshmërinë e gjerë të kapaciteteve të saj, informatat reale për progresin e arritur duhet të rrjedhin në mënyrë efikase midis organeve drejtuese dhe institucioneve zbatuese. Një aspekt tjetër që duhet marrë parasysh është disponueshmëria e fondeve. Në planin e veprimit që i është bashkangjitur strategjisë janë shqyrtuar të gjitha burimet e financimit që janë përcaktuar aktualisht. Megjithatë, nëse gjatë zbatimit të strategjisë vihen në dispozicion burime të mëtejshme, planifikimi, zbatimi dhe monitorimi duhet të përshtaten në përputhje me rrethanat.

Zbatimi, monitorimi dhe raportimi i strategjisë udhëhiqet dhe është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Udhëzimin Administrativ nr. 07/2018 për Planifikimin dhe Hartimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të Veprimit.<sup>18</sup>

MMPHI-ja është përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe udhëheqjen e zbatimit, monitorimit dhe raportimit për zbatimin e kësaj strategjie. Kjo përfshin edhe organin bashkërendues ndërmënyrës, të përfaqësuar nga Grupi Punues për Menaxhimin e Mbeturisë të Ngurta si dhe Zyra për Planifikim Strategjik (ZPS-ja) dhe Komisioni për Planifikim Strategjik. Ajo po ashtu kërkon përfshirjen e sektorit të menaxhimit të mbeturisë, biznesit dhe industrisë, dhe qytetarëve. Partnerët zbatues kryesorë janë:

- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), e cila e koordinon zhvillimin dhe mbështetjen e qeverisë për komunat, veçanërisht shtimin e aftësisë së tyre për të ofruar shërbime efektive
- Komunat e Kosovës, të cilat, sipas përkufizimit në Ligjin për Mbeturinën, janë përgjegjëse për krijimin e një sistemi të menaxhimit të mbeturisë brenda juridiksionit të tyre në përputhje me Planin Kombëtar të Veprimit, dhe përfaqësuesi i tyre në nivel kombëtar, Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK);
- Agjensioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK), në rolin e tij si rregullator mjedisor dhe i ngarkuar me detyrën për të raportuar për statusin e MMN në Kosovë (neni 14, 1.7-1.8 i Ligjit për Mbeturinën)
- Kompania për Menaxhimin e Deponive të Kosovës (KMDK), e cila e mban përgjegjësinë për menaxhimin e impianteve të mbeturisë dhe pikat e deponimit përfundimtar në Kosovë;
- Kompanitë Rajonale të Mbeturisë (KRM), operatorët me leje mjedisore komunale në pronësi të qeverive komunale që ofrojnë shërbime rajonale të grumbullimit të mbeturisë.
- Operatorët e tjerë me leje mjedisore përkatëse që ofrojnë shërbime të MMN.

Plani i Veprimit, si mjet kryesor i zbatimit, i identifikon institucionet udhëheqëse dhe potencialisht mbështetëse për secilin veprim që përcaktohet në të. Prandaj, përgjegjësinë për zbatim, monitorim dhe raportim e mbart secili institucion i identifikuar. Megjithatë, MMPHI, si organ bashkërendues, është përgjegjëse për bashkërendimin e përgjithshëm midis agjencive zbatuese dhe duhet të sigurojë që të realizohen afatet kohore dhe objektivat. Funkcionet e përgjithshme të qeverisë dhe institucioneve përkatëse të tyre nuk janë renditur në mënyrë specifike këtu (p.sh. planifikimi buxhetor dhe fondet e ndara nga Ministria e Financave). Funkcionet kryesore të të gjithë partnerëve zbatues janë paraqitur në tabelën në vijim.

#### Struktura e menaxhimit të zbatimit

| Institucioni | Funkcionet kryesore                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |
|--------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| MMPHI        | <ul style="list-style-type: none"> <li>• E harton Strategjinë dhe Planin e Veprimit</li> <li>• I udhëzon të gjithë partnerët zbatues për përgjegjësitë e tyre në kuadër të Planit të Veprimit</li> <li>• E bashkërendon përshtatjen e mbështetjes për zhvillim dhe financimit me strategjinë dhe planin e veprimit</li> </ul> |

<sup>18</sup>Udhëzimi Administrativ (QRK) nr. 07/2018 për planifikimin dhe hartimin e dokumenteve strategjike dhe planeve të veprimit është miratuar në mbledhjen e 39-të të Qeverisë së Kosovës me Vendimin nr. 03/39 të datës 4.4.2018.

|                                           |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |
|-------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|                                           | <ul style="list-style-type: none"> <li>• E krijon një mekanizëm efektiv të monitorimit dhe raportimit dhe e siguron përdorimin e tij</li> <li>• Mbledh informata nga partnerët zbatues për afatet kohore, objektivat dhe statusin e zbatimit</li> <li>• I përgatit dokumentet e nevojshme për raportim (shih më poshtë)</li> <li>• E organizon grupin punues për MMN dhe i ofron funksionet e sekretariatit</li> <li>• E siguron shkëmbimin dhe bashkëpunimin midis të gjithë partnerëve zbatues</li> <li>• I inicion diskutimet për progresin e zbatimit dhe azhurnimin ose riplanifikimin e planit të veprimit</li> </ul>                                       |
| <b>Grupi Punues për MMN</b>               | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kryen shkëmbime të rregullta për ta diskutuar ecurinë e zbatimit të strategjisë dhe planit të veprimit</li> <li>• I identifikon sfidat dhe vështirësitë dhe propozon masa korrigjuese për partnerët zbatues</li> <li>• I shqyrton dhe miraton raportet e progresit dhe monitorimit</li> <li>• E nxit bashkëpunimin midis të gjithë partnerëve zbatues</li> </ul>                                                                                                                                                                                                                                                         |
| <b>Zyra e Planifikimit Strategjik</b>     | <ul style="list-style-type: none"> <li>• U ofron mbështetje metodologjike MMPH dhe partnerëve zbatues në monitorimin, raportimin dhe hartimin e strategjisë</li> <li>• Merr pjesë në grupin punues për MMN</li> <li>• I rishikon raportet dhe e bën një vlerësim strategjik të rrezikut dhe përshtatjes me aktet strategjike kombëtare gjithëpërfshirëse</li> <li>• E integron ecurinë e strategjisë së MMN në raportimin kombëtar për dorëzim te Komiteti i Planifikimit Strategjik</li> </ul>                                                                                                                                                                   |
| <b>Komiteti i Planifikimit Strategjik</b> | <ul style="list-style-type: none"> <li>• I shqyrton dhe miraton raportet e rregullta, nëse çështjet nuk i ka zgjidhur grupi punues për MMN</li> <li>• Vendos për masat korrigjuese për ta siguruar zbatimin e shëndoshë të strategjisë</li> <li>• I zgjidh çështjet në bashkërendim dhe vendimmarrje midis partnerëve zbatues, nëse zgjidhjet kanë dështuar në nivel të grupit punues për MMN</li> </ul>                                                                                                                                                                                                                                                          |
| <b>MAPL</b>                               | <ul style="list-style-type: none"> <li>• E mbështet shpërndarjen e strategjisë dhe planit të veprimit nëpër komuna</li> <li>• E bashkërendon mbështetjen e qeverisë për komunat në lidhje me zbatimin e planit të veprimit</li> <li>• Merr pjesë në grupin punues për MMN</li> <li>• I bashkërendon masat e zhvillimit të kapaciteteve për komunat e parashikuara në planin e veprimit me masa të tjera në mbështetje të administratave komunale</li> <li>• E mbështet sigurimin e buxheteve adekuate në buxhetet komunale</li> </ul>                                                                                                                             |
| <b>Komunat</b>                            | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Në bazë të strategjisë dhe planit të veprimit zhvillohen dhe zbatohen planet komunale ose rajonale për menaxhimin e mbeturinave</li> <li>• E sigurojnë zbatimin me kohë dhe efikas të veprimeve që u janë atribuar</li> <li>• Raportojnë për progresin sipas kërkesës së MMPH dhe AMMK</li> <li>• Ia bëjnë me dije pengesat dhe sfidat ndaj zbatimit në kohë të veprimeve MMPH dhe/ose grupit punues për MMN</li> <li>• E sigurojnë bashkëpunimin e ngushtë me KMDK, KRM dhe/ose ofruesit e tjerë të shërbimeve</li> <li>• Marrin pjesë në grupin punues për MMN, përmes përfaqësuesit kombëtar të tyre – AKK</li> </ul> |
| <b>AMMK</b>                               | <ul style="list-style-type: none"> <li>• E mbështet MMPH në mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e të dhënave për zbatimin e strategjisë</li> <li>• I mbështet komunat në mbledhjen dhe raportimin e të dhënave</li> <li>• Merr pjesë në grupin punues për MMN</li> </ul>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |

|                              |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |
|------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>KMDK</b>                  | <ul style="list-style-type: none"> <li>E sigurojnë zbatimin me kohë dhe efikas të veprimeve që u janë atribuar</li> <li>E siguron monitorimin dhe raportimin me kohë dhe gjithëpërfshirës për realizimin e veprimeve dhe për objektivat dhe performancën e shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave</li> <li>Ia bëjnë me dije pengesat dhe sfidat ndaj zbatimit në kohë të veprimeve MMPH dhe/ose grupit punues për MMN</li> </ul> |
| <b>KRM</b>                   | <ul style="list-style-type: none"> <li>E siguron zbatimin me kohë dhe efikas të veprimeve që u janë atribuar</li> <li>E siguron monitorimin dhe raportimin me kohë dhe gjithëpërfshirës për realizimin e veprimeve dhe për objektivat dhe performancën e shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave</li> </ul>                                                                                                                       |
| <b>Ofruesit e shërbimeve</b> | <ul style="list-style-type: none"> <li>E sigurojnë zbatimin me kohë dhe efikas të veprimeve që u janë atribuar</li> <li>E sigurojnë raportimit me kohë dhe gjithëpërfshirës për performancën e shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave</li> </ul>                                                                                                                                                                                 |

#### Kërkesat e monitorimit dhe raportimit

Siç është treguar në tabelën e mësipërme, monitorimi është një detyrë e shpërndarë për të gjithë partnerët zbatues të përfshirë. MMPH, me mbështetjen e Zyrës së Planifikimit Strategjik, do t'i krijojë udhëzimet dhe shabllonet e nevojshme të raportimit për t'u siguruar që të ketë të dhëna dhe informata gjithëpërfshirëse për t'i hartuar raportet e kërkuara në vijim për zbatimin e strategjisë dhe planit të veprimit. Udhëzime të hollësishme janë dhënë në Doracakun për Planifikimin, Hartimin dhe Monitorimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të Veprimit të tyre, i cili është nxjerrë nga Zyra e Planifikimit Strategjik.

Kjo strategji ka një vlefshmëri prej 12 vitesh (2024-2035), me një azhurnim të propozuar pas pesë vitesh. Plani i veprimit është i vlefshëm për tri vite (2024-2026) dhe do të azhurnohet dhe zgjerohet gradualisht, pas një cikli të vlerësimit dhe riplanifikimit afatmesëm.

| <b>Monitorimi/raportimi</b>                           | <b>Përshkrimi</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |
|-------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Raporti gjashtëmuor për zbatimin e planit të veprimit | <ul style="list-style-type: none"> <li>Raporti i parë për zbatimin gjashtëmuor, raporti i dytë do ta mbulojë një periudhë prej 12 muajve</li> <li>Do të shtjellohet nga MMPHI, me përkrahjen e AMMK</li> <li>Raporti për përfundimin e veprimeve, arritjet, arsyet për vonesa dhe vlerësimet e përditësuara të rrezikut</li> <li>E mbështet grupin punues të MMPHI së dhe atë të MMN për të diskutuar dhe vendosur për masat korrigjuese</li> <li>Miratohet nga grupi punues për MMN</li> <li>Aprovohet nga Sekretari i Përgjithshëm i MMPHI</li> </ul>                                                                                                                           |
| Raporti vjetor për zbatimin e strategjisë             | <ul style="list-style-type: none"> <li>Periudha e paraparë është fundi i tremujorit të parë të vitit pasues</li> <li>Shtjellohet nga MMPHI, me përkrahjen e AMMK dhe ZPS</li> <li>Raport për: <ul style="list-style-type: none"> <li>gjendjen e caceve indikative për objektivat e strategjisë</li> <li>gjendjen e realizimit të veprimeve</li> <li>përdorimin e burimeve financiare</li> <li>pengesat kryesore dhe masat korrigjuese</li> </ul> </li> <li>E mbështet grupin punues të MMPHI së dhe atë të MMN për të diskutuar dhe vendosur për masat korrigjuese</li> <li>Miratohet nga grupi punues për MMN</li> <li>Aprovohet nga Sekretari i Përgjithshëm i MMPHI</li> </ul> |

|                                                 |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |
|-------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Raporti përfundimtar për zbatimin e strategjisë | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Brenda 3 muajve pas skadimit të strategjisë ose si pjesë e ciklit të përditësimit pas 5 vjetësh</li> <li>• Si raport vjetor, por që i dorëzohet ZPS, duke përfshirë një vlerësim të hapave të ardhshëm</li> <li>• Aprovimi përfundimtar nga Komisioni i Planifikimit Strategjik</li> </ul>                                                                                                                                          |
| Vlerësimi afatmesëm i planit të veprimit        | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Metoda e përzier e vlerësimit që do të bëhet pas zbatimit 18 mujor, duke e mbështetur planifikimin elektronik dhe zgjaten e planit të veprimit</li> <li>• Drejtohet nga MMPHI, me përkrahjen e ZPS</li> <li>• Themelimi i një task force për vlerësim</li> <li>• Raporti i dorëzohet Ministrit të MMPHI për miratim dhe Komitetit të Planifikimit Strategjik.</li> <li>• Do të publikohet në faqen e internetit të MMPHI</li> </ul> |
| Vlerësimi i strategjisë                         | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Metoda e vlerësimit të përzier duhet të kryhet menjëherë pas përfundimit të strategjisë ose si pjesë e ciklit të përditësimit pas pesë viteve</li> <li>• Si më lart</li> </ul>                                                                                                                                                                                                                                                      |

## 6 Ndikimi buxhetor

Masat e parapara në Strategjinë dhe Planin e Veprimit adresojnë obligimet e Kosovës që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA) dhe përafrimi i politikave sektoriale në fushën e menaxhimit të mbeturinave me ato të BE-së, duke përsheptuar kështu procesin e integritet evropian.

Aktivitetet e planit të veprimit përfshijnë gjithashtu kostot e parashikuara të masave të investimit të Planit Kombëtar për Menaxhimin e Mbeturinave të Ndërtimit dhe Rrënitit 2023 dhe Planit Kombëtar për Menaxhimin e Mbeturinave të Kujdesit Shëndetësor 2022.

Rekomandohet skema e zgjeruar e përgjegjësisë së prodhuesit për mbeturinat e paketimit si mjete financiare dhe menaxhuese për të siguruar investime të gjera dhe fonde operative të nevojshme për mbulimin total të popullsisë me grumbullimin e ndarë të lëndëve të riciklueshme, klasifikimin dhe riciklimin. Investimet në sektorin privat duhet të nxiten për ta rritur efektivitetin dhe efikasitetin në sektorin e MMB.

Duhet të kërkohet mbështetja financiare e BE-së për asistencë teknike dhe për financimin e granteve kapitale për zbatimin e investimeve të mëdha në infrastrukturën publike për trajtimin dhe deponimin e mbeturinave.

Burimet njerëzore dhe teknike brenda institucioneve kompetente, të nevojshme për zhvillimin intensiv të sektorit, duhet të sigurohen brenda buxhetit të pushtetit qendror dhe lokal.

Tabela përmbledh kostot e parashikuara për periudhën 2024-2026 dhe 2027-2030. Burimet e përkohshme të financimit janë të shënuara në planin e veprimit për periudhën 2024-2026.

| <b>Kostot e implementimit</b>                                      | <b>2024-2026</b>   | <b>2027-2030</b>   | <b>Totali</b>      |
|--------------------------------------------------------------------|--------------------|--------------------|--------------------|
| <i>Objektivi strategjik 1: Shërbimet dhe infrastruktura.</i>       | <i>115,301,400</i> | <i>213,677,000</i> | <i>328,978,400</i> |
| <i>Objektivi strategjik 2: Kushtet kornizë</i>                     | <i>1,250,000</i>   | <i>2,000,000</i>   | <i>3,250,000</i>   |
| <i>Objektivi strategjik 3: Implementimi, zbatimi dhe financimi</i> | <i>1,700,000</i>   | <i>1,000,000</i>   | <i>2,700,000</i>   |
| <i>Objektivi strategjik 4: Ekonomia qarkore</i>                    | <i>22,439,000</i>  | <i>35,672,000</i>  | <i>58,111,000</i>  |
| <b>Totali (Euro)</b>                                               | <b>140,690,400</b> | <b>252,349,000</b> | <b>393,039,400</b> |

## 7 Plani i Veprimit

### Plani i Veprimit për zbatimin e objektivit strategjik 1: SHËRBIMET DHE INFRASTRUKTURA

| I.   | Objektivi strategjik 1: Inicimi i shërbimeve dhe infrastrukturës për menaxhimin e integruar të mbeturinave.                                                             |                                                                 |                          |                               |           |
|------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------|--------------------------|-------------------------------|-----------|
|      | Indikatori                                                                                                                                                              | Vlera bazë                                                      | Caku i përkohshëm [2028] | Caku i vitit të fundit [2035] | Rezultati |
|      | Përqindja totale e mbeturinave të gjeneruara të kontrolluara nëpërmjet sistemit të integruar të menaxhimit të mbeturinave                                               | Sistemi i integruar për menaxhim të mbeturinave nuk ekziston 0% | 30%                      | 50%                           |           |
| I.1. | Objektivi specifik 1: Ofrimi i shërbimeve të përshtatshme dhe të qëndrueshme të grumbullimit të mbeturinave të ngurta komunale për të gjithë gjeneruesit e mbeturinave. |                                                                 |                          |                               |           |

| I.1. | Indikatori                                                                                                                     | Vlera bazë          |         | Caku i përkohshëm [2028] | Caku i vitit të fundit [2030] | Rezultati                                                                                                |                                      |          |                        |
|------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------|---------|--------------------------|-------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------|----------|------------------------|
|      | Përqindja e popullsisë së përgjithshme me qasje në shërbimet adekuate dhe të rregullta të grumbullimit të mbeturinave komunale | 90.2% në vitin 2021 |         | 98.5%                    | 99%                           | Popullsia totale me qasje në shërbimet adekuate dhe të rregullta të grumbullimit të mbeturinave komunale |                                      |          |                        |
| Nr.  | Veprimet                                                                                                                       | Afati i fundit      | Buxheti |                          |                               | Burimi i financimit                                                                                      | Institucioni drejtues dhe mbështetës | Produkti | Referenca në dokumente |
|      |                                                                                                                                |                     | 2024    | 2025                     | 2026                          |                                                                                                          |                                      |          |                        |

|       |                                                                                                                                                                                               |             |         |         |   |                                 |                            |                                           |                                    |
|-------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------|---------|---------|---|---------------------------------|----------------------------|-------------------------------------------|------------------------------------|
| I.1.1 | Hartimi dhe miratimi i planit ndër-komunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave për ZMM 1 (Podujevë, Prishtinë, Obiliq, Fushë Kosovë, Glogovc, Graçanicë, Lipjan)                        | 2025<br>TM1 | 0       | 150,000 | 0 | Granti i asistencës teknike/GIZ | Komunat/<br>MAPL/<br>MMPHI | PMM ndër-komunal i zhvilluar dhe miratuar | Ligji për bashkëpunim ndër-komunal |
| I.1.2 | Hartimi dhe miratimi i planeve ndër-komunale për menaxhimin e integruar të mbeturinave për ZMM 2 (Leposaviq, Zveçan, Mitrovicë e Jugut, Mitrovicë e Veriut, Skënderaj, Vushtrri, Zubin Potok) | 2024<br>TM4 | 150,000 | 0       | 0 | Granti i asistencës teknike/GIZ | Komunat/<br>MAPL/<br>MMPHI | PMM ndër-komunal i zhvilluar dhe miratuar | Ligji për bashkëpunim ndër-komunal |
| I.1.3 | Hartimi dhe miratimi i planit ndër-komunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave për ZMM 3 (Istog, Klinë, Pejë, Decan, Junik)                                                             | 2025<br>TM4 | 0       | 150,000 | 0 | Granti i asistencës teknike/GIZ | Komunat/<br>MAPL/<br>MMPHI | PMM ndër-komunal i zhvilluar dhe miratuar | Ligji për bashkëpunim ndër-komunal |
| I.1.4 | Hartimi dhe miratimi i planit ndër-komunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave për ZMM 4 (Malishevë, Suharekë, Mamushë, Prizren, Gjakovë, Dragash, Rahovec)                             | 2025<br>TM2 | 0       | 150,000 | 0 | Granti i asistencës teknike/GIZ | Komunat/<br>MAPL/<br>MMPHI | PMM ndër-komunal i zhvilluar dhe miratuar | Ligji për bashkëpunim ndër-komunal |
| I.1.5 | Hartimi dhe miratimi i planit ndër-komunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave për ZMM 5 (Kamenicë, Novobërdë,                                                                          | 2025<br>TM2 | 0       | 150,000 | 0 | Granti i asistencës teknike/GIZ | Komunat/<br>MAPL/<br>MMPHI | PMM ndër-komunal i zhvilluar dhe miratuar | Ligji për bashkëpunim ndër-komunal |

|       |                                                                                                                                                                                           |          |                |                |          |                                     |                      |                                        |      |
|-------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------|----------------|----------------|----------|-------------------------------------|----------------------|----------------------------------------|------|
|       | Ranillug, Gjilan, Partesh, Klokot, Viti, Ferizaj, Shtime, Kaçanik, Shtërpce, Hani i Elezit)                                                                                               |          |                |                |          |                                     |                      |                                        |      |
| I.1.6 | Hartimi dhe nënshkrimi i kontratave për shërbime publike ndërmjet komunave dhe ofruesve të shërbimeve përfshirë TKP për menaxhimin e mbeturinave për mbulimin me shërbime të grumbullimit | 2025 TM4 | 0              | 0              | 0        | brenda buxheteve aktuale të Komunës | Komunat/ MAPL/ MMPHI | Kontratat e shërbimit publik me TKP-të | n.a. |
|       | <b>Buxheti total për objektivin specifik I.1</b>                                                                                                                                          |          | <b>150,000</b> | <b>600,000</b> | <b>0</b> |                                     |                      |                                        |      |
|       | <i>Nga të cilat kapitale</i>                                                                                                                                                              |          |                |                |          |                                     |                      |                                        |      |
|       | <i>Nga të cilat rrjedhëse</i>                                                                                                                                                             |          | 150,000        | 600,000        | 0        |                                     |                      |                                        |      |

| I.2. | Objektivi specifik 1.2: Zhvillimi i sistemeve dhe impianteve të integruara, për përpunimin dhe deponimin e mbeturinave komunale                                                                                                         |                                                                                                                                                              |                          |                               |                                                                                                                                      |
|------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------|-------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|      | Indikatori                                                                                                                                                                                                                              | Vlera bazë                                                                                                                                                   | Caku i ndërmjetëm [2028] | Caku i vitit të fundit [2035] | Rezultati                                                                                                                            |
|      | Përqindja e totalit të mbeturinave të ngurta komunale të gjeneruara që menaxhohen në objekte të kontrolluara (përfshirë deponitë sanitare, dhe/ose impiantet për trajtim termik/biologjik dhe të përpunimit/riciklimit të materialeve). | 0% (2021) impiante për trajtim termik/biologjik dhe të përpunimit/riciklimit të 90.2% e mbeturinave të grumbulluara dhe të deponuara në deponi në vitin 2021 | 75%                      | 100%                          | Përqindja e mbeturinave komunale e përcaktuar të trajtohet në objektet e rikuperimit ose deponimit në përputhje me kërkesat ligjore: |

